Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

N.M. dhe të tjerët kundër UNMIK-ut

Lënda nr. 26/08

MENDIM

26 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

Faqe nr.

I. PROCEDURAT PARA PANELIT 1

II. FAKTET 4
A. Ngjarjet në të kaluarën 4
B. Shkatërrimi i Lagjes së Romëve dhe vendosja në kampe për persona të zhvendosur brenda vendit (PZHB) 5
C. Kontaminimi me plumb në Mitrovicë dhe kampet për PZHB 11
1. Burimet, efektet dhe trajtimi i helmimit nga plumbi 11
2. Organizata Botërore e Shëndetësisë, Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve dhe dokumentacioni tjetër për kontaminimin nga plumbi në Mitrovicën veriore dhe kampet për PZHB-të 13
D. Kushtet e jetës, higjienike dhe shëndetësore në kampet për PZHB 18
E. Paditë penale dhe civile të paraqitura nga ankuesit
1. Procedurat kundër UNMIK-ut 21
2. Procedurat kundër EULEX-it 22

III. ANKESA 22

IV LIGJI
Pranueshmëria 23
Bazueshmëria
A. Parashtresat e palëve
1. Parashtresat e ankuesve 24
a) Dokumentacioni mjekësor për testin lidhur me kontaminimin nga plumbi në kampe 24
b) Dokumentacioni mjekësor lidhur me anëtarët e familjes të cilët vdiqën në kampe 27
c) Pohimet dhe argumentet e ankuesve 28
2. Parashtresat e PSSP-së 33
3. Parashtresat shtesë të ankuesve 39
B. Observimet preliminare të Panelit
1. Fusha për t'u shqyrtuar nga Paneli 40
2. Pesha e dëshmisë 41
C. Vlerësimi i Panelit 42
1. Shkelja e pretenduar e të drejtës në jetë
a) Obligimi esencial 42
i) Parimet e përgjithshme 42
ii) Aplikueshmëria në rastin aktual 45
b) Obligimi procedural 51
2. Shkelja e pretenduar e të drejtës për të qenë i lirë nga trajtimi johuman dhe degradues
a) Parimet e përgjithshme 52
b) Aplikueshmëria në rastin aktual 54
3. Shkelja e pretenduar e të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare
a) Parimet e përgjithshme 56

b) Aplikueshmëria në rastin aktual 57
4. Shkelja e pretenduar e të drejtës për shëndet dhe e të drejtës për standard adekuat të jetesës
a) Parimet e përgjithshme 58
b) Aplikueshmëria në rastin aktual 61
5. Shkelja e pretenduar për ndalim të diskriminimit
a) Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike 64
i) Parimet e përgjithshme 64
ii) Aplikueshmëria në rastin aktual 66
b) Diskriminimi kundër grave 69
i) Parimet e përgjithshme 69
ii) Aplikueshmëria në rastin aktual 71
6. Shkelja e pretenduar e të drejtave të fëmijëve 73
a) Parimet e përgjithshme 74
b) Aplikueshmëria në rastin aktual 75
7. Shkelja e pretenduar e të drejtës për gjykim të drejtë dhe kompensim efektiv 77

V. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET 77

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 26 shkurt 2016,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Christine Chinkin, kryesuese
Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga
Anna Maria Cesano, ushtruese e detyrës së zyrtares ekzekutive

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pasi vuri në dukje tërheqjen e z. Marek Nowicki nga seanca për rastin në pajtim me rregullën 12 të Rregullores së punës,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 4 korrik 2008 dhe është regjistruar po të njëjtën ditë. Gjatë procedurave para Panelit, ankuesit janë përfaqësuar nga znj. Dianne Post, avokate nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

2. Më 24 korrik 2008, për ankesën u njoftua Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP)[1], lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës. Më 18 shtator 2008, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut në lidhje me pranueshmërinë e ankesës.

3. Më 7 tetor 2008, Paneli ua përcolli përgjigjen e UNMIK-ut ankuesve dhe i ftoi ata të japin komente nëse ata dëshirojnë ta bëjnë këtë. Një përgjigje nga përfaqësuesja e ankuesve është pranuar më 8 tetor 2008.

4. Më 31 tetor 2008, Paneli kërkoi nga ankuesit të ofrojnë informata shtesë. Një përgjigje është pranuar më 24 nëntor 2008.

5. Më 14, 15, 16 dhe 23 shkurt 2009, dokumentacion shtesë është pranuar nga ankuesit.

6. Me anën e një vendimi të 5 qershorit të vitit 2009, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme pjesërisht dhe të papranueshme pjesërisht.

7. Më 8 qershor 2009, Paneli ia përcolli vendimin mbi pranueshmërinë PSSP-së, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesës. Më 10 gusht 2009, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

[1]Një listë me shkurtesa dhe akronime që përmban teksti mund të gjendet në Shtojcën e bashkëngjitur.

8. Më 12 gusht 2009, Paneli ua përcolli përgjigjen e PSSP-së ankuesve duke i ftuar të paraqesin parashtresat e tyre nëse ata dëshirojnë ta bëjnë këtë. Ankuesit u përgjigjën më 25 gusht 2009.

9. Më 16 shtator 2009, përgjigja e ankuesve e 25 gushtit të vitit 2009 iu përcoll PSSP-së për komente.

10. Më 22 dhe 23 tetor 2009, Paneli, duke vërejtur se Udhëzimi Administrativ nr. 2009/1 për Implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut ishte lëshuar nga PSSP-ja më 17 tetor 2009, ftoi ankuesit dhe UNMIK-un të paraqesin komentet e tyre përkatëse në lidhje me ndikimin e atij Udhëzimi Administrativ në rastin aktual.

11. PSSP-ja u përgjigj ndaj kërkesës së 16 shtatorit të vitit 2009 për komente më 4 nëntor 2009. Kjo përgjigje iu dërgua ankuesve për komentet e tyre. Më 9 nëntor 2009, ankuesit dhanë përgjigjen e tyre.

12. Më 18 janar 2010, Paneli pranoi përgjigjen e PSSP-së ndaj letrës së vet të 23 tetorit të vitit 2009. Kjo përgjigje mban datën e 30 tetorit të vitit 2009.

13. Më 16 mars 2010, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesit, te cilët u përgjigjën po të njëjtën ditë.

14. Më 31 mars 2010, Paneli e shpalli ankesën të papranueshme, duke pasur parasysh Udhëzimin Administrativ nr. 2009/1. Paneli gjeti, në veçanti, se pjesë substanciale të ankesës binin *prima facie* brenda fushëveprimit të Procesit të Ankesave të Palës së Tretë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe prandaj kjo konsiderohej e papranueshme. Ai theksoi më tutje se pjesët substanciale dhe procedurale të ankesës ishin aq të ndërlidhura sa që do të ishte artificiale ndarja e tyre. Për atë arsye, ai e konsideroi krejt ankesën të papranueshme.

15. Në vendimin e vet, Paneli zbatoi rregullën 49 të Rregullores së vet të punës, e cila mundëson që çështjet që nuk qeverisen nga këto rregulla të zgjidhen nga Paneli. Ai vendosi që sapo të ketë përfunduar Procesi i Ankesave të Palës së Tretë i OKB-së, ankuesit mund të kërkojnë nga Paneli t'i rihapë procedurat. Paneli tregoi që ai atëherë do të vendosë, duke u bazuar në informatat në dispozicion të tij, nëse do ta pranojë apo jo një kërkesë të tillë.

16. Më 7 tetor 2011, ankuesit informuan Panelin për përfundimin e Procesit të Ankesave të Palës së Tretë të OKB-së përmes një vendimi të 25 korrikut të vitit 2011 që i shpalli ankesat e tyre, të dorëzuara para fillimit të procedurave para Panelit, jo të pranueshme. Në komunikimin e njëjtë, ankuesit i kërkuan Panelit t'i rihapë procedurat e veta.

17. Më 10 nëntor 2011, Paneli e njoftoi PSSP-në për kërkesën e ankuesve për t'i rihapur procedurat.

18. Më 31 janar 2012, PSSP-ja ofroi komentet e UNMIK-ut për kërkesën e ankuesve për t'i rihapur procedurat.

19. Më 9 shkurt 2012, Paneli kërkoi nga ankuesit të ofrojnë koment ndaj përgjigjes së UNMIK-ut të 31 janarit të vitit 2012. Më 13 shkurt 2012, ankuesit dërguan përgjigjen e tyre.

20. Më 15 shkurt 2012, Paneli e njoftoi PSSP-në për përgjigjen e ankuesve dhe kërko komente tjera të UNMIK-ut mbi çështjen.

21. Më 30 mars 2012, UNMIK-u ofroi komentet e veta të tjera.

22. Më 8 maj 2012, Paneli kërkoi informata tjera nga UNMIK-u. Më 4 qershor 2012, UNMIK-u dërgoi përgjigjen e vet.

23. Më 9 maj 2012, Paneli njoftoi ankuesit me komentet e UNMIK-ut të 30 marsit të vitit 2012. Më 14 maj 2012, ankuesit dhanë përgjigjen e tyre.

24. Më 10 qershor 2012, Paneli vendosi ta rihapë shqyrtimin e tij të ankesës, duke e shpallur atë të pranueshme.

25. Më 12 qershor 2012, Paneli ia përcolli PSSP-së vendimin e vet për ta rihapur këtë rast dhe e ftoi UNMIK-un t'i përfundojë komentet e veta mbi bazueshmërinë, nëse e konsideronte të nevojshme. Po të njëjtën ditë, Paneli ua përcolli vendimin e vet ankuesve duke i ftuar ata të ofrojnë komente shtesë mbi bazueshmërinë e ankesës nëse ata dëshirojnë ta bëjnë këtë.

26. Më 16 gusht 2012, Paneli i përsëriti kërkesat e veta për komente të UNMIK-ut mbi bazueshmërinë e ankesës. Nuk është pranuar asnjë përgjigje.

27. Në ndërkohë, Paneli pranoi parashtresa tjera nga përfaqësuesja e ankuesve, të cilat iu përcollën PSSP-së më 19 tetor 2012.

28. Më 5 mars 2013, dokumente shtesë janë pranuar nga ankuesit.

29. Më 23 prill 2013, Paneli përsëri i kërkoi PSSP-së të ofrojë komente mbi bazueshmërinë e ankesës. Nuk është pranuar asnjë përgjigje.

30. Më 11 shtator 2014, Paneli ia përsëriti kërkesën e vet PSSP-së për informata dhe dokumentacion shtesë.

31. Më 5 dhjetor 2014, PSSP-ja ofroi komentet e UNMIK-ut mbi bazueshmërinë e ankesës por pa dokumentacion përcjellës. Me anën e një korrespondence të veçantë, po ashtu të datës 5 dhjetor 2014, PSSP-ja ofroi përgjigjen e UNMIK-ut se kërkesa e Panelit për dokumentacion ishte tepër e përgjithshme dhe rrjedhimisht nuk përputhej.

32. Në përgjigje, më 19 dhjetor 2014, Paneli u dorëzoi kërkesa PSSP-së dhe Zyrës së UNMIK-ut në Mitrovicë për të pasur qasje në një listë të detajuar dhe specifikuar të dokumenteve relevante për rastin, duke përfshirë kopjet e dokumenteve mjekësore të ankuesve të dorëzuara më herët nga znj. Post në Selinë e OKB-së në Nju Jork si dhe tek UNMIK-u. Në këtë kërkesë, Paneli theksoi që, në mungesë të një përgjigje, Paneli do të vazhdojë me shqyrtimin e ankesës duke u bazuar në parashtresat e ankuesit,

materialin në dispozicion në fushën publike. Megjithatë, dokumentet e kërkuara nuk iu dorëzuan Panelit.

33. Më 19 janar 2015, Paneli ia përcolli komentet e UNMIK-ut mbi bazueshmërinë e ankesës përfaqësueses ligjore të ankuesve, e cila ofroi kundër-komentet e saj më 5 shkurt 2015.

34. Veç kësaj, me kërkesën e tij, Paneli pranoi dokumentacion dhe informata shtesë nga përfaqësuesja ligjore e ankuesve më 12 janar, 23 dhe 24 shkurt dhe, përsëri, më 6 mars 2015. Ky dokumentacion përfshinte kopjet e dokumenteve mjekësore të ankuesve me dëshmi që ato ishin pranuar nga Selia e OKB-së dhe UNMIK-u.

35. Më 25 mars dhe 5 prill 2015, znj. Post paraqiti kërkesat për pagesë të kostove dhe shpenzimeve që bëhen gjatë procedurave para Panelit.

36. Më 30 prill 2015, Paneli ia përcolli PSSP-së dëshminë me dokumente dhe kundër komentet e pranuara nga ankuesit duke e ftuar atë t'i paraqesë komentet shtesë të UNMIK-ut. Nuk është pranuar përgjigje tjetër.

II. FAKTET

37. Duke pasur parasysh se ankesa është shpallur e pranueshme, ankues janë 138 pjesëtarë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian (RAE)[2] në Kosovë të cilët jetonin në kampet për persona të shpërngulur brenda vendit (IDP-PSHB) të vendosura në Mitrovicën veriore që nga viti 1999. Të gjithë ankuesit pohojnë të kenë pësuar helmim nga plumbi dhe probleme tjera shëndetësore për shkak të kontaminimit të dheut në vendet e kampit për shkak të afërsisë së kampeve me Shkritoren Trepça dhe kompleksin e minierave dhe/apo për shkak të higjienës dhe kushteve jetësore përgjithësisht të këqija në kampe. Shkritorja e Trepçës nxirrte metale, duke përfshirë plumb, nga produktet e minierave në afërsi që nga 1930-ta deri më 1999.

38. Përshkrimi vijues i fakteve bazohet në dëshminë me dokumente (duke përfshirë dokumente mjekësore) të ofruar nga ankuesit, si dhe në dokumentet në fushën publike (raportet e organizatave lokale dhe ndërkombëtare, material i shtypit, korrespondencë etj.). Paneli e thekson se asnjë dokument nuk është ofruar nga UNMIK-u, pavarësisht kërkesës së vet të përsëritur për këtë qëllim.

A. Ngjarjet në të kaluarën

39. Para konfliktit të Kosovës, qyteti i Mitrovicës në veri të Kosovës ishte shtëpi e popullatës rome që numëronte përafërsisht 8,000 persona – njëri nga komunitetet më të mëdha rome në ish-Jugosllavi – që jetonte në Lagjen apo mëhallën e Romëve që

[2] Akronimi RAE është përdorur gjerësisht nga komuniteti ndërkombëtar për t'iu referuar së bashku komuniteteve minoritare rome në Kosovë (rom, ashkali dhe egjiptian). Çështja e identitetit të dallueshëm etnik të këtyre komuniteteve, të cilat ndajnë tipare kulturore dhe histori të margjinalizimit në shoqëri, është komplekse dhe e debatueshme. Në rastin aktual, Paneli do t'u referohet ankuesve alternativisht si pjesëtarë të komunitetit RAE apo rom në Kosovë, pasi këto janë karakteristikat dalluese të ofruara nga ta në parashtresat e tyre para Panelit.

gjendej në jug të lumit Ibër. Vlerësohet se Lagjja e Romëve në Mitrovicë (po ashtu e njohur si Lagjja e "Fabrikës") përbëhej përafërsisht prej 700 shtëpive, dhe 1,000 familjeve, të cilat ishin të integruara në jetën sociale dhe ekonomike të qytetit.

40. Konflikti i armatosur gjatë vitit 1998 dhe 1999, ndërmjet forcave serbe në njërën anë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës në anën tjetër, është mirë i dokumentuar. Kah fundi i konfliktit, mijëra romë që konsideroheshin nga shqiptarët e Kosovës se kanë bashkëpunuar me autoritetet serbe iu nënshtruan sulmeve të dhunshme në gjithë Kosovën, duke përfshirë Mitrovicën, dhe shumë nga ta u larguan *en masse* për t'u bërë PZHB apo refugjatë në Serbi, Mal të Zi, dhe Evropën Perëndimore dhe Veriore.

41. Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244 (1999). Duke vepruar sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit i OKB-së mori vendim për vendosjen e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe civile-përkatësisht të KFOR-it dhe UNMIK-ut, në territorin e Kosovës. Në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr. 1244 (1999), OKB-ja u ngarkua me kompetenca të plota legjislative dhe ekzekutive për administrim të përkohshëm. KFOR-i u ngarkua për krijimin e "një ambienti të sigurt, në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen në shtëpi të sigurt" dhe përkohësisht të sigurojë "rendin dhe sigurinë publike", derisa prania ndërkombëtare civile të mund të marrë përsipër përgjegjësinë për këtë detyrë. UNMIK-u përbëhej nga katër komponentë apo shtylla kryesore të udhëhequra nga OKB-ja (administrata civile), Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (ndihma humanitare, e cila u hoq në qershorin e vitit 2000), OSBE-ja (ndërtimi institucional) dhe BE-ja (rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik). Secila shtyllë u vendos nën autoritetin e PSSP-së. Përmes Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999), UNMIK-ut i jepet mandati që t'i "promovojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut" në Kosovë në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtarisht për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

B. Shkatërrimi i Lagjes së Romëve dhe vendosja në kampe për persona të zhvendosur brenda vendit (PZHB)

42. Më 21 qershor 1999, pas tërheqjes së forcave jugosllave, dhe ndërsa trupat e para të KFOR-it dhe personeli i UNMIK-ut po vendoseshin në Kosovë, Lagjja e Romëve në Mitrovicë ishte plaçkitur dhe djegur deri në themel nga popullata shqiptare dhe banorët e saj ishin dëbuar me forcë nën sytë e KFOR-it francez[3]. Vlerësohet se gjysma e popullatës së lagjes ia arriti të zhvendoset në vendet tjera. Ata të cilët nuk kishin mjete për t'u larguar që në fillim zunë disa ndërtesa publike në Mitrovicën veriore dhe zonat përreth.

43. Rreth 600/700 romë të zhvendosur u vendosën më vonë në kampe për PZHB në Mitrovicën veriore. Në periudhën mes shtatorit të vitit 1999 dhe janarit të vitit 2000, u ndërtuan kampe për PZHB në Zhikoc dhe Cesminluke. Kampi tjetër, Kablare, është ndërtuar në vitin 2001. Një kamp tjetër është ndërtuar në Leposaviq, përafërsisht 25 kilometra në veri të Mitrovicës. Rreth gjysma e banorëve ishin fëmijë të moshës 14 vjeç apo më të rinj.

---

[3] Shih Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, *Minoritet i braktisur. Historia e të drejtave të romëve në Kosovë*, dhjetor 2011, në f. 18, e qasur në http://www.errc.org/cms/upload/file/abandoned-minority-roma-rights-history-in-kosovo-dec-2011.pdf më 25 shkurt 2016.

44. Kampet në Zhikoc, Cesminluke dhe Kablare janë ndërtuar shumë afër minierës së Trepçës dhe kompleksit të shkritores, prodhuesja më e madhe e zinkut dhe plumbit në ish-Jugosllavi, me përafërsisht 15,000 punëtorë që ishin të punësuar në vitin 1999. Kompleksi, i cili përfshinte në zonën e Mitrovicës një shkritore të zinkut në fabrikë dhe tri diga të mëdha (që përdoreshin për të vendosur mbeturinat nga punimet minerale) e që gjendej afër kampeve, njihej të jetë si shkaktar i ndotjes së ambientit dhe kontaminimit me plumb të zonave përreth, siç dokumentohet nga studimet shkencore të kryera që nga 1970-ta.

45. Përveç problemeve të kontaminimit me plumb, kushtet e jetesës në kampe, të cilat synohej të ofrojnë vetëm akomodim të përkohshëm (45 deri 90 ditë) në varësi të negocimit të një zgjidhje të qëndrueshme për PZHB-të RAE, ishin jashtëzakonisht të rënda. Për shkak të mungesës së shpeshtë të ujit dhe drenazhit të dobët, higjiena në kampe përshkruhej të jetë tmerruese që rezultonte me sëmundje të shpeshta të banorëve. Kampet shpesh nuk ishin ujë të rrjedhshëm, rrymë, ngrohje, përkujdesje adekuate shëndetësore apo qasje në ushqim brenda kampit. Kushtet ishin veçanërisht të rrezikshme për gratë me barrë.

46. Sipas Rezolutës së KS të OKB-së 1244 (1999), UNMIK-u e kishte për obligim ta administrojë shkritoren e Trepçës në një bazë *të përkohshme*. Në gusht të vitit 2000, pasi një auditim ambiental paralajmëroi se shkritorja ishte një "burim i papranueshëm i ndotjes së ajrit" dhe pasi testimi i ushtarëve të KFOR-it francez që shërbenin afër objekteve zbuloi se niveli i plumbit në gjakun e tyre (NPGJ) ishte rritur shumë, ish-PSSP-ja, Bernard Kouchner, urdhëroi mbylljen e fabrikës si një masë emergjente shëndetësore.

47. Gjatë vitit 2000, kontingjentet e UNMIK-ut dhe KFOR-it me bazë në Mitrovicën veriore bën vlerësime të toksicitetit të dheut në dhe rreth kampeve, të cilat treguan për një nivel të lartë të kontaminimit me plumb në kampe. Kontingjentet e KFOR-it zbatuan masa për të mbrojtur personelin e tyre, duke përfshirë largimin e personelit me nivele të larta të plumbi në gjak nga zona.

48. Në nëntor të vitit 2000, UNMIK-u përgatiti një raport *"Faza e parë e projektit shëndetësor publik mbi ndotjen me plumb në rajonin e Mitrovicës"*, të përpiluar nga Sandra Moreno dhe Andrej Andrejew, i cili nuk ishte bërë publik. Duke cituar këtë dokument, Human Rights Watch (HRW) ka raportuar se në vitin 2000 kontaminimi nga plumbi në mostrat e vegjetacionit dhe dheut në Mitrovicë tejkalonte standardet e pranueshme për 176 herë në mostrat e vegjetacionit dhe për 122 herë në dhe; veç kësaj kjo dokumentonte koncentrime të larta të plumbit në pluhur (deri 4630 mg/kg)[4]. Duke iu referuar raportit të njëjtë, HRW po ashtu theksoi që, duke u bazuar në testet e gjakut të grupeve të ndryshme të popullatës në zonë, ishin regjistruar NPGJ të larta veçanërisht te romët që jetonin në kampet për PZHB[5]. Raporti përmbante disa rekomandime për UNMIK-un, duke përfshirë kryerjen e studimeve epidemiologjike dhe marrjen e rregullt të mostrave në ambient, kryerjen e monitorimit dhe trajtimit mjekësor periodik dhe sistematik të atyre që më së shumti ishin në nevojë (fëmijët

[4] Shih Human Rights Watch, *Të helmuar nga plumbi, një krizë shëndetësore dhe e të drejtave të njeriut në kampet rome të Mitrovicës*, 2009 (më pas Raporti i HRW-së), në fq. 23.
[5] *Ibid*.

dhe gratë shtatzëna) dhe vendosjen e PZHB-ve në një vend me rrezik më të ulët[6]. Në raport po ashtu paralajmërohej se kostoja e zbatimit të të gjitha atyre rekomandimeve do t'i kalonte mundësitë financiare të UNMIK-ut[7].

49. Megjithatë, në këtë kohë, UNMIK-u nuk e bëri raportin publik, nuk raportoi për situatën në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, dhe nuk u ofroi informata mbi nivelet e larta të koncentrimeve të plumbit në kampe banorëve RAE të kampeve. Nuk është ndërmarrë asnjë veprim në vitet në vijim për të trajtuar rreziqet nga ekspozimi në plumb në kampe.

50. Rastet e para simptomatike të helmimit me plumb të fëmijëve që jetonin në kampe u ishin paraqitur autoriteteve dhe medieve në fillim të vitit 2004 nga aktivistët romë. Vdekja e vajzës katërvjeçare D.M. në kampin e Zhitkovcit pasi ajo ishte diagnostikuar me helmim të gjakut, nxiti Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSH) të bëjë një vlerësim të rrezikut për shëndetin gjatë majit, qershorit dhe korrikut të vitit 2004 për të përcaktuar nivelin e të ekspozuarit të fëmijëve në metale të rënda, veçanërisht plumb, në Mitrovicë dhe Zveçan. Testet, të bëra sipas përzgjedhjes së rastit, të gjakut dhe dheut të kryera nga OBSH-ja treguan se fëmijët që jetonin në kampet për PZHB në Mitrovicë dhe Zveçan e kishin NPGJ mbi nivelet e pranueshme dhe që më shumë se 80% e dheut në kampe ishte "i pasigurt" për shkak të kontaminimit me plumb. Në korrik dhe përsëri në tetor të vitit 2004, OBSH paralajmëroi për efekte kronike të pakthyeshme të plumbit në trupin e njeriut dhe i kërkoi UNMIK-ut të evakuojë menjëherë fëmijë dhe gratë shtatzëna nga kampet (shih detaje për të gjeturat dhe rekomandimet e OBSH-së në §§ 73 dhe 76 më poshtë). Thirrje të ngjashme janë bërë më pas nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) dhe Amnesty International, të cilat publikisht kërkuan nga UNMIK-u t'i evakuojë kampet.

51. Në janar të vitit 2005, OBSH-ja së bashku me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) dhe Qendrën e Shteteve të Bashkuara për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjes (QKS), filloi me një Program për mbikëqyrjen e plumbit në gjak duke kryer rrethe periodike të testeve të gjakut për të monitoruar NPGJ-në e fëmijëve që jetonin në kampe. Rezultatet e këtyre testeve, që synohej t'u komunikoheshin vetëm familjeve, nuk u bënë publike. Nuk ka asnjë indikacion në dokumentet në posedim të Panelit nëse rezultatet e lartpërmendura iu komunikuan apo jo familjeve në fjalë.

52. Në Raportin e pestë Vjetor (11 korrik 2005), Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë po ashtu i përshkroi kushtet e jetës në kampet në Zhikoc, Kablare dhe Cesminluke si "tmerruese … që përcilleshin me varfëri, mosushqyerje dhe mungesë të higjienës elementare dhe shërbimeve shëndetësore"[8]. Institucioni i Ombudspersonit

---

[6] *Ibid*. Shih po ashtu *Raporti i Komisarit të Këshillit të Evropës për Misionin Special për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (23-27 mars 2009)*, CommDH(2009)23, Strasburg, 2 korrik 2009, në § 139; Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, *Fakte alarmuese për kampet rome në Mitrovicën veriore: Helmimi nga plumbi i fëmijëve romë*, janar 2006, i qasur në http://www.errc.org/article/alarming-facts-about-roma-camps-in-north-mitrovic%C4%82%C2%ABa-lead-poisoning-of-romani-children/2461 më 25 shkurt 2016.

[7] Raport i HRW-së, i përmendur në fusnotën 4 më lart, në ff. 5, 34 dhe 39.

[8] Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë, *Raporti i pestë Vjetor për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*, 11 korrik 2005, në f. 35.

ftoi autoritetet të trajtojnë nevojën për një evakuim urgjent të kampeve ndaras nga rindërtimi i Lagjes së Romëve i cili parashihej të zgjaste për shumë vjet.

53. Asnjë parashtresë apo dokumentacion nuk është paraqitur nga UNMIK-u që do të tregonte se çfarë veprimesh specifike ishin ndërmarrë si përgjigje ndaj paralajmërimeve të OBSH-së për rrezikun e shëndetit në kampe dhe rekomandimet e saj përkatëse. Disa dokumente në posedim të Panelit dhe në fushën publike tregojnë se në gusht të vitit 2004 12 PZHB romë ishin vendosur për dy javë në një hotel jashtë Mitrovicës me shpenzime të UNMIK-ut, ku atyre u ishte ofruar trajtim dhe ushqim më i mirë. Veç kësaj, UNMIK-u inicioi veprime sporadike rregulluese në kampin në Cesminluke – i vetmi nën administrimin e drejtpërdrejtë të Administratës së UNMIK-ut në Mitrovicë – duke përfshirë pastrimin e kampit, riparimin e objekteve sanitare dhe shpërndarjen e qumështit dhe pakove me ushqim për të luftuar ndikimin e plumbit në banorë. Duke filluar nga nëntori i vitit 2004, UNMIK-u mbajti takime me aktorët tjerë ndërkombëtarë (OBSH-në, UNHCR-në, OSBE-në, Këshillin Danez për Refugjatë) për të shqyrtuar opsionet për vendosjen e PZHB-ve në një vend të ri të pakontaminuar. Me sa duket në shkurt të vitit 2005 UNMIK-u, përmes Zyrës së vet për të Kthyerit, Komunitetet dhe Çështje të Pakicave, u takua me përfaqësuesit e PZHB-ve. Ata, unanimisht, hodhën poshtë idenë e evakuimit të kampeve, duke thënë se ata nuk ishin të gatshëm "të zhvendosen përsëri në një vend të dytë". Megjithatë, ata nuk ishin vënë plotësisht në dijeni për rreziqet që burojnë nga plumbi[9].

54. Duke filluar nga prilli i vitit 2005, u krijua i ashtuquajturi Plan për menaxhim të rrezikut nga ana e UNMIK-ut dhe u zbatua kryesisht përmes OJQ-së Këshilli Danez për Refugjatë. Plani përfshinte shpërndarjen e pakove higjienike, stufave për dru, shtojcave ushqyese dhe qasjen e përmirësuar në ujë të pastër në kampe, e cila çoi te një "përmirësim i rëndësishëm i situatës sanitare në dhe rreth kampit". Në kuadër të kësaj iniciative, disa fëmijë po ashtu u çuan për test dhe trajtim në Beograd. Megjithatë, sipas fjalëve të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë "këto masa … nuk bënë punë shumë për të trajtuar problemin real që e hasnin të gjithë banorët … derisa ata vazhdonin të jetonin në këto kampe, shëndeti i tyre do të vazhdonte të përkeqësohej"[10].

55. Në mesin e vitit 2005, UNMIK-u krijoi Ekipin për veprim në Mitrovicë (EVM), një grup punues që përbëhej nga anëtarë nga UNHCR-ja, UNICEF-i, OBSH-ja dhe OSBE-ja, për të bashkërenduar përpjekjet që kishin për qëllim zvogëlimin e ekspozimit në plumb të PZHB-ve ndërsa organizohej evakuimi i tyre nga kampet e kontaminuara. Pas negociatave të vështira, më 18 prill 2005, "Marrëveshja për kthimin në Lagjen e Romëve" ishte nënshkruar në mes UNMIK-ut, OSBE-së, UNHCR-së dhe Komunës së Mitrovicës për të mundësuar dhe përkrahur kthimin e PZHB-ve të cilët vinin nga ish-lagjja në shtëpitë e reja të ndërtuara me kontribute të donatorëve në zonën e lagjes. Asnjë përfaqësues RAE nuk u pajtua që të nënshkruajë marrëveshjen. "Projekti për kthimin në Lagjen e Romëve", një projekt i përbashkët i OKB-OJQ, parashihte vendosjen permanente të 102 familjeve, apo më shumë se 500

[9] Laurie Wiseberg, Këshilltare për të drejtat e minoriteteve, Zyra e UNMIK-ut për të kthyerit, komunitete dhe çështje të minoriteteve, Deklarata në Konferencën e OSBE-së mbi implementimin e politikave/planeve të veprimit për romët, gabelët, dhe endacakët, dhe masat ndaj fenomenit kundër romëve në Evropë, Varshavë, 20-21 tetor 2005.

[10] Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë, *Raporti i pestë Vjetor*, i përmendur në fusnotën 8 më lart, në fq. 37.

personave, të cilët do të mund të dëshmonin të drejtat e pronësisë në ish-lagjen, në shtëpitë e reja të sapondërtuara deri në fund të verës së vitit 2007. Në një konferencë ndërkombëtare të donatorëve në maj të vitit 2005, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ-të) dhe UNMIK-u u zotuan të japin 200,000 euro përkatësisht 250,000 euro për të filluar projektin, ndërsa financim i kufizuar shtesë u vu në dispozicion nga donatorët ndërkombëtarë për të filluar punën e rindërtimit në lagje. Sipas dokumenteve publike të UNMIK-ut, faza e parë e projektit, e bashkëmenaxhuar nga nënshkruesit e marrëveshjes, ka përfunduar më 30 mars 2007, me kthimin e rreth 462 personave nga kampet e PZHB-ve (si dhe nga vendet tjera ku ishin zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi) në blloqet banesore të sapondërtuara dhe të reja dhe shtëpi private[11].

56. Në ndërkohë, në dhjetor të vitit 2005, UNMIK-u mori përsipër kazermat Osterode nga KFOR-i francez, të identifikuara nga EVM si një vend i përshtatshëm për vendosje të përkohshme të PZHB-ve, pavarësisht nga ajo se ai po ashtu gjendej në afërsi të grumbujve me zgjyrë plumbi. Kampi ishte pastruar dhe rirregulluar nga UNMIK-u në pajtim me rekomandimet e QKS-së dhe një ekipi të inxhinierëve ambientalë të Armatës së SHBA-së, të cilët gjetën se kampi ishte i sigurt sa i përket plumbit. OBSH-ja po ashtu e kishte testuar kampin pas rirregullimit, duke përfunduar se kampi ishte "më i sigurt" për shkak të rrugës së shtruar me beton në kamp, mungesës së dyerve të ngjyrosura me plumb të gjetura në kampet tjera, dhe kushteve më të mira higjienike, duke përfshirë praninë e ujit të rrjedhshëm[12]. Një thirrje e përbashkët u bë nga UNMIK-u, OBSH-ja dhe UNICEF-i në shkurt të vitit 2006, në të cilën u kërkohej PZHB-ve RAE "të largohen nga kampet e ndotura me plumb në Mitrovicën veriore dhe Zveçan" dhe të vendosin familjet e tyre në kampin Osterode si "kërkesë emergjente shëndetësore", në pritje të kthimit të përhershëm të PZHB-ve në shtëpitë e tyre në lagje[13]. Sipas një njoftimi për shtyp të UNMIK-ut të datës 9 shkurt 2006, testet e gjakut të bëra në kohët e fundit nga OBSH-ja kishin konfirmuar se shumë fëmijë në Cesminluke, Kablare dhe Zhikoc kishin "nivele jashtëzakonisht të larta të plumbit në gjak". Sipas njoftimit për shtyp, një numër i masave rregulluese ishin marrë në kampe. Megjithatë, për shkak të nivelit të lartë të ndotjes "asnjë masë rregulluese në këto vende nuk mund t'i mbrojë banorët nga pasojat serioze në shëndet"; prandaj vendosja e menjëhershme në një "vend më të sigurt" ishte zgjidhja e vetme. Nën kujdesin e OBSH-së, një klinikë e vogël brenda kampit Osterode, me një mjek dhe dy motra medicinale, do të bëjë testimin e rregullt dhe do t'u ofrojë fëmijëve me nivele të larta të plumbit në gjak terapi përkatëse, një trajtim për largimin e plumbit nga gjaku e cila kërkon që pacientët të vendosen në një ambient pa plumb për rikuperim.

57. Gjatë marsit dhe prillit të vitit 2006, 593 PZHB nga kampet në Zhikoc dhe Kablare dhe një numër i vogël i banorëve nga Cesminluke, u vendosën vullnetarisht në Osterode[14]. Kampet në Zhikoc dhe Kablare më pas u mbyllën dhe u shkatërruan nga

---

[11] Shih letra e PSSP-së drejtuar Thomas Hammarberg, Komisar i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, 17 prill 2009 (në përgjigje të letrës së z. Hammarberg të datës 6 prill 2009).

[12] Shih Raport i HRW-së, përmendur në fusnotën 4 më lart, në f. 28.

[13] Shih Njoftimin për shtyp të UNMIK-ut, "UNMIK, OBSH dhe UNICEF përsërisin kërkesën për zhvendosje të menjëhershme të përkohshme të PZHB-ve romë si kërkesë emergjente shëndetësore", UNMIK/PR/1486, 9 shkurt 2006.

[14] Shih Njoftimin për Shtyp të UNMIK-ut, "PSSP-ja mirëpret fillimin e trajtimit për toksicitet nga plumbi për PZHB-të në kampin Osterode", UNMIK/PR/1577, 1 shtator 2006.

UNMIK-u. Shumica e banorëve të Cesminluke (rreth 140 PZHB) refuzuan të rizhvendosen, duke besuar se Osterode, vetëm 150 metra larg nga vendi i tyre i tanishëm, ishte i kontaminuar si Cesminluke.

58. Më 1 shtator 2006, UNMIK-u mirëpriti nisjen nga ana e OBSH-së, përmes Institutit për Shëndet Publik të Serbisë, të "trajtimit të specializuar mjekësor për helmim nga plumbi" (terapia përkatëse) në klinikën shëndetësore në Osterode. Trajtimi, i kombinuar me shpërndarjen terapeutike të ushqimit nga Norwegian Church Aid (Ndihma e Kishave Norvegjeze), OJQ-ja që menaxhonte kampin, ishte i kufizuar për fëmijët të cilit kishin ardhur nga kampet në Zhikoc, Kablare dhe Cesminluke, siç kërkohej nga OBSH-ja. Sipas standardeve të OBSH-së, terapia përkatëse nuk duhet t'u ofrohet pacientëve të cilët kthehen në një ambient të ndotur nga plumbi, meqë trupat e tyre do të absorbonin madje sasi më të mëdha të metalit duke shkaktuar rrezik më të madh për shëndetin[15].

59. Të dyja, shpërndarja e shtojcave ushqimore dhe trajtimi mjekësor në Osterode janë ndërprerë në vitin 2007 (në janar përkatësisht në tetor). Veç kësaj, situata e përgjithshme në kampe ishte përkeqësuar: marrëveshjet e sigurisë u bënë joefektive për parandalimin e aktiviteteve të shkrirjes së plumbit në vend të ngjarjes; objektet e kampit, që supozohej të pastrohen dy herë në muaj për t'i mbajtur sipërfaqet të pastra nga pluhuri i plumbit, nuk ishin pastruar me muaj për shkak të mungesës së financimit të kamionit për sjelljen e ujit.

60. Sipas UNMIK-ut, "komponentët mjekësorë" të terapisë ishin ndërprerë "pasi ishte vendosur nga OBSH-ja se nuk ishin më tutje të nevojshme"[16]. Megjithatë, dy vjet pasi ishte ndërprerë trajtimi, një grup punues i OBSH-së, ekspertë të QKS-së dhe një OJQ për të drejtat e romëve bënë një vlerësim të situatës në vend. Në njoftimin për shtyp të OBSH-së, të datës 31 janar 2009, thuhet se të dhënat e mbledhura qartas tregonin për "një zvogëlim të vazhdueshëm të niveleve të plumbit në gjak te komuniteti", me "përmirësime më të rëndësishme tek ata që ishin kthyer në Lagjen e Romëve në Mitrovicën Jugore". Megjithatë, "nivelet individuale të plumbit në gjak" ishin akoma "të larta"; për këtë arsye OBSH-ja apeloi tek "ata që akoma jetonin në kampe të përkohshme të vendosen sa më shpejt që të jetë e mundshme në një ambient pa plumb, dhe veçanërisht Cesminluke të mbyllet si një çështje emergjente" dhe që "vendi afër digave duhet të shpallet një vend i rrezikshëm për njerëzit"[17]. Në njoftimin tjetër për shtyp, të datës 9 shtator 2009, OBSH-ja shpjegoi se terapia përkatëse "nuk rekomandohet në zonat e kontaminuara" dhe sqaroi se OBSH-ja kishte përshkruar terapinë përkatëse në Osterode si një intervenim urgjent pas premtimit që "e gjithë kjo popullatë do të zhvendosej brenda gjashtë muajve", e cila nuk ndodhi. Në njoftimin e njëjtë për shtyp thuhet që OBSH-a ka "bërë thirrje vazhdueshëm për një nevojë të menjëhershme dhe urgjente për t'i evakuuar të gjithë personat romë, ashkali dhe egjiptianë të zhvendosur brenda vendit nga kampet Osterode dhe Cesmin Lug në një vend pa praninë e plumbit" meqë banorët e

---

[15] *Ibid.*

[16] Komiteti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Përgjigjet nga Qeveria e UNMIK-ut ndaj listës me çështje për t'u nisur në lidhje me vlerësimin e raportit fillestar të UNMIK-ut Dok. i OKB-së E/C.12/UNK/Q/1/Add.1, 6 tetor 2008, në § 48.

[17] Njoftimi për shtyp i OBSH-së, "KUSH kërkon më shumë përpjekje për të zvogëluar helmimin nga plumbi në kampet e përkohshme", 31 janar 2009.

kampeve "kanë helmueshmëri nga plumbi kërcënues për jetën e cila është dëshmuar përmes të të gjeturave laboratorike dhe klinike"[18].

61. Pas mbylljes së klinikës në Osterode, në vitin 2008 mjekë të pavarur kryen në Mitrovicë testim të mëtejmë me kërkesën e udhëheqësve RAE dhe OJQ-ve dhe gjetën nivel të lartë të vazhdueshëm të kontaminimit. Raportet nga disa prej këtyre testeve i janë paraqitur Panelit nga përfaqësuesja ligjore e ankuesve (shih § 113 më poshtë).

62. Pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga autoritetet e Kosovës, në maj të vitit 2008 përgjegjësia e mbikëqyrjes për kampet Osterode dhe Cesminluke u transferua nga UNMIK-u te Ministria e Kosovës për Komunitet dhe Kthim e IPVQ-ve. Kampet u mbyllën përfundimisht në tetor të vitit 2010 (Cesminluke), dhjetor 2012 (Osterode) dhe dhjetor 2013 (Leposaviq).

C. Kontaminimi me plumb në Mitrovicë dhe kampet për PZHB

63. Paneli shqyrtoi dhe e ka parasysh një pjesë të mirë të literaturës përkatëse lidhur me efektet e kontaminimit nga plumbi, duke përfshirë kampet.

1. Burimet, efektet dhe trajtimi i helmimit nga plumbi

64. Plumbi është një metal i rëndë tepër toksik përdorimi i gjerë i të cilit ka shkaktuar ndotje ambientale dhe problem shëndetësore në shumë pjesë të botës[19]. Plumbi, i cili gjendet në ambient kryesisht si sulfur plumbi, është shpërndarë gjerësisht në biosferë vetëm gjatë pak mijëvjeçarëve të kaluar, kryesisht si rezultat i aktivitetit të njeriut. Për shkak se e ka një pikë të ulët të shkrirjes dhe mundet lehtësisht të përshtatet dhe kombinohet me metale tjera, plumbi përdoret në një varg produktesh. Sot, burimet kryesore të të ekspozuarit në plumb përfshijnë: plumbi që i shtohet benzinës; plumbi nga një industri aktive, sikur punimet minerale (veçanërisht në dhe); ngjyrat dhe pigmentet me bazë plumbin; bashkuesi i plumbit në kuti ushqimi; sistemet e ujit të pijshëm me bashkues plumbi dhe gypa plumbi; shkrirja dhe riciklimi i mbeturinave që përmbajnë plumb siç janë akumulatorët; kontaminimi nga plumbi si trashëgimi e kontaminimit real nga ish-vendet industriale; plumbi në zinxhirin e ushqimit, përmes dheut të kontaminuar; plumbi në mbeturinat elektronike. Faktorët socio-ekonomikë ndikojnë shumë në ekspozimin ndaj plumbit, meqë familjet e varfra ka më shumë të ngjarë të jetojnë afër kompleksëve industriale, të banojnë në vende të ndotura, të punojnë në industri ndotëse apo të jetojnë në shtëpi më të vjetër me ngjyrë me bazë plumbin. Veç kësaj, ushqimet me mungesa hekuri të varfëruar apo kalciumi ndihmojnë absorbimin e plumbit, veçanërisht nga fëmijët

65. Plumbi hyn në trupin e njeriut përmes inhalacionit apo ngrënies së ushqimit apo ujit nga një dhe i kontaminuar me plumb dhe ai akumulohet në tru, mëlçi, veshkë, eshtra

---

[18] Njoftimi për shtyp i OBSH-së, "OBSH insiston edhe një herë se zgjidhja e vetme në kampet për PZHB-të në Mitrovicën veriore ku jetojnë romët, ashkalitë dhe egjiptianët duke iu ekspozuar plumbit kërcënues për jetën është evakuimi i tyre i menjëhershëm", shtator 2009.

[19] Referencat e marra nga Paneli për përgatitjen e këtij seksioni përfshijnë: OBSH, *Helmimi i fëmijëve nga plumbi*, Gjenevë, 2010; QKS, *Parandalimi dhe trajtimi i helmimit nga plumbi. Rekomandime për fëmijët refugjatë*, Të dhëna mjekësore të bazuara në fakte, 24 shtator 2012; QKS "Nivelet e plumbit në gjak te fëmijët e moshës nga 1-5 vjeç, Shtetet e Bashkuara, 1999-2010", *Raport javor për sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë*, vëll. 62, nr. 13, 5 prill 2013, në ff. 245-248; OBSH, *Helmimi nga plumbi dhe shëndeti*, Të dhëna me fakte nr. 379, rishqyrtuar në tetor të vitit 2014.

dhe dhëmbë. Niveli i ekspozimit në plumb vlerësohet kryesisht përmes përcaktimit të koncentrimit të plumbit në gjak, megjithëse ekzaminimi i flokut, dhëmbëve, eshtrave dhe urinës mundet gjithashtu të zbulojë helmimin nga plumbi. Në vitin 1991, QKS-ja e SHBA-së dhe OBSH-ja përcaktuan 10 µg/dL (mikrogram *për* decilitër) si prag i sigurisë mbi të cilin NPGJ mund të paraqesë arsye për "shqetësim". Megjithatë, studimet e kohëve më të fundit thonë se asnjë nivel i plumbit në gjak nuk është i sigurt[20]. Helmimi nga plumbi mund të ketë efekte negative në pothuaj çdo organ të trupit. Organet kryesore të prekura janë sistemi nervor qendror dhe periferik, veçanërisht te fëmijët, dhe sistemet kardiovaskulare, gastrointestinale, renale, endokrine, të imunitetit reproduktiv dhe ato hematologjike. Ekspozimi i gjatë dhe në shkallë të lartë në plumb mund të shkaktojë simptome siç janë dhimbje barku, kolike (*drejtuara kah barku*), të vjella, kapsllëk, lodhje, anemi dhe efekte neurologjike nga koncentrimi i dobët deri te mpirja dhe, në rastet më të rënda, encefalopati, komë dhe konvulsione. Prania në sasi të ulët e hekurit në nivele gjaku, që është menduar më parë të jetë e sigurt, ka efekte të dëmshme afatgjata në sisemet e imunitetit, reprodukuese dhe kardiovaskulare. Është e ditur se, ndërsa prania rritet, shtrirja dhe vrazhdësia e shfaqjes së simptomave po ashtu rritet.

66. Paneli e ka parasysh literaturën mjekësore në të cilën thuhet se të vegjlit, fëmijët deri në moshën pesë vjeç dhe gratë shtatzëna janë në rrezikun më të madh nga prania e plumbit dhe janë më të cenueshëm nga efektet e tij toksike. Të ekspozuarit e grave shtatzëna në nivele të larta të plumbit mund të shkaktojë dështim, lindje të frytit të vdekur, lindje të parakohshme dhe peshë të vogël pas lindjes si dhe deformitete të vogla[21]. Fëmijët janë në rrezikun më të lartë kur i ekspozohen plumbit sepse ata i ekspozohen plumbit gjatë gjithë shtatzënisë (plumbi i akumuluar në trupin e nënës kalon te fëmija); ata absorbojnë 4-5 herë më shumë plumb nga ajo që marrin të rriturit; kanë kuriozitet të lindur ta eksplorojnë botën me gojën e tyre e cila rezulton në marrjen e objekteve të mbuluara me plumb apo dheut dhe pluhurit të kontaminuar; kalojnë më shumë kohë në një ambient të vetëm, ka më shumë të ngjarë të kenë mungesa ushqimi e cila e lehtëson absorbimin e plumbit; dhe u mungon kontrolli mbi ambientin përreth[22]. Efektet e zakonshme dhe të njohura mirë të helmimit nga plumbi te fëmijët përfshijnë sistemet gastrointestinale dhe nervore. Sipas OBSH-së, simptomat gastrointestinale mund të jenë të pranishme te NPGJ që janë të ulëta deri në 20 µg/dL, megjithëse ato janë më të zakonshme te fëmijët me NPGJ që është më i lartë apo baras me 50 µg/dL. Plumbi është veçanërisht i dëmshëm në zhvillimin e trurit dhe sistemit nervor të fetusit dhe fëmijëve të rinj. Hulumtimet e fundit tregojnë se plumbi mund të shkaktojë sjellje neurotike te fëmijët në nivelet e plumbit prej 5 µg/dL dhe madje edhe më të ulët, pasi "duket të mos ketë asnjë prag nën të cilin plumbi nuk shkakton dëm për zhvillimin e trurit të njeriut". Pasojat në trurin e fëmijëve që shkaktohen për shkak se iu kanë ekspozuar plumbit përfshijnë humbjen e inteligjencës, shkurtimin e kohës së vëmendjes dhe sjellje përçarëse. Efektet tjera që fillojnë në nivele të ulëta të plumbit në gjak përfshijnë: shtat apo rritje e zvogëluar, mprehtësi e zvogëluar e të dëgjuarit, dhe aftësi e dobësuar për të mbajtur qëndrim apo

[20] Helen Gavaghan, "Plumbi, i pasigurt në çdo nivel", *Buletin i Organizatës Botërore të Shëndetësisë*, vëll. 80, nr. 1, 2002, i qasur në http://www.who.int/bulletin/archives/80%281%2982.pdf më 25shkurt 2016; shih po ashtu publikimet e OBSH-së të përmendrua në fusnotën 19 më lart.
[21] OBSH, *Helmimi nga plumbi dhe shëndeti*, përmendur në fusnotën 19 më lart.
[22] OBSH, *Helmimi i fëmijëve nga plumbi*, përmendur në fusnotën 19 më lart, në f. 21.

zhvillim të drejtë[23]. Në nivele të larta (më të larta se 100 µg/dL) fëmijët mund të përjetojnë shenja encefalopatie, duke përfshirë ndryshime të vërejtura në aktivitetin mental, ataksi, kriza, komë dhe madje vdekje. Efektet neurologjike dhe ato në sjellje nga plumbi besohet të jenë të pakthyeshme. Helmimi nga plumbi është, në pjesën më të madhe, asimptomatik; mungesa e simptomave të hapura, megjithatë, nuk përjashton rrezikun se fëmija i është ekspozuar dëmtimit të vazhdueshëm të sistemit nervor. Për këtë arsye, matja venoze e plumbit në gjak është mënyra më e besueshme për të diagnostikuar helmimin nga plumbi[24].

67. Paneli vëren që literatura mjekësore është me sa duket konsistente në atë se, sapo të jetë diagnostikuar helmimi nga plumbi, hapi më i rëndësishëm në trajtim është të parandalohet të ekspozuarit e mëtejmë duke larguar burimin e të ekspozuarit nga ambienti dhe/apo vendosja në një vend tjetër e pacientëve. Terapia përkatëse është trajtim që zakonisht përdoret për të zvogëluar koncentrimet e plumbit në gjak në rastet më të rënda të helmimit nga plumbi. Gjatë terapisë përkatëse -një proces që zgjatë dy apo tri orë- mund të ndihmojnë disa agjentë për largimin e plumbit, përmes gojës apo injeksioneve intravenoze, për të lidhur plumbin (si dhe metalet tjera të rënda) në sistemin e qarkullimit të gjakut, duke formuar një përbërje e cila pastaj hiqet nga trupi. Pasi trajtimi përkatës mundet po ashtu të shterojë elemente të dobishme në trup, siç janë hekuri, zinku, dhe bakri, shtojcat ushqimore dhe vitaminat rekomandohet të merren gjatë trajtimit. Sipas QKS-së – e cila rekomandon terapinë përkatëse (chelation) t'u jepet fëmijëve me koncentrime të plumbit në gjak baras apo mbi 45 µg/dL – terapia mund të mos jetë plotësisht efektive veç në rast se ekspozimi ndaj plumbit zvogëlohet. Në të kundërtën, agjentët që largojnë plumbin munden në fakt të lehtësojnë absorbimin e plumbit në traktin gastrointestinal[25].

2. OBSH, QKS dhe dokumentacioni tjetër për kontaminimin nga plumbi në Mitrovicën veriore dhe kampet për PZHB-të

68. Paneli thekson numrin e analizave dhe studimeve të kryera që nga fundi i viteve 1970-ta nga Divizioni i Epidemiologjisë dhe Shëndetit Publik i Universitetit Kolumbia (Shtetet e Bashkuara), të cilat dokumentuan nivele të larta të ndotjes ambientale dhe kontaminimit nga plumbi në zonën përreth Minierës Trepça dhe kompleksit të shkritores në Mitrovicën veriore. Në mesin e tyre, në studim i titulluar *Mbi Përcaktuesit e Plumbit të Ngritur në Gjak gjatë Shtatzënisë në një Popullatës Përreth një Shkritoreje të Plumbit në Kosovë, Jugosllavi* (1990), zbuloi se gratë shtatzëna në Mitrovicë kishin nivele dukshëm më të ngritura të plumbit në gjak (86% prej tyre kishin NPGJ më të lartë se 10 µg/dL, krahasuar me 3.4 % të grave shtatzëna në Prishtinë). Studimi potenconte se "zona e banimit ishte parashikuesi më i rëndësishëm" i NPGJ të ngritur te nëna pasi koncentrimi i plumbit "zbriste ndërsa distanca nga shkritorja te shtëpia rritej". Faktorët tjerë që ndikojnë në ngritjen e NPGJ ishin: punësimi i burrit në industrinë e plumbit; grupi etnik i familjes (është gjetur se

[23] *QKS, Parandalimi dhe trajtimi i helmimit nga plumbi. Rekomandime për fëmijët refugjatë*, përmendur në fusnotën 19 më lart.
[24] OBSH, *Helmimi i fëmijëve nga plumbi*, përmendur në fusnotën 19 më lart.
[25] Departamenti i Shëndetit dhe Shërbimeve Humane i SHBA-së, Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjes, Qendra Nacionale për Shëndet Ambiental, Agjencia për Substanca Toksike dhe Regjistër të Sëmundjes, Divizioni i Emergjencës dhe Shërbimeve Shëndetësore Ambientale, *Krijimi i një plani të integruar për intervenim për të zvogëluar ekspozimin ndaj plumbit dhe kontaminuesve tjerë në Qendrën Minerale La Oroya, Peru*, maj i vitit 2005, e qasur në http://www.cdc.gov/nceh/ehs/docs/la_oroya_report.pdf më 25 shkurt 2016.

gratë shqiptare e kishin NPGJ më të ulëtin sigurisht për shkak të zakonit të tyre për t'i zbathur këpucët në hyrje të shtëpisë, e cila parandalon që dheu i kontaminuar të sillet brenda); faktorët ushqyes.

69. Duket se testet ambientale ishin kryer menjëherë pas arritjes së UNMIK-ut në Kosovë në qershor të vitit 1999. Në gusht të vitit 2000, UNMIK-u urdhëroi mbylljen e Shkritores Trepça. Në një njoftim për shtyp të UNMIK-ut të lëshuar më 14 gusht 2000 thuhet:

> "Populli i Mitrovicës është në rrezik për shkak të kësaj shkritoreje", tha PSSP-ja Bernard Kouchner. "Si mjek, si dhe si administrator kryesor i Kosovës, unë do ta braktisja rrugën nëse do ta lejoja të vazhdojë ky kërcënim për shëndetin e fëmijëve dhe grave shtatzëna madje edhe për një ditë më shumë.
>
> Testet e fundit tregojnë se nivelet e tanishme të ekspozimit ndaj plumbit arrijnë tek ato më ekstremet gjatë dekadave. Nivelet e plumbit atmosferik të matur muajin e kaluar [në korrik të vitit 1999] ishin rreth 200 herë më lart se standardet e pranueshme të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Shkritorja ka punuar kohë pas kohe që nga konflikti i vitit 1999 në Kosovë. Megjithatë, një kontroll i ambientit i urdhëruar nga UNMIK-u dhe i kryer në mars dhe prill të këtij viti, paralajmëroi se ajo duhet mbyllur si një "burim i papranueshëm i ndotjes së ajrit". Gjashtë javë pasi rifilluan operacionet ditore të shkrirjes në muajin qershor, testet e ushtarëve të KFOR-it që shërbenin afër shkritores zbuluan nivele të rritura dukshëm të pranisë së plumbit në gjak. Testet franceze të plumbit atmosferik të bëra në qershor-korrik treguan nivele mesatare prej 250 mikrogramë për metër kub, dy të tretat më të lartë se limitet që lejohen për t'iu ekspozuar në Francë. UNMIK-u menjëherë dërgoi specialistë mjekësorë dhe të shëndetësisë publike si dhe një ekip ndërkombëtar epidemiologjik në rajonin e Mitrovicës. Javën e kaluar UNMIK-u filloi një fushatë mbi shëndetin publik për t'i informuar banorët … për nivelet në rritje të plumbit; për të matur më tutje nivelin e plumbit …; dhe për të ofruar testim, këshillim dhe trajtim mjekësor"[26].

70. Specialistë mjekësorë dhe të shëndetit publik u vendosën më pas nga UNMIK-u në Mitrovicë. Në nëntor të vitit 2000, një raport i porositur nga UNMIK-u me titull *"Faza e parë e projektit shëndetësor publik mbi ndotjen me plumb në rajonin e Mitrovicës"* është përgatitur por kurrë nuk është bërë publik. Siç thuhet në § 48 më lart, sipas HRW, ky raport konfirmonte se, duke u bazuar në analizën e mostrave të pluhurit, dheut dhe vegjetacionit të mbledhura në rajon, niveli i kontaminimit nga plumbi në Mitrovicë tejkalonte standardet e pranueshme për 176 herë në mostrat e vegjetacionit dhe 122 herë në mostrat e dheut. Koncentrim i madh i plumbit ishte regjistruar po ashtu në pluhur. Në raport po ashtu thuhej se, duke u bazuar në testet e gjakut të grupeve të ndryshme të popullatës në zonë, ishte regjistruar veçanërisht NPGJ i lartë te komuniteti RAE që jetonin në kampet për PZHB-të të ndërtuara nga UNHCR-ja që nga viti 1999 dhe thuhej se nivelet e kontaminimit ishin "më të larta te romët sesa te personat që nuk ishin romë". Faktorë tjerë të rrezikut të identifikuar në raport ishte punësimi i mëparshëm në Trepçë dhe afërsia e objekteve të saj. Me sa duket ky raport përmbante rekomandimin që kampet për PZHB-të të vendosen në një zonë me rrezik më të ulët.

---

[26] Njoftimi për shtyp i UNMIK-ut, UNMIK/PR/312, 14 gusht 2000.

71. Siç dokumentohet në studimet pasuese, kontaminimi nga plumbi në Mitrovicë vazhdoi me vite pas mbylljes së shkritores së Trepçës, që vinte kryesisht nga grumbujt e pakontrollueshëm të mbeturinave dhe digat në të cilat krijohej erozion nën ndikimin e erës dhe ujit si dhe nga pajisja e kontaminuar, ndërtesat dhe dheu i lënë pas nga operacionet e mëparshme[27].

72. Nga maji deri në korrik të vitit 2004, pas raportimeve të aktivistëve për të drejtat e romëve për raste simptomatike të helmimit nga plumbi, duke përfshirë vdekjet e fëmijëve në kampe, OBSH bëri një vlerësim të rrezikut për shëndetin për të përcaktuar shtrirjen dhe rrugët e ekspozimit të fëmijëve në komunat në Mitrovicën Veriore dhe Zveçan në metale të rënda, veçanërisht plumb, që ishin të pranishme në ambient. Për këtë qëllim, OBSH, mori mostra në ambient, bëri test të gjakut dhe ekzaminime fizike dhe psikologjike në një grup të synuar prej 58 fëmijëve të moshës 24 deri 36 muaj, të gjitha të konceptuara pas mbylljes së Shkritores Trepça. Rezultatet e vlerësimit gjenden në *Raportin Preliminar të OBSH-së mbi Nivelet e Gjakut në Mitrovicën veriore dhe Zveçan* (korrik 2004) në të cilin thuhet:

> "Sipas institucioneve shëndetësore, përafërsisht 150 fëmijë … janë duke jetuar brenda kësaj zone të caktuar. Ne kemi marrë mostër prej gjithsej 58 fëmijëve dhe 34 nga ta kanë nivele mbi të pranueshmet. Kjo paraqet 58.6 % të numrit të përgjithshëm të atyre nga të cilët është marrë mostër.
>
> Te dymbëdhjetë (12) fëmijë janë gjetur nivele jashtëzakonisht të larta. Gjashtë nga ta me sa duket hyjnë në kuadër të asaj çfarë është përshkruar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Substanca Toksike dhe Regjistër të Sëmundjes (ASTRS) se përbën një emergjencë mjekësore (≥ 70 µg/dL). (Instrumentet tona janë në gjendje të regjistrojnë vetëm 65 mikrogramë për decilitër).
>
> Këta 12 fëmijë të gjithë jetojnë në kampet rome ku është duke u bërë apo është bërë shkrirja në një shkallë të ulët.
>
> Ne presim të shohim nivele të ngritura të plumbit në gjak në grupmoshat e tjera të fëmijëve.
>
> […]
>
> Pa rezultate të mostrave të marra në ambient ne vetëm mund të dyshojmë se aktivitetet e shkrirjes në kampe krijojnë këto nivele të larta dhe të rrezikshme të plumbit në gjak pasi ky është ndryshimi kryesor sa i përket të ekspozuarit me pjesën tjetër të grupit të marrë si mostër në zonën e Mitrovicës dhe Zveçanit. Arsye tjetër të mundshme paraqesin trajtimet e tyre lokale, ku plumbi i shkrirë hedhet në gotë të ujit …, megjithëse kjo ka më pak të ngjarë të ndodhë pasi të gjithë fëmijët në kampe kanë nivele të larta."

73. Në raport thuhet se situata kërkon një përgjigje urgjente duke përfshirë: mbylljen e menjëhershme të shkritores së hapur në kampin e PZHB-ve në Zhikoc dhe largimin e

[27] Shih për shembull, Programi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ambientin (UNEP), *Rast studimor mbi kontaminimin nga plumbi dhe metalet e rënda në Mitrovicë, Kosovë*, Gjenevë/Amsterdam, nëntor 2010.

pluhurit dhe dheut në afërsinë e drejtpërdrejtë të shkritores në Zhikoc dhe digës; hetimi për aktivitete të mundshme të shkrirjes në kampe dhe ndalimi i tyre; sigurimi i qasjes në ujë të pastër si masë preventive në kampin në Zhikoc, meqë banorët ankohen se ai është ndalur; largimi i menjëhershëm nga kampet, derisa të konfirmohen rezultatet, i grave shtatzëna dhe fëmijëve deri gjashtë vjeç për t'i dërguar "në një zonë të pastër si masë parandaluese". Autori i raportit, epidemiolog i OBSH-së për ambientin, përfundoi:

> "Unë nuk e rekomandoj këtë lehtë. Kjo është një masë standarde për të parandaluar të ekspozuarit e vazhdueshëm të njerëzve dhe këto nivele tepër të larta të plumbit në gjak paraqesin rrezik real për encefalopati dhe vdekje të mundshme".

74. Më 22 tetor 2004, OBSH ia dërgoi UNMIK-ut Raportin e dytë mbi *konfirmim për plumb në kapilar të gjakut dhe situata shëndetësore kritike e lidhur me plumbin e fëmijëve të kampeve rome*, i cili konfirmoi rezultatet e testit të gjakut të korrikut të vitit 2004 [me një shkallë saktësie prej +/- 14.5 %] dhe identifikoi kontaminimin e dheut në kampe. Në raport thuhet:

> "Mostrat e gjakut në vena ishin marrë nga fëmijët që kishin nivele gjaku në kapilar mbi 15 µg/për decilitër dhe për secilin fëmijë të 10-të në popullatën mostër … Ne sapo kemi pranuar disa nga rezultatet … Këto rezultate konfirmojnë rezultatet e ekzaminimit lokal të kapilarëve të gjakut të qershorit dhe korrikut të vitit 2004 dhe ngritin shqetësime për një ndikim më të madh nga ai që ishte menduar fillimisht. Për shkak të mungesës së gatishmërisë prindërore për të dhënë gjakun nga venat në Zveçan, Mitrovicën veriore dhe te komuniteti rom, janë marrë vetëm gjashtë mostra nga venat nga lagjet në vend të 24 mostrave. Nga ato gjashtë të mbledhurat, tre ishin fëmijë romë dhe të gjitha tri rezultatet erdhën nga RIVM [laborator në Holandë] me nivelet më të larta nga e gjithë popullata e marrë si mostër – njëri kishte 74.4 µg/dL në gjak, njëri kishte 58.5 dhe njëri kishte 37.4 µg/dL në gjak."

75. Sa u përket mostrave ambientale, në raport thuhet:

> "Mostra dheu ishin marrë nga shtëpitë e fëmijëve në vendin e tyre ku luanin dhe nga kopshte me bimë. Gjithsej 49 mostra janë marrë në Zveçan, Mitrovicën veriore dhe jugore. Vetëm 13 nga mostrat janë brenda limiteve të sigurta për dhe në vend banimi dhe që përdoret në bujqësi. […]
>
> 17 nga 49 mostra dheu janë marrë nga dy kampe rome (8 nga Cesminluke dhe 9 nga Zhitkovci). Nga këto 17, vetëm dy prej tyre janë brenda limitit të pikës prej 450 mg/kg që konsiderohet e sigurt për banim, kopshtari dhe kopsht të fëmijëve. Prandaj, përfundimi është që 88.23 % e dheut në të dy kampet është i pasigurt për t'u shfrytëzuar për banim nga njerëzit dhe për kopshtari."

76. Raporti, përsëri, adreson disa rekomandime për autoritetet duke përfshirë: "largimin e menjëhershëm të fëmijëve (0-6 vjeç) dhe grave shtatzëna; zhvendosjen e përkohshme, në pritje të një zgjidhjeje të qëndrueshme, për zhvendosjen e përhershme të kampeve" (Cesminluke dhe Zhikoc); "vlerësim emergjent mjekësor (hospitalizim dhe trajtim i menjëhershëm) i fëmijëve me NPGJ më të lartë se 70

mg/dL"; analizë dhe trajtim mjekësor i fëmijëve NPGJ i të cilëve ishte 30 mg/dL dhe më i lartë; ritestimi në bazë javore i fëmijëve me NPGJ prej 10 mg/dL dhe më i lartë dhe ofrimi i trajtimit për ata që tregojnë nivele të larta dhe të vazhdueshme. Në raport po ashtu rekomandohet që "të fillojë menjëherë edukimi përmes ofrimit të këshillës, vlerësimi i ushqyerjes dhe intervenimit, hulumtimi ambiental dhe referimi publik shëndetësor për menaxhim të rastit dhe ekzaminimi psikologjik për publikun e gjerë". Në përfundim të raportit thuhet:

> "Mendimi ynë profesional është se rasti i romëve është urgjent. Jetët e fëmijëve dhe potencialet për zhvillim janë në rrezik. Fëmijëria e tyre rrezikohet, pavarësisht nga ajo se këta fëmijë kanë të drejtën fundamentale të njeriut për shëndet të mirë. Një veprim i shpejtë dhe i bashkërenduar është skajshmërisht i nevojshëm"[28].

77. Me kërkesën e OBSH-së dhe UNICEF-it, QKS e SHBA-së bëri një vlerësim të situatës në kampe në vitin 2007. Në raportin e QKS-së "*Rekomandimi për parandalimin e helmimit nga plumbi të popullatës rome të zhvendosur brenda vendit në Kosovë të Qendrës për Kontroll dhe Parandalim të Sëmundjes*" (tetor 2007), lidhur me programin e mbikëqyrjes të plumbit në gjak i përgatitur së bashku nga këto tri institucione thuhet:

> "Në 3 rrethet e fundit të testit për plumb në gjak, të bëra në mes vitit 2005 dhe 2007, mesatarisht, 30% e fëmijëve kishin nivele plumbi në kapilarë gjaku prej > 45 µg/dL, nivel në të cilin QKS rekomandon terapinë përkatëse. Pak, nëse ndonjë, fëmijë në kampe kanë mbajtur një nivel të plumbit në gjak prej < 10 µg/dL për krejt fëmijërinë e tyre. Këta fëmijë janë në rrezik të madh që të kenë gjithë jetën paaftësi në zhvillim dhe në sjellje dhe gjendje të tjera të këqija shëndetësore[29]. […]
>
> Të dhënat për NPGJ u janë raportuar prindërve por nuk janë paraqitur zyrtarisht nga OBSH-ja për shkak se interpretimi i këtyre të dhënave është i vështirë për shkak të mbledhjes jo të standardizuar, vendosjes së familjeve në kampe dhe në lagje dhe anësive në përzgjedhje[30].

78. Raporti i lartpërmendur, po ashtu, përmban një vlerësim të nivelit të kontaminimit me plumb në Cesminluke dhe Osterode – dy kampet e mbetura për PZHB pranë Kompleksit Trepça pasi ishin shkatërruar ato në Kablare dhe Zhikoc në vitin 2006 – si dhe të vendit Lagjja e Romëve, ku ishin vendosur familjet e para të PZHB-ve duke filluar nga pranvera e vitit 2007. Në raport thuhet:

> "Cesmin Lug: Ky kamp i ka së paku 4 burime ku fëmijët i ekspozohen plumbit. 1) Kampi është në drejtimin e erës që vjen nga mbeturinat minerale të plumbit, duke ngritur nivelet e plumbit në dheun dhe ajrin e ambientit. 2) Ka dëshmi për

---

[28] Me sa duket asnjë test i gjakut nuk është kryer në kampin Kablare megjithëse shumë fëmijë atje, po ashtu, tregojnë simptoma të helmimit me plumb, siç janë humbje e kujtesës, humbje e bashkërendimit, të vjellat dhe konvulsionet (shih Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, *Fakte alarmuese rreth kampeve rome në Mitrovicën veriore: Helmimi me plumb i fëmijëve romë*, përmendur në fusnotën 6 më lart).

[29] QKS, Rekomandime për parandalimin e helmimit nga plumbi të popullatës rome të zhvendosur brenda vendit në Kosovë të Qendrës për Kontroll dhe Parandalim të Sëmundjes, 27 tetor 2007, në f. 3.

[30] *Ibid*., në f. 7.

aktivitet joformal të shkrirjes së plumbit në kamp … Zonat e djegies që janë afër shtëpive janë padyshim të kontaminuara rëndë. Fëmijët luajnë në këto vende, dhe pluhuri bartet në shtëpi nga fëmijët dhe të rriturit, veçanërisht nga ata që nuk mbathin këpucë. 3) Shumë korniza dyersh dhe dritare janë ngjyrosur me ngjyrë plumbi dhe ajo ngjyrë është tepër e dobësuar dhe ka filluar të ndahet. 4) Ka dëshmi të kohës së fundit për shkrirje joformale të plumbit në kampin e vjetër Kablar i cili është afër Cesmin Lug… Megjithatë, tymi dhe pluhuri nga shkrirja e plumbit mund të barten në shtëpi nga personat të cilët janë të përfshirë në këtë dhe e kontaminojnë ambientin shtëpiak.

Osterode: Ky kamp i ka së paku 2 burime ku fëmijët i ekspozohen plumbit. 1) Kampi është në drejtimin e erës që vjen nga mbeturinat minerale të plumbit, duke ngritur nivelet e plumbit në dheun dhe ajrin e ambientit. 2) Individë në Osterode mund të jenë, po ashtu, të përfshirë në shkrirje joformale të plumbit në kampin e vjetër Kablar … Megjithatë, në vitin 2006 vendi është inspektuar nga z. Brooks, një inspektor i licencuar për plumb nga QKS-ja. Është gjetur që vendi është i sigurt nga plumbi. Rekomandimet për mbajtjen e sigurisë nga prania e plumbit ─ duke përfshirë pastrimin ditor të sipërfaqeve të shtruara ─janë në vend dhe ishin të dukshme gjatë vizitës në qershorin e vitit 2007. Përveç kësaj, familjet në Osterode vizitohen nga edukatorët (asistentë) për shëndetin të cilët potencojnë nevojën që familjet t'i implementojnë masat për ta zvogëluar kontaminimin nga plumbi duke përfshirë zbathjen e këpucëve kur hyhet në shtëpi dhe mbajtjen e higjienës së mirë. Këto aktivitete ishin po ashtu në dëshmi gjatë vizitës në vend në qershorin e vitit 2007.

Lagjja e Romëve: Në lagje nuk ka burime të dukshme për t'iu ekspozuar plumbit. Drejtorët e Trepçës e informuan QKS-në se në të kaluarën lagjja ishte ndoshta zona më së paku e kontaminuar në Mitrovicë …".

79. Rekomandimi i dhënë nga QKS për UNMIK-un dhe agjencitë tjera relevante përfshinin mbylljen e menjëhershme të Cesminluke dhe vendosjen e banorëve të saj në Osterode, e synuar të jetë një "zonë në kuadër të fazës" për lagjen; shkatërrimi i vendqëndrimeve pasi ato të ishin zbrazur për të parandaluar vendosjen e familjeve tjera; krijimi i një programi për riciklimin e akumulatorëve për të parandaluar shkrirjen joformale; publikimin e gjithë mbikëqyrjes së plumbit në gjak dhe të dhënave të trajtimit si dhe të dhënave ambientale për të siguruar monitorim efektiv dhe transparent; ofrimi i trajtimit adekuat mjekësor për ata me NPGJ të ngritur.

80. Në vitin 2011, QKS bëri një vlerësim të situatës pasi u intensifikuan përpjekjet për të vendosur PZHB-të në Lagjen e Romëve dhe pasi kampi në Cesminluke ishte shkatërruar në shtator të vitit 2010. Në raportin e vitit 2011 thuhet që kampi Osterode, i banuar nga 80 familje të PZHB-ve në vitin 2010 ishte gjetur aktualisht të jetë "larg nga të qenit pa plumb", me "dhe që përmbante nivele të papranueshme të plumbit". Në raport po ashtu thuhet që një rreth tjetër i testimit ishte bërë në dhjetor të vitit 2010 në 45 fëmijë në "Ambulancë" në Lagjen e Romëve. Në mesin e tyre, 16 % kishin NPB ≥ 45 μg/dL; 49% kishin NPB 20-44 μg/dL, 24% kishin NPB 10-19 μg/dL; dhe vetëm 11 % kishin NPB nën 10 μg/dL[31].

[31] QKS, *Vlerësim dhe rekomandime për parandalimin e helmimit nga plumbi të popullatës rome të zhvendosur brenda vendit në Kosovë të Qendrës për Kontroll dhe Parandalim të Sëmundjes*, 10 janar 2011.

81. Kontaminimi nga plumbi dhe metalet e rënda në Mitrovicë dhe efektet e tij negative në shëndetin e njeriut janë dokumentuar në studimet e mëtejme, duke përfshirë një raport të UNEP-it në *"Rastin studimor dhe kontaminimi me plumb dhe metale të rënda në Mitrovicë, Kosovë"* (përmendur në fusnotën 27 më lart), në të cilin po ashtu thuhet që popullata RAE e kampeve për PZHB-të i ishte ekspozuar një rreziku të lartë nga kontaminimi për shkak të afërsisë së madhe të kampeve dhe materialit me mbeturina të kontaminuara e të pasigurta dhe për shkak të vetë kushteve elementare të jetës në kampe.

D. Kushtet e jetës, higjienike dhe shëndetësore në kampet për PZHB

82. Kushtet e përgjithshme të jetës në kampe, siç është dokumentuar, ishin shumë të vështira. OJQ-të për të drejtat e njeriut (sikur HRW), institucionet lokale për të drejtat e njeriut (kryesisht Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë) dhe OKB-ja dhe mekanizmat evropianë për monitorimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë traktatet dhe organet e OKB-së dhe raportuesit specialë, si dhe Komisarin për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës (CoE-KiE), të cilët i kanë vizituar dhe monitoruar kampet që nga viti 2005, e përkufizuan situatën në kampet RAE si problemin më serioz humanitar dhe ambiental në Evropë[32] .

83. Disa raporte dhe dokumente përshkruajnë kushtet e banimit dhe jetesës në kampe si "nën standarde", "veçanërisht shqetësuese"[33], dhe "të tmerrshme … të përcjella nga varfëria, kequshqyerja dhe mungesa e higjienës dhe shërbimeve mjekësore më elementare"[34]. Në vitin 2008 (që do të thotë dy vjet pasi kampet Kablare dhe Zhikoc ishin mbyllur), HRW dokumentoi akomodimin në kampin Cesminluke që përbëhej nga shtëpiza të vogla të punuara nga dërrasa druri (shpesh dërrasa të ngjyrosura plumbi të dorës së dytë), pa izolim (apo izolim nga kartoni) dhe pa ngrohje. Higjiena ishte çështja kryesore në këtë kamp, për shkak të mungesës së ndonjë sistemi të kanalizimit apo ujit të rrjedhshëm brenda shtëpizave (banorët merrnin ujë nga pompat jashtë) dhe ndërprerjeve të shpeshta të energjisë elektrike[35]. Kampi i Leposaviqit, që gjendej 45 km në veriperëndim të grumbujve toksikë me zgjyrë, përshkruhej të jetë më së paku i ekspozuar ndaj kontaminimit me plumb. Sidoqoftë, sipas Human Rights Watch, ky kamp, i cili përfshinte një hangar dhe kazermat që më parë ishin të zëna nga Armata jugosllave dhe në të cilin ishin strehuar rreth 130 PZHB, ishte "i errët, i vogël, me lagështi dhe kishte kacabu", pa ujë të rrjedhshëm brenda.

84. Siç ka theksuar Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë në korrik të vitit 2005, kampet në Zhikoc, Cesminluke dhe Kablare i kishin kushtet më të këqija për jetesë, pasi ato ishin me rrezik afër vendit për deponimin e mbeturinave që u takonin mbetjeve të Kompleksit të Minierës Trepça[36]. Raportuesi special i OKB-së për të drejtat e PZHB-ve deklaroi se, gjatë vizitës së tij të parë në kampe në vitin 2005, ai

---

[32] *Raporti i Komisarit të Këshillit të Evropës për Misionin Special për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (23-27 mars 2009)*, përmendur në fusnotën 6 më lart, në § 146.
[33] *Një pasqyrë e përgjithshme e situatës në Kosovë*, Raport i të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, Kai Eide, Dokument i OKB-së S/2005/635, 7 tetor 2005, në f. 4.
[34] *Ibid*.
[35] Shih Raporti i KDNJ, përmendur në fusnotën 4 më lart, në f. 40.
[36] Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë, *Raporti i pestë Vjetor*, përmendur në fusnotën 8 më lart, në f. 35.

ishe "i tronditur" kur pa nga dora e parë se PZHB-të RAE ishin vendosur në një "vend shumë të kontaminuar" në Mitrovicën veriore dhe apeloi te komuniteti ndërkombëtar t'i evakuojë menjëherë kampet[37]. Apele urgjente për t'i evakuuar kampet janë bërë, po ashtu, nga Raportuesi Special i OKB-së për të drejtën për strehim adekuat, Raportuesi Special për të drejtën e secilit të gëzojë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor dhe Raportuesi Special mbi mbeturinat toksike, në tetor të vitit 2005 dhe, përsëri, në janar të vitit 2007.

85. Pasi kampi Osterode, më herët i zënë nga trupat e KFOR-it, ishte identifikuar nga EVM si një vend për vendosje të përkohshme, udhëheqësit romë të kampit si dhe organizatat për të drejtat e njeriut ishin unanime në vënien në pyetje të përshtatshmërisë së kampit, që gjendej mu pranë Cesminluke dhe rrjedhimisht pohohej, po ashtu, të jetë i kontaminuar me kimikate toksike[38]. Ky kamp, ku shumica e PZHB-ve ishin vendosur pas mbylljes së kampeve Kablare dhe Zhitkovc, ofroi kushte më të mira banimi me shumicën e PZHB-ve që jetonin në banesa të vogla apo baraka dhe kishin qasje të përmirësuar në ujë të rrjedhshëm, rrymë dhe ngrohje. Megjithatë, dëshmia mjekësore tregonte që niveli i plumbit në gjak te PZHB-të në Osterode "akoma tejkalonte nivelet e pranueshme për shumë herë", duke qenë "akoma tepër i lartë madje për t'i filluar masat terapeutike"[39]. Siç raportohet nga HRW, udhëheqësit e kampit Osterode besonin që KFOR-i e kishte larguar stafin e vet nga Osterode në fillim të vitit 2005, për shkak të niveleve të larta të plumbit të gjetur tek ushtarët. Hetimet e HRW-së rreth kësaj as nuk ishin konfirmuar e as hedhur poshtë nga KFOR-i[40].

86. Paneli cek shumë raporte që theksojnë se problemi më i madh në kampe ishte gjendja shëndetësore e banorëve. Në një letër drejtuar UNMIK-ut, PSSP-së, z. Lamberto Zannier, në prill të vitit 2009, Komisari për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës (KiE) theksoi se kur e vizitoi këtë kamp, ai ishte "i goditur nga të dyja, kushtet shumë të rënda në të cilat familjet jetonin si dhe nga rreziqet jashtëzakonisht serioze për shëndetin", me të cilat ata përballeshin çdo ditë, duke u mbështetur në faktin se ata jetonin në një vend të kontaminuar me plumb. Sipas mendimit të komisarit, "raportet për shkallën më të lartë se shkalla normale" ishin "të besueshme"[41]. Sipas intervistave të kryera nga HRW me udhëheqësit e kampit, PZHB-të dhe profesionistët mjekësorë që punonin në kampe, kishte një shfaqje të lartë të sëmundjeve siç janë problemet me veshka, shtypja e lartë e gjakut, diabeti, reumatizmi, astma dhe sëmundjet e zemrës. Drejtori i Spitalit të Mitrovicës i deklaroi HRW në vitin 2008:

> "Megjithëse këto probleme janë mjaft të zakonshme në Kosovë, dhe do të kërkonte studime shkencore për të thënë diçka autoritative, këto probleme janë më të rënda në rastin e PZHB-ve romë nga kampet, thjesht për shkak të kushteve

---

[37] Shih Raportin e Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi të Drejtat e Njeriut të Personave të Zhvendosur Brenda Vendit, Walter Kälin, Misioni në Serbi dhe Mal të Zi, Dok. i OKB-së E/CN.4/2006/71/Add. 5, 12 janar 2006, në § 63.

[38] Shih Raportin e Raportuesit Special për Strehim Adekuat si Komponentë e të Drejtës për Standard Adekuat të Jetës, Miloon Kothari, Dok. i OKB-së E/CN.4/2006/41/Add.1, 23 dhjetor 2005, në § 41; shih gjithashtu Raportin e HRW-së, përmendur në fusnotën 4 më lart, në f. 42.

[39] Shih Raportin e Raportuesit Special për Strehim Adekuar si Komponentë e të Drejtës për Standard Adekuat të Jetës, përmendur në fusnotën 38 më lart, në §§ 41 dhe 63.

[40] Raporti i HRW-së, përmendur në fusnotën 4 më lart, në f. 42.

[41] Letër nga Komisari për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës drejtuar ambasadorit Lamberto Zannier (UNMIK), Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, CommDH (2009), 20/23 prill 2009.

jetësore në të cilat ata jetojnë (temperaturat e ulëta, lagështia e madhe), ushqimi i dobët, vizita dhe ekzaminime më të rralla mjekësore, dhe puna fizike që ata e bëjnë"[42].

87. Raportet vazhdimisht theksonin gjendjen shëndetësore veçanërisht kritike të fëmijëve. Sipas HRW, fëmijët e kampit vuanin nga probleme serioze shëndetësore me sa duket të lidhura me kontaminimin nga plumbi (rritje me vonesë, nervozë, epilepsi, lodhje). Përveç kësaj, për shkak të sistemeve të tyre të dobëta imunitare, dhe si pasojë e ushqimit dhe higjienës së dobët, ata ishin të cenueshëm ndaj të gjitha llojeve të sëmundjeve dhe epidemive, siç janë diarreja, problemet me lëkurë, pneumonia[43]. Komisari për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës (KiE) shkroi se, megjithëse pasojat afatgjata të ekspozimit në plumb ishte e vështirë të përcaktohen, kontaminimi me plumb padyshim shkakton dëmtim zhvillimor të vazhdueshëm te fëmijët, të cilën ai e kishte parë me sytë e tij kur vizitoi Osteroden dhe Cesminluke-n në mars të vitit 2009[44]. Në një letër të mëvonshme drejtuar PSSP-së, ai shkroi se fëmijët që ai i kishte takuar në kampe ishin "qartas më pak të zhvilluar krahasuar me moshën e tyre" dhe e përkufizoi situatën si një "fatkeqësi humanitare". Komiteti Këshillimor i Këshillit të Evropës (KiE) për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Nacionale theksoi se "rreziku serioz për shëndetin", të cilit fëmijët dhe gratë shtatzëna veçanërisht i ishin ekspozuar në kampe, nuk ishte në pajtim me nenin 4 të Konventës që ndalon diskriminimin e personave që i takonin një pakice nacionale[45].

88. Për sa i përket qasjes në shërbime dhe trajtim shëndetësor, shumica e PZHB-ve, të rritur dhe fëmijë, ishin bartës të "librezave shëndetësore" për të pasur qasje në spitalet serbe në Mitrovicën e veriut dhe Serbi[46]. Megjithatë, asnjë ilaç nuk u ofrohej falas; në fakt, HRW e dokumentoi rastin e një familjeje, e cila ishte ekonomikisht e shkatërruar kur ajo ishte e detyruar t'i paguajë medikamentet e fëmijëve[47]. Pas hapjes së Osterodes, ishte hapur në kamp një klinikë e vogël (*ambulancë*) që kishte si staf infermiere për t'iu ofruar shërbimet themelore shëndetësore PZHB-ve që jetonin në Osterode dhe Cesminluke, megjithëse banorët e kampit ankoheshin se klinika vuante nga "mungesa kronike e barnave"[48].

89. HRW thekson se probleme të ngjashme me qasjen në barna dhe ndihmë mjekësore ishin parë në kampet dhe vendbanimet e tjera të PZHB-ve romë që organizata i vizitoi në nëntor/dhjetor të vitit 2008, por ajo çfarë ishte unike rreth situatës në kampet e Mitrovicës, ishte mungesa e përpjekjeve sistematike për t'i monitoruar nivelet e kontaminimit me plumb dhe ofrimit të trajtimit adekuat[49]. Në këtë drejtim, Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore shprehi shqetësimin e vet që trajtimi mjekësor për helmimin nga plumbi është ndërprerë në vitin 2007 dhe se nuk ka pasur asnjë monitorim të vazhdueshëm të niveleve të plumbit në gjak në

---

[42] Raport i HRW-së, përmendur në fusnotën 4 më lart, në f. 41.
[43] *Ibid.*, në ff. 40-44.
[44] *Raporti i Komisarit të Këshillit të Evropës për Misionin Special për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (23-27 mars 2009)*, përmendur në fusnotën 6 më lart, në § 148.
[45] Komiteti Këshillimor i Këshillit të Evropës (KiE) për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Nacionale, *Mendimi mbi Implementimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Nacionale në Kosovë*, miratuar më 25 nëntor 2005, në §§ 47 dhe § 151.
[46] Raport i HRW-së, përmendur në fusnotën 4 më lart,në ff. 44-45.
[47] *Ibid.*, në f. 44.
[48] *Ibid.*, në f. 41.
[49] *Ibid.*, në f. 40.

kampe[50]. Raportuesi i OKB-së mbi të drejtat e PZHB-ve, në vizitën e tij vijuese në qershor-korrik të vitit 2009, deklaroi se ai ishte "veçanërisht i shqetësuar" të theksojë që fëmijëve të PZHB-ve, të cilët ishin lëvizur nga kampet e kontaminuara për në Lagjen e Romëve, nuk u ishte ofruar "qasje në terapi, megjithëse kjo ishte e mundshme dhe urgjentisht e nevojshme". Ai shprehu shqetësimin që një "situatë e tillë kërcënuese për jetë", me vite, mbeti "në themel e pazgjidhur" [51].

E. Paditë penale dhe civile të paraqitura nga ankuesit

1. Procedurat kundër UNMIK-ut

90. Më 31 gusht 2005, Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (QEDR), një organizatë ndërkombëtare për të drejtën me interes publik, paraqiti një kallëzim penal në lidhje me situatën në kampet e PZHB-ve në "Zyrën e Prokurorit Publik në Kosovë". Kallëzimi është dorëzuar në emër të 550 "RAE-ve akoma të paidentifikuar", në mesin e tyre ankuesit, sipas nenit 291.5 (shkaktim i rrezikut të përgjithshëm) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Ankuesit i bënë një referim specifik vdekjes së D.M.[52].

91. Sipas informatave të ofruara nga përfaqësuesja ligjore e ankuesve, më 9 janar 2015, nuk është pranuar asnjë përgjigje në lidhje me kallëzimin e lartpërmendur penal.

92. Më 20 shkurt 2006, QEDR në emër të ankuesve paraqiti një ankesë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër UNMIK-ut. Sipas QEDR, Gjykata i informoi ata se nuk kishte juridiksion të shqyrtojë këtë rast, meqë UNMIK-u nuk ishte palë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

93. Më 10 shkurt 2006, ankuesit paraqitën kërkesa për kompensim në kuadër të Procesit të Ankesave të Palës së Tretë të OKB-së (shih § 16 më lart).

94. Më 25 korrik 2011, nënsekretarja e përgjithshme e OKB-së për çështje ligjore informoi ankuesit për vendimin e saj që t'i shpallë kërkesat jo të pranueshme. Ajo deklaroi se sipas nenit 29 të Konventës së vitit 1946 mbi Privilegjet dhe Imunitetet të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Procesi i OKB-së i Ankesave të Palës së tretë ofroi kompensim vetëm në lidhje me "pretendimet me karakter nga e drejta private", derisa pretendimet e ankuesve arrinin, në esencë, "te një rishikim i performancës në mandatin e UNMIK-ut si administratë e përkohshme në Kosovë". Ajo deklaroi më tutje:

> "Pavarësisht nga kjo që u tha më lart, ne theksojmë se, megjithëse nuk e kemi obligim ligjor ta bëjmë këtë, UNMIK-u ka ndërmarrë hapa substancialë për të përmirësuar gjendjen e popullatës së PZHB-ve. Me sa duket në vitin 2000, kur

---

[50] Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, *Shqyrtimet e raporteve të dorëzura nga palët shtetërore sipas nenit 16 dhe 17 të Konventës*, Dok. i OKB-së E/C.12/UNK/CO/1, 19 nëntor 2008, në § 29.

[51] Shih Raportin e Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi të Drejtat e Njeriut të Personave të Zhvendosur Brenda Vendit, Walter Kälin, Vizita në vazhdim në Misionin në Serbi dhe Mal të Zi (duke përfshirë Kosovën) në vitin 2005, Dok. i OKB-së A/HRC/13/21/Add.1, 11 dhjetor 2009, në §§ 63-64.

[52] Kopja e kallëzimit penal e qasur në http://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/3CACE6190D88ECC2492570750022EDE1-errc-yug-31aug.pdf më 25 shkurt 2016.

Miniera e Trepçës rifilloi njëanshëm punën, UNMIK-u e mbylli shkritoren. Veç kësaj, që nga viti 2000, UNMIK-u dhe komuniteti ndërkombëtar, në konsultim me përfaqësuesit e PZHB-ve, si dhe përfaqësuesit e strukturave lokale në Kosovë, kanë shpenzuar burime të konsiderueshme për mbrojtjen dhe ndihmën e popullatës PZHB, duke përfshirë vendosjen e banorëve të kampit në kampin Osterode dhe në një vendbanim të sapondërtuar në Lagjen e Romëve".

2. Procedurat kundër EULEX-it

95. Përveç kësaj, procedurat filluan kundër EULEX-it. Më 2 shkurt 2010, ankuesit i kërkuan kryeprokurorit të EULEX-it të hetojë përgjegjësinë e mundshme penale që del nga situata në kampet për PZHB-të RAE në Mitrovicën veriore. Megjithatë, ata u informuan nga kryeprokurori se asnjë hetim nuk do të fillohej pasi rasti, sipas tij, bie jashtë juridiksionit të EULEX-it.

96. Më 21 nëntor 2013, ankuesit paraqitën një kallëzim penal në Zyrën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe më 15 prill 2014, një hetim ishte nisur nga prokurori i caktuar i EULEX-it. Megjithatë, pas hyrjes në fuqi më 30 maj të vitit 2014 të Ligjit të Kosovës nr. 04-L-273, i cili vendos efektin retroaktiv që prokurori i EULEX-it ka autoritetin të kryejë hetime penale vetëm në rastet për të cilat vendimi për të filluar hetimet është paraqitur para 15 prillit të vitit 2014, rasti iu dorëzua prokurorëve të Kosovës në Zyrën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

97. Më 22 prill 2015, Paneli i EULEX-it për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (PSHDNJ) paraqiti vendimin e vet për rastin (të paraqitur tek ata më 9 qershor 2011), duke gjetur që EULEX-i kishte shkelur të drejtën e ankuesve për një kompensim efektiv (shih PSHDNJ, *X. dhe të tjerët kundër EULEX-it*, lënda nr. 2011-20, vendimi dhe të gjeturat e 22 prillit të vitit 2015).

III. ANKESA

98. Të 138 ankuesit ishin banorë të kampeve për PZHB në Zhikoc (funksionale prej vitit 1999 deri më 2006), Kablare (2001-2006) Cesminluke (1999-2010), Osterode (2006-2012) dhe Leposaviq (1999-2013) në Mitrovicën veriore. Përafërsisht gjysma e ankuesve ishin fëmijë më 4 qershor 2008, kur ankesa iu dorëzua Panelit. Rreth 75 ankues janë gra dhe vajza. Së paku 13 nga to i kanë lindur foshnjat në kampe dhe kanë paraqitur ankesë, po ashtu, në emër të fëmijëve të tyre. Ato kërkuan nga UNMIK-u t'i mbajë identitetet e tyre konfidenciale "për shkak të shqetësimeve serioze për sigurinë e tyre dhe frika nga ndonjë dhunë apo pasoja tjera". Prandaj, vetëm një përmbledhje e parashtresave, duke përfshirë dokumente mjekësore, të paraqitura nga ankuesit është ofruar më poshtë.

99. Ankuesit ankohen se UNMIK-u shkeli të drejtat e tyre të njeriut duke i vendosur ata në kampet për PZHB në një tokë të njohur të jetë shumë e kontaminuar, duke mos u ofruar atyre informata me kohë rreth rreziqeve për shëndetin apo trajtimin e kërkuar mjekësor, si dhe duke dështuar për t'i vendosur ata në një vend më të sigurt. Në veçanti, ata pretendojnë se UNMIK-u shkeli obligimet e veta pozitive për të mbrojtur të drejtën në jetë, siç parashihet me nenin 2 të KEDNJ-së, të drejtën e tyre për të qenë të lirë nga trajtimi johuman dhe degradues (neni 3 i KEDNJ-së), të drejtën e tyre për

të respektuar jetën private dhe familjare (neni 8 i KEDNJ-së), të drejtën e tyre për një gjykim të drejtë të çështjes (neni 6 § 1 i KEDNJ-së) dhe për një kompensim (neni 13 i KEDNJ-së). Ata, po ashtu, pohojnë se vendimi i UNMIK-ut për të vendosur PZHB-të RAE në kampe të kontaminuara dhe dështimi i tij t'i dërgojë ata në një ambient më të sigurt, përbënte diskriminim kundër ankuesve si pjesëtarë të komunitetit RAE në shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së, marrë në lidhje me dispozitat e përmendura më lart.

100. Ankuesit pohojnë më tutje se kushtet jo të shëndetshme dhe johigjienike në kampe përbënin një shkelje të të drejtave të tyre për strehim, shëndet dhe higjienë publike adekuate (neni 25 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDR)**)**, nenet 11 dhe 12 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK), dhe që të drejtat e grave dhe fëmijëve sipas dispozitave të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (KEDKG) dhe Konventa për të Drejtat e Njeriut (KDNJ), po ashtu janë shkelur.

101. Ankuesit N.M. (nr. 1) dhe S.M. (nr. 2), prindërit e D.M., ankuesi S.M. (nr. 8), burri i R.M., dhe ankuesja I.I. (nr. 20), gruaja e V.S., po ashtu ankohen se duke pasur parasysh se ankesat e tyre janë shpallur të pranueshme, nuk ka filluar asnjë hetim lidhur me vdekjet në kampe të anëtarëve të tyre të familjes, në shkelje të obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së.

IV. LIGJI

Pranueshmëria

102. Në komentet e tij mbi bazueshmërinë e ankesës të datës 5 dhjetor 2014 (shih § 31 më lart), PSSP-ja thekson se ankesa është e papranueshme.

103. PSSP-ja thekson se nuk ka bazë ligjore për rihapjen e rastit përkatësisht ankesës, e cila është shpallur e papranueshme nga Paneli më 31 mars 2010 duke u bazuar në nenin 2.2. të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2009/1 (Procesi i Ankesave nga Palët e Treta i OKB-së). PSSP-ja argumenton se nuk ka asnjë dispozitë në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/12 mbi themelimin e Panelit, e cila lejon rihapje të rastit përkatësisht ankesës që më parë është shpallur e papranueshme nga Paneli. Ndërsa Rregullorja e lartpërmendur mundëson, në nenin 18, që "Paneli Këshillëdhënës të mund të miratojë Rregulloren e punës për procedurat e veta", ajo "nuk mandaton krijimin e një procedure të re që është në mospajtim me frymën dhe qëllimin e Rregullores apo udhëzimeve administrative të nxjerra në lidhje me këtë". Sipas mendimit të PSSP-së, vendimi i Panelit për të rihapur rastin përkatësisht ankesën është marrë *ultra-vires*.

104. PSSP-ja shton se komentet e tij mbi bazueshmërinë e ankesës duhet marrë në konsideratë "pa paragjykime për pranueshmërinë e ankesës dhe vetëm të bëra si një çështje të mirësjelljes ndaj Panelit Këshillëdhënës".

105. Paneli tashmë e ka analizuar dhe hedhur poshtë këtë vërejtje të PSSP-së në vendimin e vet të pranueshmërisë së rastit të datës 10 qershor 2012 (në § 24).

106. Paneli nuk sheh ndonjë arsye për të hequr dorë nga përfundimi i vet i mëparshëm për çështjen dhe hedh poshtë vërejtjen e PSSP-së.

Bazueshmëria

A. Parashtresat e palëve

1. Parashtresat e ankuesve

a) Dokumentacioni mjekësor për testin lidhur me kontaminimin nga plumbi në kampe

107. Ankuesit deklarojnë se niveli i lartë i kontaminimit të plumbit i përcjell nga higjiena dhe kushtet e këqija jetësore në kampe, i kanë shkaktuar dëme të rënda shëndetit të tyre dhe shëndetit të anëtarëve të familjeve të tyre. Ankuesit thonë se, pas hyrjes në kampe, ata kanë përjetuar lloj-lloj gjendjesh serioze shëndetësore duke përfshirë: paralizë, encefalitis (inflamacion i trurit), sisteme të dobëta imunitare, anemi, humbje të peshës, çrregullime në sjellje, hipertension, vështirësi në frymëmarrje, humbje e përkohshme e vetëdijes, shtypje të lartë të gjakut, dhimbje dhe ngërçe të muskujve dhe nyjave, problem me veshka, të vjella, dhimbje barku, paaftësi në dëgjim, paaftësi në frymëmarrje, lodhje dhe kokëdhembje.

108. Ankuesit i ofruan Panelit disa komplete me dokumente mjekësore, kryesisht raporte të testeve për plumb të kryera në kampe gjatë datave të ndryshme në periudhën 2005-2008. Këto raporte kanë të bëjnë me 65 ankues apo anëtarët e tyre të familjeve, si dhe një numër të madh të PZHB-ve, që jetonin në kampe e të cilët nuk janë në mesin e ankuesve. Këto dokumente tregonin vazhdimisht për nivele të larta, apo jashtëzakonisht të larta të kontaminimit me plumb të banorëve të kampeve gjatë gjithë periudhës së paraqitur.

109. Kompleti i parë i dokumenteve janë kopjet e raporteve të kryera të testimit të gjakut dhe flokëve, me kërkesën e OJQ-ve lokale, nga Shtëpia e Shëndetit në Mitrovicë në prill/maj të vitit 2005 dhe nga Klinika Gjermane "IFU" në tetor të vitit 2005. Testi i gjakut tregon që, nga 13 ankues/pjesëtarë të familjeve të ankuesve të testuar, dhjetë janë kualifikuar si emergjenca mjekësore, duke pasur NPGJ-në mbi > 65 µg/dL (maksimumi që mund të matej nga një analizues dore i plumbit). Sa i përket testimit të flokëve, raportet e dorëzuara tregojnë se 21 ankues/ anëtarë të familjeve të ankuesve të testuar kishin nivele të larta të koncentrimit të plumbit në gjak.

110. Ankuesit, po ashtu, dorëzuan kopjet e testeve të gjakut të kryera më 20 dhjetor 2005 nga OBSH për Evropë në 24 fëmijë nga kampet e PZHB-ve në Kablare, Zhikoc dhe Cesminluke, duke përfshirë gjashtë ankues/anëtarët e tyre të familjeve. Këto teste tregojnë që 18 fëmijë të testuar kualifikoheshin për trajtim të menjëhershëm me terapinë përkatëse (ata u gjet të kenë NPGJ >45) dhe që, në mesin e tyre, 11 ishin me emergjenca mjekësore (duke pasur NPGJ >65 µg/dL).

111. Paneli, po ashtu, pranoi kopjet e testeve të gjakut të kryera në "Qendrën Klinike të Serbisë" në korrik dhe gusht të vitit 2006 në 177 individë (të gjithë fëmijë, përveç nëntë të rriturve) nga tri kampet e përmendura më lart, duke përfshirë 30 ankues, apo anëtarët e tyre të familjeve. Këto teste tregojnë që, me përjashtim të 16 individëve, të

gjithë fëmijët e testuar kishin NPGJ konsiderueshëm të lartë (10 µg/dL dhe më lart), megjithëse asnjëri nuk ishte kualifikuar për emergjencë mjekësore.

112. Paneli mori parasysh kopjet e testeve të gjakut të kryera nga Shtëpia e Shëndetit në Mitrovicë në kampet Cesminluke dhe Osterode në vitin 2007. Testet tregonin që, në një mostër prej mbi 103 fëmijëve nga PZHB-të (duke përfshirë dhjetë ankues/anëtarët e tyre të familjeve), dhjetë u kualifikuan si emergjenca mjekësore (NPGJ mbi 65 µg/dL), ndërsa pjesa e mbetur kishte NPGJ të lartë apo jashtëzakonisht të lartë.

113. Në fund, Paneli mori parasysh kopjet e testeve tjera të gjakut të kryera nga Shtëpia e Shëndetit në Mitrovicë në kampet Osterode dhe Leposaviq në dhjetor të vitit 2008. Testet tregojnë se, nga 84 fëmijë të testuar në Osterode (duke përfshirë 17 ankues/anëtarët e tyre të familjeve), në 12 ishte gjetur se kanë NPGJ mbi 65 µg/dL (emergjencë mjekësore), me pjesën e mbetur që tregonte për NPGJ konsiderueshëm të lartë. Në testet e kryera në Leposaviq thuhet që, nga 31 individë (23 fëmijë) të testuar, duke përfshirë gjashtë ankues apo anëtarët e tyre të familjeve: tetë kishin NPGJ nën 10 µg/dL; katërmbëdhjetë kishin NPGJ në mes 10-20 µg/dL; pesë në mes 20-30µg/dL; një në mes 30-40 µg/dL; tre në mes 40-50 µg/dL.

114. Njëmbëdhjetë ankues theksojnë se gjaku i tyre ishte testuar dhe se ata ishin gjetur të kenë NPGJ të lartë (të paspecifikuar); megjithatë atyre nuk u ishin ofruar kopjet e rezultateve. Gjithsej 34 ankues kanë pohuar të kenë përjetuar simptome të helmimit nga plumbi, por nuk mundën t'i ofrojnë Panelit ndonjë dokumentacion mjekësor për këtë qëllim.

115. Si dëshmi shtesë, ankuesit po ashtu paraqitën raportin "Niveli më i lartë i kontaminimit me plumb i regjistruar ndonjëherë në mostrat e flokëve të njeriut: 560 refugjatë romë iu ekspozuan metaleve të rënda vdekjeprurëse që nga viti 1999", që ishte publikuar nga OJQ-ja për të drejtat e njeriut 'Shoqëria për Popujt e Kërcënuar' (GfbV) në vitin 2005. Një pjesë e raportit e ka autorësinë e z. Klaus-Dietrich Runow, specialist i mjekësisë ambientale në Institutin gjerman IFU, i cili, me kërkesën e GfbV, vizitoi kampet dhe bëri teste të flokëve në një mostër prej 64 PZHB RAE në tetor të vitit 2005 (shih § 109 më lart). Artikulli përmban diagrame të testeve dhe një analizë të rezultateve të testit të z. Runow:

> "Hetimet paraprake kanë treguar që shumë persona kishin vlera të larta të plumbit në gjakun e tyre. Pasi analizat e gjakut pasqyrojnë vetëm koncentrimin akut dhe nuk tregojnë asnjë indikacion për trupin si të tërë, unë propozova që të bëhen analiza të flokëve. Analizat e flokëve paraqesin një metodë të përcaktimit të koncentrimit të metaleve të rënda në trup […]
>
> Analizat tregojnë për koncentrim jashtëzakonisht të lartë të elementeve të ndryshme toksike siç janë: hekuri, arseni, antimoni, alumini, kadmiumi, kallaji, mangani dhe vanadiumi […]
>
> Rezultatet e marra nga laboratori ynë raportohet të jenë më të lartat që ishin parë ndonjëherë sa u përket vlerave të metaleve të rënda në mostrat e flokëve të njeriut … Sa i përket mjekësisë ambientale, refugjatët do të përjetojnë dëm të pakthyeshëm në sistemin nervor dhe imunitet dhe dëmtim në rritje të eshtrave dhe sistem të gjakut nëse nuk ofrohet ndihma shpejt. Ndihma mjekësore duhet të

synojë konstatimin e shkaktarit të saktë të koncentrimit të metaleve të rënda. Testet e dheut ishin analizuar jo vetëm për plumb, por edhe për të gjitha llojet e tjera të elementeve toksike të gjetura në analizat e flokëve. Në operacionin e dekontaminimit duhet pasur kujdes i madh, pasi sasi të konsiderueshme të elementeve toksike mund të vihen në lëvizje në terapitë e zakonshme dekontaminuese (p.sh. Na-EDTA, DMPS, etj.), dhe kështu mund të ndodhin reagime të paparashikueshme… Prandaj trajtimi duhet bërë vetëm në institucione me përvojë prej shumë vitesh në mjekësinë ambientale.

Meqenëse në të gjitha rastet e ekzaminuara është gjetur nivel i ulët i selenit, unë dua të potencoj se pediatërit shohin një lidhje reciproke në mes mungesës së selenit dhe vdekjes së papritur të fëmijëve. Veçanërisht te gratë shtatzëna dhe fëmijët e lindur në kampe, niveli i selenit duhet të ekzaminohet dhe nëse është e nevojshme të normalizohet.

Nga pikëpamja e mjekësisë preventive është e nevojshme të përmirësohet niveli i ushqyerjes së personave në fjalë. Përveç marrjes së ushqimit jo të kontaminuar, trajtimi me minerale, elemente që ndihmojnë në rritje dhe vitamina duhet të sigurohen … Këto masa do të kenë pak ndikim nëse personat në fjalë mbesin të ekspozuar në helmet ambientale. Evakuimi i njerëzve në kampet e refugjatëve është esencial nga pikëpamja e mjekësisë ambientale dhe duhet të bëhet menjëherë. Sugjerohet si e nevojshme një diagnozë dhe terapi ambientale dhe mjekësore e azhurnuar”[53].

116. Përveç kësaj, e dokumentuar në raport është një dëshmi nga një punëtor i një OJQ-je rome, i cili punoi për dy vjet në kampe në një projekt edukimi për higjienën. Pjesë të kësaj deklarate ofrohen në vijim:

“Gjatë kësaj kohe ne kemi parë shumë fëmijë të sëmurë për shkak të helmimit nga plumbi. Nënat e tyre na tregojnë se, si ato e zbulojnë se fëmijët e tyre janë në rrezik. Ata fillojnë të kenë probleme në sjellje, duke u hidhëruar dhe duke u bërë të dhunshëm për gjëra të vogla. Ata humbin të dëgjuarit e tyre, dhe humbin orientimin kur ecin. Ndërsa gjendja e tyre përkeqësohet më shumë, ata humbin kujtesën e tyre dhe kanë të vjella çdo ditë. Afër fundit ata kanë dhimbje në këmbët e tyre, dhe u humb dhe kthehet vetëdija […]

Shumica e grave, të cilat mbesin shtatzëna në kampe, këto ditë kanë dështime. Pavarësisht nëse është fëmija i tyre i parë apo fëmija i dhjetë, ka shumë të ngjarë se ato do të kenë dështim […]

Nga ato 50 gra shtatzëna [të intervistuara], shumica kishin pasur dështime para muajit të pestë. Të tjerat vendosën ta vetëshkaktojnë abortin …[54]”

117. Punëtori i njëjtë i OJQ-së deklaron në raport se njëra nga gratë shtatzëna të intervistuara ishte R.M., 43 vjeç, e cila ankohej për simptomat e saj që shfaqen për 3

[53] Shoqëria për Popujt e Kërcënuar, *Niveli më i lartë i kontaminimit me plumb i regjistruar ndonjëherë në mostrat e flokëve të njeriut: 560 refugjatë romë iu ekspozuan metaleve të rënda vdekjeprurëse që nga viti 1999*, dhjetor 2005, në ff. 7-8.
[54] *Ibid.*, në ff. 9-10

vjet për helmim nga plumbi dhe e cila vdiq me foshnjën e saj të sapolindur në korrik të vitit 2005[55].

b) Dokumentacioni mjekësor lidhur me anëtarët e familjes të cilët vdiqën në kampe

118. Dokumente mbështetëse të paraqitura Panelit përfshijnë dokumentet mjekësore të paraqitura nga familjet N., M. dhe S., anëtarët e familjes të të cilave (një fëmijë dhe 2 të rritur) vdiqën në kampe.

119. Për sa i përket familjes N., ankuesit ofruan dokumentet mjekësore nga Shtëpia e Shëndetit në Mitrovicë, në të cilat thuhet se vajza e tyre 4-vjeç D.M., e cila vdiq në korrik të vitit 2004, ishte hospitalizuar së pari më 11 dhe 12 mars 2004 në gjendje të pavetëdijshme dhe me konvulsione. Ajo ishte referuar si një rast emergjent në Spitalin e Kragujevcit, ku ishte diagnostikuar me "etiologji virale me sa duket nga virusi herpes". Ata, po ashtu, ofruan kopje të dokumenteve mjekësore për vajzën e tyre të dytë, N.M. (ankuesi nr. 3). Në fletë lëshimin e Shtëpisë së Shëndetit në Mitrovicë thuhet se ajo ishte pranuar për herën e parë nga 28 maji deri më 2 qershor 2004 me konvulsione, kriza dhe inflamacion bajamesh dhe, për herën e dytë, nga 2 deri më 24 mars 2005, kur ajo ishte diagnostikuar me helmim nga plumbi dhe anemi. Dokumentet, po ashtu, përfshijnë kopje të testeve të gjakut të kryera në N.M. në shkurt të vitit 2005, në të cilat thuhet se ajo kishte NPGJ më të lartë se 65 µg/dL. Ata, po ashtu, ofruan kopje të testeve të gjakut për anëtarët e tjerë të familjeve të tyre (ankuesi nr. 4, 5, 6 dhe 7) që mbajnë datën e muajit qershor të vitit 2005, në të cilat thuhet se ata, po ashtu, kishin NPGJ më të lartë se 65 µg/dL.

120. Ankuesit, po ashtu, ofruan mendimet e ekspertëve për ndërlidhjet e mundshme mes vdekjes së D.M. dhe problemeve të tyre shëndetësore dhe kontaminimit me plumb në kampe. Në mendimin e ekspertit të ofruar me kërkesën e ankuesve, Dr. S.M., një mjek i specializuar për helmimin nga plumbi, thuhet që, meqë nuk ishte kryer kurrfarë testi për praninë e plumbit, "duke u bazuar në dokumentet e lëshimit, anamnezën dhe të gjeturat e tjera klinike, nuk ka dëshmi shkencore" se ajo ishte prekur prej helmimit nga plumbi. Në mendim po ashtu thuhet që, megjithatë, historia e sëmundjes së D.M. tregon se ajo ishte prekur nga një mosfunksionim serioz i sistemit imunitar – e cila mund të jetë shkaktuar nga helmimi nga plumbi – e cila, pastaj, shkaktoi infeksion viral me dëmtim të rëndësishëm më pas të sistemit nervor qendror. Shkaktari i vdekjes së D.M. duhet parë në kontekst të faktit që vëllezërit dhe motrat e saj janë testuar dhe është gjetur të kenë nivele alarmuese të plumbit në gjakun e tyre. Duke pasur parasysh se ata "ndanë hapësirën, ujin dhe ushqimin e njëjtë", ishte "e logjikshme" të supozohet që ajo ishte, po ashtu, e prekur nga helmimi me plumb "madje edhe pa të gjetura të drejtpërdrejta laboratorike" në lidhje me këtë.

121. Në mendimin e datës 4 nëntor 2005, të një eksperti të toksikologjisë, Dr. B.G., në lidhje me vdekjen e D.M., thuhet që "asnjë diagnozë tjetër e ndryshme nuk ishte kryer për të përjashtuar helmimin nga plumbi (kontaminimi i madh me plumb i dheut në kampet rome ishte i njohur mirë në atë kohë)" dhe që "nuk ka mohim të faktit që helmimi i madh nga plumbi mund të ketë sjellë rrezik dhe komplikime nga sëmundjet infektive". Për sa i përket rastit të D.M. në mendim përfundohet "është mundësi e madhe që helmimi me plumb të mos jetë diagnostikuar … si shkaktar i gjendjes së saj

[55] *Ibid.*, në f. 10.

klinike dhe në fund, vdekjes. Te motra e saj [N.M.], helmimi me plumb ishte diagnostikuar vetëm një vit më vonë".

122. Familja M., e përbërë nga burri, gruaja e tij e ndjerë, R.M., e cila vdiq në korrik të vitit 2005, për shkak të komplikimeve që dolën gjatë lindjes së fëmijës dhe dhjetë fëmijët e tyre, paraqiti dokumentet e lëshimit nga Klinika Gjinekologjike në Mitrovicë. Në to thuhet që R.M. "është trajtuar në këtë spital prej 12 korrikut të vitit 2005 deri më 13 korrik të vitit 2005, kur ajo ishte lëshuar me diagnozën Gar ml X. Dyabetes mellitus typ II. St. Post infarctus myocard. Diagnoza për fëmijën: Fetus mortus in utero. Hydrops foetalis." Ky ankues, po ashtu, dorëzoi kopjet e rezultateve të testit të flokëve të kryera në tetor të vitit 2005 nga IFU në fëmijët e tij (ankuesit nr. 13, 14, 15, 16 dhe 17), që tregojnë se ata kishin nivel të lartë të koncentrimit të plumbit. Sa i përket ankueses nr. 18, është ofruar një raport i testit të gjakut, i datës 13 prill 2005 nga Shtëpia e Shëndetit në Mitrovicë, që tregon se ajo kishte NPGJ më të lartë se 65 µg/dL, si dhe fletë lëshimi nga Spitali i Beogradit, të datës 26 prill 2005, në të cilat thuhet se ajo ishte diagnostikuar me helmim nga plumbi.

123. Sa i përket familjes S., ku babai, V.S., vdiq në mars të vitit 2006, në moshën 26-vjeçare, në mesin e dokumenteve tjera ankuesit paraqesin kopjet e testeve të gjakut të kryera në Shtëpinë e Shëndetit në Mitrovicë në prill të vitit 2005 dhe në "Qendrën Klinike të Serbisë" në korrik të vitit 2006 dhe dhjetor të vitit 2008, për katër anëtarët e familjes (një i rritur dhe tre fëmijë), duke theksuar se ata të gjithë kishin NPGJ më të lartë se 65 µg/dL në vitin 2005 dhe më të lartë se 40 µg/dL në dhjetor të vitit 2008, pasi ata ishin vendosur në Osterode.

c) Pohimet dhe argumentet e ankuesve

124. Ankuesit theksojnë se ata u bënë PZHB si pasojë e luftës në Kosovë dhe shkatërrimit të Lagjes së Romëve, ku shumica e tyre jetonin. Për shkak të dinamikës ndëretnike pas konfliktit në Kosovë, dhe për shkak të statusit të tyre si PZHB, ata nuk kishin liri të plotë të lëvizjes dhe mund të mbështeteshin vetëm në "kujdestarinë e UNMIK-ut".

125. UNMIK-u ndërtoi kampet për PZHB në Zhikoc, Cesminluke dhe Kablar, në vendin që ishte i njohur nga UNMIK-u që nga viti 2000 të jetë i kontaminuar apo "vend për hedhje mbeturinash toksike". Në lidhje me këtë, ankuesit i referohen raportit të brendshëm të UNMIK-ut të nëntorit të vitit 2000, raporteve të OBSH-së të korrikut të vitit 2004 dhe tetorit të vitit 2004 të përmendura më lart (shih §§ 50 dhe 73 më lart), si dhe vlerësimeve dhe raporteve tjera që dokumentojnë kontaminimin me plumb në kampe duke përfshirë: vlerësimet që thuhet se janë bërë nga KFOR-i amerikan dhe ai francez në vitin 2000, që dokumentojnë nivele të larta të plumbit në gjak në mesin e trupave dhe paralajmërimet për rreziqe serioze për shëndetin që rrjedhin nga kontaminimi me plumb; testimi i dheut i bërë nga UNMIK-u në kampe në maj të vitit 2005, rezultatet e të cilit thuhet se nuk janë bërë të ditura për publikun; një raport tjetër i përgatitur nga OBSH-ja në fund të vitit 2005, vetëm përmbledhja ekzekutive e të cilit është vënë në dispozicion të publikut të gjerë, që konfirmon të gjeturat e mëparshme mbi nivelet e rrezikshme të kontaminimit me plumb në mesin e fëmijëve në kampe; dhe vlerësimin e dheut në kampin Osterode të bërë nga një ekip ambiental amerikan në tetor të vitit 2005, rezultatet e të cilit, po ashtu, thuhet të mos jenë bërë publike.

126. Ankuesit theksojnë se "pavarësisht dëshmisë së madhe për një emergjencë mjekësore", banorët e Zhikocit, Cesminluke dhe Kablar nuk ishin zhvendosur dhe kampet ishin në vend të kontaminuar në kohën e paraqitjes së ankesës, që do të thotë rreth tetë vjet pas ndërtimit të tyre.

127. Ankuesit ankohen se, përveç vendosjes së tyre në një vend të kontaminuar me plumb dhe gjendjes rezultuese emergjente, kushtet e përgjithshme në kampe ishin "të mjerueshme", që kontribuoi për problemet e menjëhershme dhe afatgjata shëndetësore të ankuesve. Ata pohojnë se banorët e kampeve shpesh nuk kishin qasje në ujin e rrjedhshëm, rrymë, ngrohje, përkujdesje shëndetësore apo ushqim. Ankuesit theksojnë që, për shkak të mungesës së ujit në kampin në Zhikoc, mbajtja e higjienës ishte e vështirë dhe fëmijët shpesh kishin gjendje të keqe që ndërlidhej me lëkurën. Ata, po ashtu, theksojnë që në shtator të vitit 2005, tualetet e përbashkëta në kampin në Zhikoc "nuk kishin dry të derës, letër tualeti, peshqirë, sapun për larjen e duarve dhe kishin përplot jashtëqitje dhe urinë njerëzish". Ata thonë se pothuajse çdonjëri nga tri kampet e lartpërmendura "ka apo ka pasur morra" dhe se "çdonjëri në Cesminluke dhe Kablare ka apo ka pasur qere". Ankuesit theksojnë se disa OJQ dhe organizata ndërkombëtare kishin theksuar në raportet e tyre se standardet e jetesës në kampe janë larg nën standardet ndërkombëtare.

128. Gjendja e grave shtatzëna në kampe paraqiste një shqetësim të veçantë. Sipas ankuesve, shumë foshnja lindnin të vdekura dhe kishte shumë dështime në kampe. Ata pohojnë që pasi shumë gra e dinin se fëmijët e tyre do të lindnin "me retardime mentale", ato praktikonin aborte të vetëshkaktuara duke pirë preparate për morra apo pesticide, apo duke përzier tharmin me birrë për të shkaktuar dështime.

129. Ankuesit ankohen se "pak apo asnjë informatë" nuk iu është dhënë PZHB-ve për afro gjashtë vjet në lidhje me rreziqet për shëndetin të cilave u ishin ekspozuar dhe, që madje edhe pas publikimit të dy raporteve të vitit 2004 të OBSH-së në të cilat kërkohej evakuim i menjëhershëm i kampeve, "banorëve nuk u ishin dhënë informata të duhura dhe të kuptueshme rreth rrezikut për shëndetin e tyre dhe shëndetin e fëmijëve të tyre". Ata deklarojnë më tutje se një numër i studimeve dhe raporteve nga burime të ndryshme, për shembull ai i përmendur në § 50 më lart, "mbaheshin nga UNMIK-u" dhe se vetëm kur nga aktivistët lokalë u soll çështja në vëmendje ndërkombëtare, autoritetet filluan një fushatë informative në vjeshtën e vitit 2005. Deri atëherë, UNMIK-u jo vetëm që dështoi të ofrojë informata, por ishe përgjegjës për ofrimin e "keqinformimit" dhe "keqinterpretimeve" për çështjen. Në lidhje me këtë, ndër të tjera, ankuesit theksojnë se zyrtarët e UNMIK-ut përhapën informata se banorët e kampeve ishin përgjegjës për shëndetin e tyre të keq, për shkak të aktiviteteve të tyre joformale që ndërlidheshin me shkrirjen.

130. Sa i përket vendosjes së shumicës së PZHB-ve në kampin Osterode në vitin 2006, ankuesit argumentojnë që Osterode ishte ndoshta edhe më i kontaminuar sesa kampet e tjera, siguristh jo më i sigurt, siç është dëshmuar nga testet e gjakut të bëra në atë kamp në vitin 2007. Ankuesit theksojnë se testet, kopjet e të cilave u janë ofruar edhe UNMIK-ut edhe Panelit (shih §§ 109-113 më lart), tregojnë që fëmijët kishin "tregues për nivel më të lartë të plumbit në gjak pas një viti në Osterode sesa që e kishin më parë".

131. Ankuesit deklarojnë më tutje që, meqë terapia përkatëse duhet marrë jashtë vendit që është burim i kontaminimit, dhe për shkak të ndotjes akoma të lartë me plumb në Osterode, terapia përkatëse dhe shpërndarja e shtesave ushqimore, që kishte filluar në vjeshtën e vitit 2006, ishte ndërprerë papritmas në vitin 2007. Pavarësisht kushteve më të mira të jetës, PZHB-të akoma jetonin në një vend shumë të kontaminuar në Osterode, që e bëri terapinë përkatëse joefektive. Ankuesit, po ashtu, pohojnë se asnjë informatë në lidhje me këtë, duke përfshirë rezultatet e trajtimit të bërë, nuk u ishte ofruar ndonjëherë prindërve të fëmijëve që ishin trajtuar.

132. Në dritë të kësaj që u tha më lart, ankuesit pohojnë që kushtet në kampet, në të cilat ata jetuan, i vunë jetët e tyre në rrezik serioz, në shkelje të qartë të nenit 2 të KEDNJ-së që mbron të drejtën në jetë. Ankuesit theksojnë që neni 2 ua ngarkon shteteve detyrën që jo vetëm të përmbahen nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, por gjithashtu t'i ndërmarrin hapat e duhur për t'i mbrojtur jetët e atyre që janë nën juridiksionin e tyre. Ata i referohen praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së që e zgjeron këtë obligim në fushën e "aktiviteteve të rrezikshme", në "çdo aktivitet, pavarësisht nëse është publik apo jo, në të cilin e drejta në jetë mund të jetë në rrezik", dhe "*a fortiori* në rastin e aktiviteteve industriale, të cilat nga vetë natyra e tyre janë të rrezikshme, siç është të vepruarit në vendet e mbledhjes së mbeturinave". Ky obligim pozitiv mund të përfshijë sigurimin e informatave lidhur me rreziqet e mundshme për jetë të shkaktuara nga veprimet e shtetit si dhe obligimin për të ndërmarrë hapa të caktuar për t'i mbrojtur kategoritë më të cenueshme të njerëzve siç janë minoritetet etnike dhe gratë.

133. Në rastin aktual, ankuesit pohojnë se situata ambientale, për të cilën janë ankuar, nuk ishte rezultat i një kthese të menjëhershme dhe të papritur të ngjarjeve; përkundrazi, ishte një situatë e mirënjohur që kishte zgjatur shumë. Duke pasur parasysh rreziqet e njohura nga ekspozimi ndaj plumbit në kampe, autoritetet e UNMIK-ut e kanë ditur apo është dashur ta dinë rrezikun e madh për jetët e PZHB-ve. Sidoqoftë, ato nuk morën ndonjë hap pozitiv për të përmirësuar gjendjen apo të largojnë PZHB-të nga vendi i kontaminuar. Veç kësaj, UNMIK-u po ashtu dështoi t'i informojë ata për rreziqet me të cilat ata po përballeshin duke jetuar në një ambient të tillë toksik.

134. Ankuesit ankohen që dëmi dhe dëmtimi që e kanë përjetuar ata është "i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm". Ata theksojnë që rasti i tyre paraqet një "kombinim të fuqishëm të dëshmisë së drejtpërdrejtë dhe supozimeve", që e bën të arsyeshëm të konkluduarit se shëndeti i viktimave u përkeqësua si rezultat i qëndrimit të tyre të gjatë në një vend që ishte shumë toksik. Ekspozimi i gjatë në kontaminim të plumbit i bëri ata më të cenueshëm nga sëmundjet e ndryshme që ndikuan negativisht në cilësinë e jetës së tyre, sidomos të fëmijëve. Për këto arsye, ata theksuan se aktet dhe lëshimet e UNMIK-ut të përshkruara më lart paraqesin shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së.

135. Ankuesit theksojnë se "vendosja e tyre fillestare dhe mbajtja afatgjatë" në kampe për PZHB-të të kontaminuara me plumb dhe më pas efektet negative në shëndetin e tyre, po ashtu, përbën shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së, i cili ndalon trajtimin johuman dhe degradues. Ndërsa pranohet që sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, keqtrajtimi për të cilin bëhet ankesë duhet të arrijë "një nivel minimal të ashpërsisë" që të përbëjë trajtim johuman dhe degradues sipas nenit 3, ankuesit deklarojnë që ky vlerësim duhet t'i marrë parasysh faktorët, siç janë gjinia e

viktimave, mosha dhe gjendja shëndetësore, të cilat ndikojnë në cenueshmërinë e viktimave ndaj vuajtjes fizike apo emocionale.

136. Ankuesit argumentojnë më tutje që, duke ndjekur arsyetimin e njëjtë, etnia e tyre rome dhe fakti se ata i takojnë një grupi minoritar historikisht të pafavorizuar në Kosovë, i ka bërë ata veçanërisht të cenueshëm nga trajtimi degradues. Ankuesit pohojnë që indiferenca e autoriteteve ndaj vuajtjeve të tyre ka shkaktuar "poshtërim dhe përulje" dhe që identiteti i tyre etnik "rezultoi në forcimin e ndjenjës për degradimin e tyre, pafuqi të plotë dhe mungesë të ndonjë mbrojtjeje ligjore", të cilat duhet pasur parasysh gjatë shqyrtimit të pretendimeve sipas nenit 3.

137. Ankuesit theksojnë që të drejtat e tyre për standardin më të lartë të arritshëm të jetës, e drejta për banim dhe e drejta për standard adekuat të të jetuarit, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe banimin adekuat, të garantuara me nenet 12 dhe 11 të KNDESK-së, po ashtu janë shkelur.

138. Ankuesit theksojnë se rreziqet për shëndet që rrjedhin nga kontaminimi me plumb në kampe dhe dështimi i UNMIK-ut që të ndërmarrë veprim rregullues, po ashtu, përbëjnë shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së, i cili e mbron të drejtën për jetë private dhe familjare, të drejtën për shtëpi dhe të drejtën korresponduese. Neni 8 përfshin edhe detyrën për t'u përmbajtur nga interferenca dhe detyrën e autoriteteve relevante për të miratuar masa që ofrojnë mbrojtje të të drejtave, madje edhe në marrëdhënien ndërmjet individëve privatë.

139. Ankuesit argumentojnë që ata e konsiderojnë vendqëndrimin e tyre në kampe si "shtëpi" në kuptimin e nenit 8 dhe që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, dështimi i autoriteteve shtetërore që t'i mbrojnë individët nga dëmi ambiental, duke përfshirë dëmin që rrjedh nga industria private, përbën shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, ata theksojnë që dështimi i UNMIK-ut për të rregulluar çështjen e kontaminimit apo për t'i larguar ata nga burimi i kontaminimit përbën shkelje të nenit 8.

140. Ata pohojnë më tutje që UNMIK-u, po ashtu, shkeli nenin 8 duke mos u mundësuar atyre qasje në informata të duhura dhe në kohë lidhur me rreziqet për shëndetin në të cilat ata ishin të ekspozuar. Ata pohojnë që, madje edhe kur janë bërë studimet, rezultatet e tyre nuk u ishin ofruar atyre apo bërë publike (shih §§ 49-51 më lart).

141. Ankuesit theksojnë se diskriminimi kundër komunitetit RAE në Kosovë për qasje në punësim, banim të përshtatshëm, arsim dhe përkujdesje shëndetësore dhe në përgjithësi përjashtimi i personave RAE nga rrjedhat e përgjithshme shoqërore, janë mirë të dokumentuara në raportet e organizatave ndërkombëtare, sikur OSBE-ja. Ata ankohen se dështimi për t'i larguar PZHB-të RAE nga kampet e kontaminuara me plumb është "vetëm një ndodhi në një model të praktikës diskriminuese nga të dyja aktorët privatë dhe publikë" kundër komunitetit RAE në Kosovë. Ata theksojnë që neni 14, shpallur në lidhje me nenet 2, 3, 8, 6 dhe 13 të KEDNJ-së, po ashtu është shkelur, si dhe dispozitat relevante të KNDCP-së, KNDESK-së dhe Konventës Ndërkombëtare kundër të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (KNEDR).

142. Ankuesit argumentojnë që vetëm PZHB-të RAE, krahasuar me PZHB-të nga Kosova me origjinë tjetër etnike, janë vendosur në një afërsi të tillë të Kompleksit Trepça, në

vendin që është ditur të jetë i kontaminuar. Ata ankohen më tutje që autoritetet publike kanë vepruar në një mënyrë më të shpejtë për t'i "kthyer, ofruar rindërtim dhe kompensuar" banorët jo RAE të Kosovës, të cilëve u ishte humbur apo shkatërruar prona e tyre gjatë konfliktit. Si shembull, ata përmendin Raportin e pestë Vjetor të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, në të cilin thuhet që, për sa u përket trazirave dhe shkatërrimit pasues të pronës, që ndodhi në mars të vitit 2004, me datën 11 korrik 2005, Qeveria kishte "filluar rindërtimin e pothuaj të gjitha pronave të dëmtuara apo shkatërruara" dhe "ofroi grante në para të gatshme për familjet e kthyera". Ankuesit theksojnë se "Romët akoma presin për rindërtim dhe kompensim të pronave që janë shkatërruar në vitin 1999" dhe që planet e UNMIK-ut për të rindërtuar Lagjen e Romëve janë bërë dhe vazhduar pa pajtimin paraprak të komunitetit RAE.

143. Ankuesit, po ashtu, përmendin emergjencën tjetër ambientale jo të lidhur por që pritej të përfshinte mbi 1,000 shqiptarë nga fshati Hade, që gjendej mbi një minierë të qymyrit dhe ishin në rrezik nga shembja e dheut. Ankuesit theksojnë se banorëve, të cilët ishin të detyruar t'i braktisin shtëpitë e tyre, iu ofrua përkohësisht ushqim dhe strehim si dhe … iu ndanë parcela të reja të tokës dhe shtëpi apo apartamente të reja. Kjo çështje, po ashtu, dokumentohet në Raportin e pestë Vjetor të Institucionit të Ombudspersonit, në të cilin thuhet që "pas shumë përpjekjeve të Qeverisë për të arritur një zgjidhje për banorët e fshatit Hade … 29 familje refuzuan të zhvendoseshin. Megjithatë, zhvendosja e pavullnetshme e familjeve të përmendura së fundi më 2 qershor 2005 kishte pasqyruar planifikim intensiv gjatë një periudhe të kohës dhe ishte e organizuar mirë dhe kryer me kujdes. Sa i përket humbjeve apo dëmtimeve të pronës që ishin shkaktuar, pagesat e kompensimit ishin tanimë duke u bërë …". Ankuesit përfundojnë që këto veprime nga UNMIK-u demonstrojnë që "evakuimi nga një gjendje ambientale potencialisht e rrezikshme është e mundshme për mbi 1,000 shqiptarë. Në kontrast me këtë, largimi i gjysmës së atij numri të romëve nga një vend i njohur dhe i dokumentuar mirë si kontaminues është vonuar për gjashtë vjet".

144. Ankuesit argumentojnë që, duke pasur parasysh *prima facie* të provuar se vendosja dhe mbajtja e PZHB-ve RAE në kampet e kontaminuara me plumb ndjek këtë lloj të diskriminimit, i takon UNMIK-ut të dëshmojë se çështja nuk ishte menaxhuar nga ata në një mënyrë diskriminuese.

145. Përveç shkeljeve tjera të pretenduara të të drejtave të njeriut, në mënyrë specifike lidhur me ankueset femra, ankuesit pohojnë për shkelje që kanë të bëjnë me shkelje të KEDKG-së.

146. Ankuesit pohojnë se, pasi e paditura dinte apo është dashur të dijë për rrezikun serioz për jetët dhe shëndetin e viktimave gra nga kontaminimi me plumb në kampe dhe kushtet e përgjithshme jetësore, dhe nuk mori ndonjë hap pozitiv t'i largojë viktimat nga rreziku për shkak të diskriminimit, kjo paraqet një shkelje të dispozitave relevante të KEDKG-së (duke përfshirë nenet 1, 2 dhe 3). Më tutje theksohet në emër të këtyre ankuesve, të cilët, në kohën në fjalë ishin banorë të kampeve në Zhikoc, Cesminluke dhe Kablare dhe tani janë banorë të kampit Osterode, se vendosja e tyre fillestare dhe mbajtja e gjatë në kampe të PZHB-ve në një vend të kontaminuar afër një vendi për hedhurina toksike, dhe efektet përcjellëse të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e tyre përbëjnë një shkelje të nenit 12 të KEDKG-së. Po ashtu, pohohet që

kushtet në të cilat ankuesit jetuan, vështirësuan aftësitë e tyre për të pasur arsimim të duhur familjar dhe qasje në shëndetësi dhe informata, dhe vështirësoi më tutje jetën familjare dhe kështu përbën shkelje tjetër të KEDKG-së. Ankuesit theksojnë se mungesa e pretenduar e përkujdesjes adekuate shëndetësore, kushtet e vështira të jetës dhe mungesa e informatave të duhura mjekësore rreth rrezikut përcjellës, ishin veçanërisht serioze për gratë shtatzëna për shkak të rritjes së cenueshmërisë së tyre dhe të asaj të fëmijëve të tyre të palindur.

147. Një numër i shkeljeve specifike të KDF-së pretendohen nga ankuesit. Ata pohojnë që neni 2 është shkelur për shkak të diskriminimit etnik dhe gjinor nga e paditura; neni 3 është shkelur pasi e paditura nuk i ka marrë parasysh interesat më të mira të fëmijëve në veprimet e veta; neni 5 është shkelur pasi të drejtat e prindërve nuk janë respektuar përmes dështimit të të paditurës që t'i raportojë rezultatet e testeve të gjakut apo të japë informata të sakta; veç kësaj, neni 6 është shkelur për ata fëmijë të cilët kanë vdekur dhe, veç kësaj, që e drejta për zhvillim që përmban neni 6 është mohuar si pasojë e paaftësive të vazhdueshme mentale të fëmijëve të lindur me helmim nga plumbi dhe përmes mungesës së trajtimit mjekësor.

148. Ankuesit pohojnë për shkelje të nenit 16 të KDF-së përmes një shkelje të së drejtës të mbrohen nga sulmet në apo interferencë privatësie, jetë familjare dhe shtëpi. Neni 19 pohohet të jetë shkelur nga dështimi i të paditurës që të marrë masa për t'i mbrojtur fëmijët nga dhuna fizike apo mentale, lëndimi apo abuzimi. Për shkak të dështimit të të paditurës që të krijojë kushte në të cilat fëmijët e paaftë mentalisht apo fizikisht të mund të gëzojnë një jetë të plotë dhe të mirë nën përkujdesje të veçantë, ankuesit pohojnë për shkelje të nenit 23. Pretendohet që e paditura e ka shkelur të drejtën e fëmijëve për të pasur standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit të kërkuar me nenin 24 përmes ndërprerjes së sigurimit të ushqimit kalorik dhe përkujdesjes mjekësore, duke dështuar kështu t'i marrë parasysh rreziqet nga ndotja ambientale dhe duke dështuar të ofrojë informata adekuate apo çfarëdo informate. Në fund, ankuesit pohojnë për shkelje të nenit 27, e drejta për standard adekuat të jetesës dhe shkelje të nenit 37 për shkak se ankuesit fëmijë iu nënshtruan trajtimit mizor, johuman dhe degradues.

149. Përveç kësaj, ankuesit theksojnë se ata nuk kanë qenë në gjendje të paraqesin ndonjë ankesë lidhur me shkeljen e të drejtave të tyre sipas neneve 2, 3 dhe 8 të KEDNJ-së te "ndonjë autoritet nacional me kompetencë për zbatim efektiv të ligjit". Ata theksojnë që, në njërën anë, atyre "u është ndaluar ndonjë veprim ligjor për shkak të imunitetit të KFOR-it dhe UNMIK-ut"; e në anën tjetër, ata janë përballë me "një sistem gjyqësor jokoherent dhe jo të besueshëm" në Kosovë, "i cili ua bëri atyre të pamundshme të ndërmarrin veprim ligjor kundër palëve përgjegjëse". Për këtë arsye, ata pohojnë që janë shkelur e drejta e tyre për gjykim të drejtë dhe e drejta e tyre për kompensim efektiv sipas nenit 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

2. Parashtresat e PSSP-së

150. Në fillim, PSSP-ja thekson se e drejta në shëndet duket të jetë e drejta kryesore e njeriut që UNMIK-u pretendohet ta ketë shkelur në lidhje me ankuesit. Meqë e drejta në shëndet është ngushtë e lidhur dhe e varur nga realizimi i të drejtave të tjera të njeriut, "siç janë e drejta në ushqim, banim dhe strehim, punë, arsimim, dinjitet

njerëzor, mosdiskriminim, barazi, ndalim të torturës dhe të drejtën në jetë", ankuesit theksojnë shkeljen e një spektri të gjerë të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u.

151. PSSP-ja argumenton se UNMIK-u nuk mund të mbahet përgjegjës për një situatë që ekzistoi me dekada para themelimit të tij dhe që UNMIK-u kishte bërë gjithçka në kuadër të autoritetit të vet që ta përfundojë atë. PSSP-ja thekson se është një fakt i mirënjohur që për 60 vjet para themelimit të UNMIK-ut, Shkritorja e Trepçës "lironte plumb me tonë për çdo ditë në atmosferë nga vendi i saj në bregun verior të lumit Ibër", me një ndikim negativ në shëndetin e komuniteteve që jetonin afër. Ai u referohet studimeve akademike dhe shkencore të kryera që nga 1980-at dhe 1990-at, raporteve (të përmendura në § 68 më lart), të cilat tregonin koncentrimin më të lartë të plumbit në ujë, dhe ajër në gjithë rajonin e Mitrovicës. Banorët e zonës-dhe në veçanti gratë shtatzëna- atëherë tregonin nivele shumë më të larta të NPGJ-së krahasuar me kosovarët nga rajoni i Prishtinës. Pavarësisht këtyre të gjeturave, fabrika e Shkritores së Trepçës vazhdoi të punojë derisa UNMIK-u e mbylli atë në gusht të vitit 2000, "në një përpjekje për t'i lehtësuar problemet ambientale".

152. PSSP-ja thekson më tutje që raportet pasuese, siç janë raporti i porositur i UNMIK-ut i nëntorit të vitit 2000 dhe raporti i OBSH-së i vitit 2004 (të përmendur në §§ 48 dhe 50 më lart), potencojnë faktin që historia e ndotjes ambientale në rajonin e Mitrovicës, si dhe "ndonjë çështje e ndotjes ambientale që i kontribuoi helmimit të pretenduar të komuniteteve RAE", janë "me dekada të vjetra" dhe kështu nuk mund t'i atribuohen UNMIK-ut. Ai, po ashtu, thekson që në raportet e njëjta të OBSH-së "në mënyrë të përsëritur theksohet shkrirja manuale dhe artizanale si faktor kryesor kontribuues për helmimin nga plumbi në mesin e komuniteteve RAE", ku mbetja e plumbit në dheun përreth zonës dhe afërsia me digat me mbeturina të Minierës së Trepçës janë parë nga ekspertët e tjerë si "faktorë kontribuues shtesë".

153. PSSP-ja argumenton më tutje që UNMIK-u dhe aktorët e tjerë ndërkombëtarë ndërmorën shumë iniciativa "për të siguruar që komunitetet RAE të mbrohen nga kontaminimi me plumb dhe rreziqet e tjera për shëndetin" dhe se parashtresat e ankuesve për mosveprimin e pretenduar të UNMIK-ut lidhur me gjendjen e tyre janë "faktikisht të pasakta". Për t'i përmendur veprimet e ndërmarra nga UNMIK-u, PSSP-ja fillon duke thënë që, pas konfliktit të Kosovës në vitin 1999, Lagjja e Romëve në Mitrovicën veriore ishte vendi më i madh me shtëpi të shkatërruara në Kosovë, me 700-800 shtëpi të shkatërruara dhe përafërsisht 8,000 pjesëtarë të komunitetit RAE të zhvendosur dhe të mbetur pa shtëpi. UNMIK-u dhe UNHCR-ja menjëherë morën përgjegjësinë për ndërtimin dhe menaxhimin e kampeve të PZHB-ve dhe ndërtimin e "shtëpive të përkohshme për komunitetin". Sipas PSSP-së, si pjesë e kësaj iniciative, mjekët lokalë vizituan kampet në bazë javore dhe morën përgjegjësinë për përkujdesje mjekësore në kampe.

154. PSSP-ja thekson se pas raportit të parë mbi helmimin me plumb në Mitrovicë të bërë publik në vitin 2000, UNMIK-u mori vendim që ta mbyllë Shkritoren e Trepçës për shkak të shëndetit publik, pavarësisht kundërshtimit nga autoritetet serbe për ta mbyllur dhe pasojave ekonomike që ajo përfshinte (punëtorët e pezulluar vazhduan të paguhen nga UNMIK-u). PSSP-ja thekson se me vendimin e vet për ta mbyllur shkritoren, UNMIK-u siguroi një zvogëlim gradual të kontaminimit të ajrit dhe dheut në Mitrovicë. Përveç kësaj, Departamenti i UNMIK-ut për Informim Publik, me pjesëmarrjen e organizatave të tjera ndërkombëtare duke përfshirë OBSH-në,

ndërmori iniciativa gjithëpërfshirëse për edukim dhe vetëdijesim publik (shpërndarje të pamfleteve, fushata nga dera në derë, takime në salla të qyteteve), për rreziqet nga plumbi dhe higjienën brenda kampeve duke u angazhuar me popullatën lokale në Mitrovicë.

155. PSSP-ja argumenton që testet e bëra më vonë nga OBSH-ja dhe organizatat e tjera ndërkombëtare zbulojnë që, pavarësisht nga zvogëlimi i niveleve të plumbit brenda rajonit që nga mbyllja e Shkritores së Trepçës, nivelet e plumbit në gjak mbetën të larta te komunitetet RAE. Ndër të tjera, ai u referohet rezultateve të një studimi mbi nivelet e gjakut në plumb të bërë nga OBSH-ja në vitin 2004, i cili tregoi një rënie në NPGJ te fëmijët serbë që nga mbyllja e shkritores, ndërsa NPGJ te fëmijët romë mbeti i lartë. Sipas PSSP-së, kjo diferencë "dyshohet se mund t'i atribuohet mënyrës së jetës së komuniteteve RAE që përfshinte riciklimin e akumulatorëve, shkrirjen si zeje dhe aktivitetet e tjera për gjenerim të të ardhurave me implikime negative në shëndet". Ai, po ashtu, u referohet rezultateve të publikuara në vitin 2008 nga "Instituti i Serbisë për Shëndetin Publik" në Mitrovicë, që tregonte për "kontaminim të vazhdueshëm, akoma në nivele të kufizuara dhe të përmirësuara, në mesin e banorëve në Osterode dhe Cesmin Lug"; dhe rezultateve të testeve të ajrit dhe testeve të gjakut të kryera nga Ushtria franceze, që tregojnë se "plumbi në ajër kishte rënë në nivele të pranueshme (do të thotë brenda normave të pranuara për zonat urbane në Francë) pak muaj pasi shkritorja ishte mbyllur, siç kishin rënë nivelet e plumbit në gjak". Megjithatë, Paneli thekson që asnjëri nga raportet dhe studimet e përmendura nga PSSP-ja nuk janë paraqitur së bashku me parashtresat e UNMIK-ut bërë Panelit.

156. PSSP-ja argumenton më tutje që, me bërjen publike të të gjeturave të OBSH-së mbi krizën e shëndetit publik nga helmimi me plumb, UNMIK-u dhe OBSH-ja u takuan me përfaqësuesit RAE dhe propozuan "largimin e menjëhershëm dhe të përkohshëm të grave shtatzëna dhe fëmijëve", por ky plan kishte "hasur në rezistencë të fortë të shumicës së komuniteteve të prekura". Ai thekson më tutje që UNMIK-u, UNHCR-i, OBSH-ja dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë filluan me masat për të gjetur më shumë vende të përshtatshme për vendosjen e PZHB-ve. Si pasojë, shumica e popullatës së prekur RAE u zhvendos në kampin Osterode, një iniciativë e cila ishte implementuar gjatë një periudhe të konsiderueshme kohore dhe pavarësisht rezistencës së udhëheqësve të komunitetit RAE për t'u zhvendosur. PSSP-ja thekson se kampi Osterode ishte identifikuar të jetë si një zonë shumë "më e sigurt", por e pranon që "vetvetiu, duke u gjendur në Mitrovicë, nuk ishte kurrë një vend plotësisht pa plumb". PSSP-ja thekson që në kuadër të kësaj iniciative "çështjet mjekësore, po ashtu, ishin prioritizuar dhe terapia përkatëse ishte aplikuar te fëmijët dhe të tjerët me nivele tepër të larta të plumbit në gjak".

157. Para vendosjes së PZHB-ve në Osterode, më 5 maj 2005 UNMIK-u organizoi një "Konferencë me donatorë për Lagjen e Romëve" dhe "disa konferenca tjera", të cilat thuhet se rezultuan me afërsisht dy milionë euro të mbledhura për t'i përmirësuar kushtet jetësore të PZHB-ve dhe siguruar që strehimi dhe akomodimi janë ofruar në një ambient të sigurt. Në veçanti, UNMIK-u mblodhi para për rindërtimin e Lagjes së Romëve si pjesë e një zgjidhjeje të përhershme për zhvendosjen e komuniteteve RAE dhe krijoi një Fond rezervë për të menaxhuar financimin e donatorëve. PSSP-ja thekson që, pavarësisht këtyre përpjekjeve "Komunitetet RAE rezistuan zhvendosjen, nuk morën parasysh fushatat publike të ngritjes së vetëdijes, dhe vazhduan me

aktivitetet për shkrirjen e plumbit dhe praktikat për riciklimin e akumulatorëve, madje edhe në kampet e PZHB-ve".

158. Si përgjigje ndaj kësaj situate, UNMIK-u dhe Komuna e Zveçanit ndaluan aktivitetet e shkrirjes në kampe. PSSP-ja thekson se UNMIK-u shqyrtoi mënyrat për shfrytëzimin e përkrahjes së policisë për të ndërmarrë veprim detyrues kundër aktiviteteve të shkrirjes; megjithatë, ishte e vështirë të merren masa detyruese, meqë aktivitetet e tilla nuk paraqisnin një shkelje sipas ligjeve të Kosovës.

159. Në mesin e masave tjera të marra për t'u përballë me krizën e shëndetit publik të shkaktuar nga helmimi me plumb, UNMIK-u themeloi, po ashtu, në vitin 2005 Grupin punues ndërmjet agjencive mbi kontaminimin me plumb, i cili e hartoi një strategji për menaxhimin e rrezikut në bazë të rekomandimeve të OBSH-së. Këto përfshinin shpërndarjen e shtesave ushqimore (të provuara të jenë efektive për zvogëlimin e absorbimit të plumbit), përmirësimin e kushteve të higjienës në kampe (ujë, kanalizim dhe mbledhje e bërllokut), ofrimin e edukimit shëndetësor, vendosjen në vend të një menaxhimi të duhur të kampit, angazhimi i mjekëve dhe infermiereve për të punuar në kampe, si dhe ofrimin e ekzaminimit të gjakut dhe trajtimit mjekësor. Shumica e harxhimeve të ndërlidhura me këto shërbime janë paguar nga Fondi rezervë i PSSP-së.

160. PSSP-ja thekson se UNMIK-u, po ashtu, themeloi në vitin 2005 Ekipin për veprim ndërmjet agjencive në Mitrovicë, i cili, nën koordinimin e Administratës Civile të UNMIK-ut në Mitrovicë, mbajti takime të rregullta për t'i formuluar strategjitë se si të ndihmohen më tutje PZHB-të përmes një Plani operacional dhe që thuhet të ketë kushtuar 1,4 milion euro. Kjo përfshinte ofrimin e stimujve për komunitetet RAE (sikur gjërat joushqimore, shërbimet mjekësore falas, rrymën, ujin, menaxhimin e mbeturinave dhe shtesat ushqimore për një vit), si dhe ofrimin e skemës për gjenerim të të ardhurave (p.sh. pastrimin e copëzave të mbetura, mbeturinave nga rrënimi, kaçubave dhe bërllokut në Lagjen e Romëve, pastrimin e Varrezave Ortodokse; Qendra për Trajnim Profesional; ndërtimi i kampit në vendin e zhvendosjes).

161. Sa u përket aktiviteteve rehabilituese, PSSP-ja thekson se, deri kah mesi i vitit 2005, disa intervenime ishin kryer në Cesminluke dhe kampet e tjera, "ku dheu i kontaminuar ishte larguar dhe vendet e rrezikshme me plumb ishin mbuluar me beton"; në Zhikoc, Agjencia Evropiane për Rindërtim në bashkërendim me UNMIK-ut financoi një projekt "për t'i izoluar depozitat me mbetje nga miniera, rehabilitimin dhe mbulimin e pjesëve të pjerrëta për t'i parandaluar fëmijët të luajnë atje". PSSP-ja thekson që, pavarësisht këtyre përpjekjeve, udhëheqja e RAE vazhdimisht kundërshtonte çfarëdo forme të zhvendosjes së përkohshme, meqë, siç thuhej në takimet publike në maj dhe qershor të vitit 2005, ata "të gjithë dëshironin të ktheheshin në Lagjen e Romëve dhe askund tjetër në Kosovë".

162. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lartë, PSSP-ja argumenton që UNMIK-u dhe agjencitë e OKB-së "morën vendime kryesore mbi politikën dhe me zell implementuan strategjitë për zhvendosje të matur dhe rindërtimin e Lagjes së Romëve me qëllim të lehtësimit të gjendjes së vështirë të komuniteteve RAE. Për fat të keq, zhvendosja u pengua nga vështirësia për të identifikuar një vend që është i lirë nga përplasjet ndëretnike larg Mitrovicës veriore e që nuk kishte plumb dhe ishte i pranueshëm për të gjitha palët, dhe nga kundërshtimi i përgjithshëm dhe i

vazhdueshëm i popullatës së prekur për të gjitha masat e përkohshme". PSSP-ja parashtron më tutje që të gjitha veprimet e ndërmarra nga UNMIK-u, siç janë përshkruar më lart, ishin "akte të një administrimi të përkohshëm", jo të ndërmarra "në cilësi të një misioni paqeruajtës të OKB-së". Si pasojë "burimet financiare të UNMIK-ut ishin të kufizuara me ato të buxhetit dhe burimeve njerëzore të Kosovës, në të gjitha fushat, duke përfshirë shërbimet mjekësore dhe sociale".

163. Përveç kësaj, ndërsa përmend me keqardhje vdekjet e të afërmve të ankuesve dhe shëndetin e keq të ankuesve dhe familjeve të tyre, PSSP-ja thekson që "pretendimet për gjendjet shëndetësore nuk janë dokumentuar plotësisht në të gjitha rastet me dëshmi të qartë dhe të sigurt mjekësore". Ai thotë që UNMIK-u "e thekson se është e rëndësishme të tregohet se shkaktari i gjendjes shëndetësore është vërtetuar padiskutueshëm në të gjitha rastet nga informatat e ofruara nga ankuesit". Në lidhje me këtë, është qëndrim i PSSP-së se "ndërsa ankuesit ofrojnë disa dëshmi mjekësore *post facto* duke u bazuar në dokumente të kufizuara mjekësore, ka një mungesë të dëshmisë mjekësore për të provuar, pa dyshim, se gjendjet shëndetësore ishin shkaktuar, apo kontribuuar në to, nga ndotja me plumb apo nga aktet apo lëshimet e UNMIK-ut". Veç kësaj, PSSP-ja argumenton që ankues të caktuar ishin "vizitorë të përkohshëm" në kampe dhe kjo duhet marrë parasysh kur shqyrtohen pretendimet për dëmin e pësuar.

164. Në përgjigje të pretendimeve të ankuesve se e drejta e tyre në jetë ishte shkelur për shkak të kontaminimit me plumb dhe kushteve në kampe, PSSP-ja thekson që, kur UNMIK-u u vu në dijeni për rrezikun për shëndet që shkaktonte ndotja me plumb "përmes hetuesve të shumtë apo raporteve të përpiluara nga partnerët e vet", ai ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të mjeteve të veta për të parandaluar materializimin e atyre rreziqeve. Lidhur me pretendimet sipas obligimit procedural të nenit 2 të KEDNJ-së, që UNMIK-u dështoi të kryejë hetime për vdekjet e banorëve të caktuar, PSSP-ja thotë që është "e qartë nga ajo që u përmend më lart, se kushtet në kampe ishin në mënyrë të vazhdueshme nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut dhe partnerëve të tij, duke përfshirë OBSH-në, dhe ishin bërë raporte dhe rekomandime të një natyre hetuese për kushtet në kampe për të mbrojtur të drejtën në jetë të banorëve të kampit". Ai thekson më tutje, në mënyrë specifike lidhur me vdekjet e D.M., R.M. dhe V.S., që "nuk është vërtetuar se këto vdekje janë shkaktuar nga helmimi me plumb". Sipas PSSP-së, ankesa i referohet një "analize *post-facto*" nga një mjek dhe "përshkrimit të simptomave që të afërmit e të vdekurve ia kanë bërë përfaqësueses së ankuesve".

165. Sa i përket pretendimit të ankuesve se kushtet në kampe shkaktuan vuajtje fizike dhe mentale që përbëjnë trajtim johuman dhe degradues, PSSP-ja thekson që UNMIK-u e hedh poshtë ankesën që UNMIK-u "qëllimisht i shkaktoi vuajtje komunitetit RAE". PSSP-ja thekson që, madje edhe para konfliktit, komuniteti RAE vuante "nga disavantazhet paraekzistuese sa i përket shëndetësisë, arsimit, pjesëmarrjes ekonomike, kushteve të banimit dhe shoqërore" dhe jetoi në një vend të ndotur me plumb. PSSP-ja e pranon që, pa dyshim, kushtet në kampe "ishin të rënda për shkak të situatës së pas konfliktit"; në anën tjetër, ai argumenton që UNMIK-u "i lehtësoi kushtet e rënda aq sa ishte e mundshme derisa ishte gjetur një zgjidhje afatgjatë dhe ishte rindërtuar Lagjja e Romëve". PSSP-ja argumenton më tutje që GJEDNJ "zbaton një standard për provën që ankuesi duhet të dëshmojë se është përtej dyshimit të arsyeshëm se ka ndodhur një shkelje e nenit 2"; megjithatë, sipas mendimit të tij,

ankuesit dështuan të provojnë se ata i ishin nënshtruar trajtimit johuman dhe degradues.

166. Duke iu përgjigjur pretendimeve se UNMIK-u shkeli të drejtën e ankuesve për strehim, shëndet dhe standard adekuat të jetesës, PSSP-ja, në fillim thotë, sipas Komitetit të OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, gjatë përcaktimit se cilat veprime apo lëshime përbëjnë shkelje të së drejtës në shëndet, është e rëndësishme të dallohet "pamundësia" nga "mosgatishmëria" e një pale shtetërore për t'i përmbushur obligimet e veta sipas KNDESK-së. Prandaj PSSP-ja argumenton që dështimi i UNMIK-ut për të gjetur menjëherë një opsion për zhvendosje alternative të komuniteteve të prekura, në dritë të situatës së sigurisë në Kosovë dhe ndotjes afatgjatë nga plumbi në zonën e Mitrovicës, paraqiste "një pamundësi jashtë kontrollit të vet, dhe jo një indikacion i mosgatishmërisë së tij për t'i përmbushur obligimet për të drejtat e njeriut". Sipas PSSP-së të gjitha burimet në dispozicion të UNMIK-ut, me gjithë kufizimet e tyre, "ishin përdorur për t'u siguruar të drejtat e komuniteteve RAE". PSSP-ja thekson më tutje që, pavarësisht të gjitha përpjekjeve të UNMIK-ut, nuk ishte e mundshme të garantohen "standardet më të larta të shëndetit dhe mbrojtje absolute nga kontaminimi me plumb", po ashtu për shkak të praktikave në zejen e shkrirjes së plumbit në kuadër të PZHB-ve, siç është theksuar tashmë më lart. Në lidhje me këtë, ai u referohet komenteve të Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, që miratimi i "stileve jo të shëndetshme dhe me rrezik të jetës", mund të luajë një rol të rëndësishëm për sa i përket shëndetit të individit, e cila mund të përjashtojë përgjegjësinë e shtetit.

167. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 8 të KEDNJ-së, PSSP-ja thekson që UNMIK-u dhe partnerët e tij ndërmorën të gjithë hapat e arsyeshëm për t'i parandaluar faktorët ambientalë që ndikonin në të drejtën e ankuesve për jetë të tyre private dhe familjare. Në përgjigje të parashtresës së ankuesve se atyre u ishte mohuar qasja në informata për rreziqet nga helmimi me plumb në periudhën 2000-2005 dhe që UNMIK-u "ofroi informata të pamjaftueshme pas kësaj" dhe keqinterpretoi të qenit adekuat të kushteve në kamp, PSSP-ja thekson që "Romët mbaheshin vazhdimisht të informuar nga UNMIK-u dhe partnerët e tij, duke përfshirë menaxherët e kampeve dhe profesionistët e angazhuar mjekësorë dhe se ishin organizuar fushata të edukimit publik.

168. PSSP-ja hedh poshtë pretendimin e ankuesve se, si pjesëtarë të komunitetit RAE, ata i ishin nënshtruar diskriminimit të drejtpërdrejtë institucional dhe, në veçanti, se komunitetet e tjera të PZHB-ve ishin trajtuar në mënyrë më të favorshme. PSSP-ja thekson që, në fakt, të gjitha masat e marra nga UNMIK-u tregojnë që nevojat e "komuniteteve RAE' janë trajtuar me prioritet nga UNMIK-u dhe partnerët e tij".

169. PSSP-ja, po ashtu, e hedh poshtë pretendimin që UNMIK-u shkeli dispozitat relevante të KEDKG-së duke mos ndërmarrë veprime për t'i mbrojtur gratë, duke përfshirë gratë shtatzëna dhe fëmijët e tyre të palindur, nga rreziku i helmimit me plumb. PSSP-ja thekson që, siç është përshkruar më lart, UNMIK-u dhe partnerët e tij ndërmorën veprime (duke përfshirë mbylljen e Shkritores së Trepçës, punët rregulluese në kampe, ofrimin e ndihmës mjekësore dhe fushatat e edukimit shëndetësor) dhe që ndikimi specifik i kontaminimit nga plumbi në gratë shtatzëna ishte trajtuar nga OBSH-ja në raportet dhe rekomandimet e saj, në të cilat thuhet se gratë shtatzëna dhe fëmijët duhet të largohen nga kampet. Sipas PSSP-së, "përpjekjet

për t'i larguar personat e cenueshëm nga kampet kishin hasur në rezistencë të komunitetit".

170. Ngjashëm, PSSP-ja hedh poshtë të gjitha pretendimet që UNMIK-u shkeli të drejtat e fëmijëve dhe dispozitat relevante të KDF-së. Në lidhje me këtë ai argumenton që "siç është treguar, UNMIK-u dhe partnerët e vet përmbushën obligimet pozitive për t'i mbrojtur të drejtat e fëmijëve duke siguruar mbrojtje, strehim, përkujdesje shëndetësore dhe arsimim".

171. Sa u përket ankesave sipas nenit 6 dhe 13 të KEDNJ-së, PSSP-ja thekson që, për aq sa ka të bëjë me ankesën sipas nenit 6, UNMIK-u krijoi një sistem funksional të drejtësisë në Kosovë, si dhe Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (duke përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale), të cilat nuk ishin imune ndaj procesit ligjor. Ai thekson që ankuesit nuk ishin parandaluar në çfarëdo mënyre nga të kërkuarit përkrahje apo shërbime nga institucionet e lartpërmendura, e as që kishte ndonjë pengesë procedurale për të kërkuar qasje në gjykatë vis-à-vis këtyre institucioneve. Veç kësaj, sipas mendimit të tij, ankuesit nuk e kanë dëshmuar se atyre u ishte mohuar qasja e tillë në çfarëdo kohe. Sa i përket ankesës sipas nenit 13 të KEDNJ-së, PSSP-ja thekson që privilegjet dhe imunitetet e OKB-së dhe UNMIK-ut, duke përfshirë ato nga procesi ligjor, në Kosovë "bazohen në parime legjitime të së drejtës ndërkombëtare të cilat Paneli Këshillëdhënës nuk është i mandatuar t'i shqyrtojë". Përveç kësaj, edhe Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë edhe Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut janë krijuar me mandatin për t'i shqyrtuar pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut të kryera në Kosovë.

3. Parashtresat shtesë të ankuesve

172. Në komentet e tyre të 5 shkurtit të vitit 2015, ankuesit argumentojnë që parashtresat e PSSP-së që sqarojnë se si UNMIK-u trashëgoi ndotjen ambientale nga plumbi në rajonin e Mitrovicës, i cili kishte ekzistuar me dekada para vendosjes së tij, e bën të qartë se UNMIK-u ishte vënë në dijeni për kontaminimin në kampe para themelimit të tij. Megjithatë, ankuesit qartësojnë se ata nuk parashtrojnë qëndrimin se UNMIK-u është përgjegjës për ndotjen e shkaktuar nga Trepça. Ankesa e tyre fokusohet më parë në dështimin e UNMIK-ut për të marrë masa efektive për të rregulluar gjendjen pasi ata e kishin marrë përgjegjësinë për administrimin e Kosovës dhe për mirëqenien e PZHB-ve.

173. Në përgjigje të argumentimit të PSSP-së se PZHB-të ishin kryesisht përgjegjës për helmimin nga plumbi për shkak të aktiviteteve të tyre në shkrirje, të cilat UNMIK-u nuk ishte në gjendje t'i ndalë, ankuesit theksojnë se këto pretendime nuk mbështeten në dëshmi shkencore. Ankuesit u referohen raporteve të bëra publike nga OBSH-ja dhe organizatat e tjera, në të cilat qartas thuhet që burimi kryesor i helmimit nga plumbi ishte inhalacioni i pluhurit të kontaminuar nga PZHB-të, si dhe niveli jashtëzakonisht i lartë i kontaminimit të dheut në të cilin ishin ndërtuar kampet.

174. Lidhur me masat e miratuara nga UNMIK-u, ankuesit argumentojnë se është e qartë se të gjitha veprimet e përmendura nga PSSP-ja ishin joefektive dhe që UNMIK-u nuk mori ndonjë masë të vetme e cila do ta bënte diferencën, që do të ishte evakuimi i PZHB-ve në një ambient pa plumb, siç është kërkuar në mënyrë të përsëritur nga

OBSH-ja dhe organet e tjera ndërkombëtare. Në veçanti, ankuesit parashtrojnë se kampi Osterode, ku ishin vendosur disa PZHB në vitin 2006, ishte madje edhe më i kontaminuar sesa kampet e tjera. Kjo dëshmohet nga testet e gjakut të bëra në vitin 2008 në PZHB-të që jetonin në Osterode, si dhe fakti që terapia përkatëse dhe masat e tjera rregulluese ishin filluar dhe ndërprerë shpejt nga OBSH-ja, meqë ato nuk janë efektive nëse aplikohen në ambiente të kontaminuara.

175. Sa i përket masës së propozuar nga UNMIK-ut për t'i zhvendosur përkohësisht gratë shtatzëna, ankuesit argumentojnë që nuk ishte e ndjeshme në aspektin kulturor. Vetëm pak gra mund të pranonin ofertën përkohësisht, meqë RAE-të kanë "etikë të fortë familjare", e cila e bën të papranueshme ndarjen nga familja. Ankuesit ankohen më tutje se "zgjidhja nuk ishte të ndahen familjet por të largohen të gjithë PZHB-të nga kontaminimi".

176. Në kundërkomentet e tyre të 5 shkurtit të vitit 2015, ankuesit theksojnë mospërputhjet në argumentet e PSSP-së që UNMIK-u menaxhoi kampet në cilësinë e vet si një administratë e përkohshme dhe jo si një mision paqeruajtës (duke iu nënshtruar kështu kufizimeve buxhetore, shih § 162 më lart) dhe argumentit të paraqitur më lart se UNMIK-u kishte imunitet legjitim diplomatik në Kosovë.

177. Ankuesit, po ashtu, e kundërshtojnë që PSSP-ja nuk kishte paraqitur ndonjë dëshmi që vërteton se UNMIK-u u ofroi informata adekuate komuniteteve të prekura, duke përfshirë referimin në "instanca specifike, dëshmitë nën betim, kopjet e njoftimeve, shpalljet rreth takimeve të komunitetit, njoftimet për takimet, nënshkrimin në listat e pjesëmarrjes".

178. Veç kësaj, në përgjigje të argumentimit të PSSP-së se ankuesit nuk dorëzuan dëshmi të mjaftueshme për të dëshmuar dëmin e shkaktuar, ankuesit theksojnë se ata i kanë siguruar dëshmi të forta Panelit, duke përfshirë kopjet e testeve të gjakut, raportet mjekësore, mendimet e ekspertëve, studimet shkencore, raportet e OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare. Ata theksojnë se po të kishin pasur qasje në shërbime adekuate mjekësore, ata do të kishin qenë në pozitë të ofrojnë dëshmi mjekësore shtesë. Në anën tjetër, ata përsërisin se PSSP-ja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi apo çfarëdo qoftë dokumentacioni për t'i mbështetur argumentet e veta.

B. Observimet preliminare të Panelit

1. Fusha për t'u shqyrtuar nga Paneli

179. Para se ta shqyrtojë bazueshmërinë e ankesës, Paneli duhet ta qartësojë fushën e shqyrtimit.

180. Paneli thekson më tutje se neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 siguron që Paneli ka juridiksion mbi ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut "që kanë ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 apo që rrjedhin nga faktet të cilat kanë ndodhur para kësaj date, ku këto fakte shkaktojnë një shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Pra, ngjarjet që kanë ndodhur para 23 prillit 2005, përgjithësisht janë jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit. Megjithatë, në rastin kur ngjarjet e tilla kanë shkaktuar një situatë të vazhdueshme, Paneli ka juridiksion t'i shqyrtojë

ankesat që ndërlidhen me atë situatë por vetëm për aq sa situata ka vazhduar pas 23 prillit të vitit 2005.

181. Paneli, po ashtu, thekson që neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut numër 2006/12, i 23 marsit 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut siguron që Paneli "shqyrton ankesat nga çdo person apo grup individësh që pohojnë të jenë viktimë e shkeljes së të drejtave (të tyre) të njeriut nga UNMIK-u". Pra vetëm aktet apo lëshimet që i atribuohen UNMIK-ut bien brenda juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Në lidhje me këtë, duhet përmendur, siç është theksuar më lart, se pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga autoritetet e Kosovës, në maj të vitit 2008, përgjegjësia e mbikëqyrjes për menaxhimin e kampeve u transferua nga UNMIK-u te Ministria e Kosovës për Komunitete dhe Kthim. Nga kjo rrjedh se pas kësaj date UNMIK-u nuk ushtron më autoritetin ekzekutiv mbi kampet. UNMIK-u nuk bart asnjë përgjegjësi për ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut që pretendohet se janë kryer pasi autoritetet e Kosovës e morën mbi vete përgjegjësinë. Sa u përket ankuesve të cilët ankohen rreth akteve që kanë ndodhur pas asaj date, ato janë jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit.

182. Paneli thekson që me miratimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1, më 25 korrik 1999, UNMIK-u mori përsipër obligimin që t'i zbatojë standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve të veta. Ky zotim u detajua në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, të 12 dhjetorit 1999, me të cilën UNMIK-u mori obligimet sipas këtyre instrumenteve për të drejtat e njeriut: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet me të, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Tjetër Mizor, Jonjerëzor dhe Degradues dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.

183. Prandaj, Paneli thekson që, sa i përket juridiksionit të vet *ratione materiae*, siç vijon nga neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai mund t'i shqyrtojë aktet apo lëshimet për të cilat është bërë ankesë rreth pajtueshmërisë së tyre me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cekura më lart.

184. Paneli, po ashtu, inspirohet nga Parimet Udhëheqëse të OKB-së mbi Zhvendosjen Brenda Vendit[56], të cilat janë bazuar në standardet ekzistuese normative të traktateve në § 182 më lart.

2. Pesha e dëshmisë

185. Në fillim, Paneli thekson se fakte të caktuara për rastin kontestohen nga palët dhe kjo ngrit çështjen e peshës së dëshmisë.

186. Në lidhje me këtë, Paneli i referohet qasjes së GJEDNJ-së dhe qasjes së vet të mëparshme. Rregull e përgjithshme është që i takon palës që e mbron një propozim apo fakt, ta dëshmojë atë, por kjo nuk është një rregull rigjide.

[56] Dok. i OKB-së E/CN.4/1998/53/Add.2.

187. Gjykata ka konsideruar se, kur vlerësohet dëshmia, parim i përgjithshëm ka qenë të zbatohet standardi i dëshmisë "përtej dyshimit të arsyeshëm". Megjithatë, ka qenë praktikë e Gjykatës dhe vetë praktikë e Panelit të lejohet fleksibilitet, duke marrë parasysh natyrën e të drejtës substanciale në rrezik dhe ndonjë vështirësi në provat e përfshira. Në lidhje me këtë, Gjykata po ashtu ka theksuar që nëse autoritetet dështojnë t'i zbulojnë dokumentet vendimtare për t'i mundësuar gjykatës t'i verifikojë faktet apo ndryshe të japin një sqarim të kënaqshëm dhe bindës, dëshmia e tillë mund të pasojë nga një bashkekzistencë e konkluzioneve mjaftueshëm të forta, të qarta dhe të harmonishme apo nga supozime të pakundërshtueshme për faktin (shih, GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 16064/90, 16065/90, 16066/90, 16068/90, 16069/90, 16070/90, 16071/90, 16072/90 dhe 16073/90, vendimi i 18 shtatorit të vitit 2009, në § 184; shih po ashtu, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut (KDNJ), *Benaniza kundër Algjerisë*, mendimet e 26 korrikut 2010, në § 9.4, Dok. i OKB-së KDCP/C/99/D/1588/2007; KDNJ, *Bashasha kundër Xhamahirisë Arabe të Libisë*, mendimet e 20 tetorit 2010, në § 7.2, Dok. i OKB-së KDCP/C/100/D/1776/2008; shih po ashtu, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ), *Jokiq kundër UNMIK-ut*, lënda nr. 34/09, mendimi i 23 prillit të vitit 2013, në §§ 62-64).

188. Paneli thekson që kjo jurisprudencë ndërkombëtare, e cila së pari është zhvilluar në një kontekst ku qeveritë përkatëse mund të mbahen drejtpërdrejt përgjegjëse për vrasjet dhe zhdukjet e imponuara, është zbatuar më pas edhe te shkeljet e pretenduara të së drejtës në jetë që dalin nga çështjet ambientale (shih GJEDNJ, *Budayeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 15339/02, 21166/02, 20058/02, 11673/02 dhe 15343/02, vendimi i 20 marsit të vitit 2008, në § 146, GJEDNJ, *Fadeyeva kundër Rusisë*, nr. 55723/00, vendimi i 9 qershorit të vitit 2005, në §§ 79-80).

189. Duke iu kthyer rastit aktual, Paneli posaçërisht e ka parasysh situatën e veçantë të ankuesve, si PZHB, dhe sfidat e ndërlidhura për marrjen e dëshmive përtej dokumenteve që i janë ofruar Panelit (shih §§ 31-32 më lart).

190. Paneli, po ashtu, e ka parasysh faktin që asnjë dokumentacion nuk është dorëzuar nga UNMIK-u, pavarësisht njohurisë së veçantë që UNMIK-u kishte apo është dashur të ketë rreth gjendjes shëndetësore në kampe dhe pavarësisht nga kërkesat e përsëritura të Panelit për t'i dorëzuar posaçërisht ato dokumente që janë përmendur nga apo në të cilat është mbështetur PSSP-ja.

191. Paneli thekson se në nenin 15 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, thuhet që Paneli mund të kërkojë dorëzimin nga UNMIK-u të çdo dokumenti dhe që PSSP-ja të bashkëpunojë me Panelin dhe të sigurojë ndihmën e nevojshme duke përfshirë, në veçanti, lëshimin e dokumenteve dhe informatave relevante për ankesën. Paneli në lidhje me këtë i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që duhet nxjerrë konkluzion nga sjellja e palës së paditur gjatë procedurave, duke përfshirë dështimin e vet "për t'i dorëzuar informatat në duart e tyre pa një sqarim të kënaqshëm" (shih GJEDNJ, *Çelikbilek kundër Turqisë*, nr. 27693/95, vendimi i gjykatës, 31 maj 2005, § 56).

192. Prandaj, Paneli konsideron se parimi që "konkluzione të forta" mund të nxirren nga dokumentacioni në dispozicion, është i aplikueshëm në rastin aktual.

C. Vlerësimi i Panelit

1. Shkelja e pretenduar e të drejtës në jetë

a) Obligimi esencial

193. Në vendimin e vet mbi pranueshmërinë të 9 qershorit të vitit 2009, Paneli i shpalli ankesat të papranueshme *ratione temporis* lidhur me vdekjen e D.M. (e cila vdiq më 22 korrik 2004), dhe të papranueshme për shkak të rregullës për gjashtë muaj të ankesave lidhur me vdekjet e R.M. (e cila vdiq në qershor të vitit 2005), dhe V.S. (i cili vdiq më 13 korrik 2005, shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët kundër UNMIK-ut*, lënda nr. 26/08, vendimi i 5 qershorit të vitit 2009, në § 57). Në anën tjetër, Paneli e shpalli të pranueshme sipas nenit 2 të KEDNJ-së, obligimi esencial, pjesën e mbetur të ankesës, lidhur me kushtet në rrethana kërcënimi me jetë në kampe.

i) Parimet e përgjithshme

194. Paneli rikujton që Gjykata Evropiane ka konsideruar që neni 2 jo vetëm që ngarkon obligimin mbi autoritetet për t'u përmbajtur nga marrja e qëllimshme e jetëve, por gjithashtu vendos një obligim pozitiv për të ndërmarrë hapat e duhur për t'i mbrojtur jetët e atyre nën juridiksionin e tyre (shih, për shembull, GJEDNJ, *L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14/1997/798/1001, vendimi i 9 qershorit të vitit 1998, në § 36, dhe GJEDNJ, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, vendimi i 14 marsit të vitit 2002, në § 54; GJEDNJ [DHL], *Öneryıldız kundër Turqisë*, nr. 48939/99, vendimi i 30 nëntorit të vitit 2004, në § 71; GJEDNJ, *Budayeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 15339/02, 21166/02, 20058/02, 11673/02 dhe 15343/02, vendimi i 20 marsit të vitit 2008, në § 128). Ky obligim vlen në kontekst të çdo aktiviteti, dhe *a fortiori* në rastin e aktiviteteve industriale të cilat janë të rrezikshme sipas natyrës së tyre, siç janë operimi në vende për mbledhjen e mbeturinave (shih GJEDNJ [DHL], *Öneryıldız kundër Turqisë*, përmendur më lart, në §§ 71 dhe 90), testimi nuklear (shih GJEDNJ, *L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur më lart, në § 38), ekspozimi ndaj lirimeve nga fabrika e plehrave kimike (shih GJEDNJ, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 116/1996/735/932, vendimi i 19 shkurtit të vitit 1998, në §§ 60 dhe 62) apo ekspozimi i punëtorëve në asbest (shih GJEDNJ, *Brincat dhe të tjerët kundër Maltës*, nr. 60908/11, 62110/11, 62129/11, 62312/11 dhe 62338/11, vendimi i 24 korrikut të vitit 2014, në § 81).

195. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane, obligimi pozitiv për të ndërmarrë të gjithë hapat e duhur për të mbrojtur të drejtën në jetë sipas kërkesave të nenit 2, përfshin një detyrë primare mbi autoritetet që të vendosin në vend një kornizë legjislative dhe administrative të dizajnuar për të ofruar një përmbajtje efektive kundrejt kërcënimeve të së drejtës në jetë (shih GJEDNJ [DHL], *Öneryıldız kundër Turqisë*, përmendur më lart, në §§ 89-118; GJEDNJ, *Budayeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, përmendur më lart, në § 129; GJEDNJ, *Vilnes dhe të tjerët kundër Norvegjisë*, nr. 52806/09 dhe 22703/10, vendimi i 5 dhjetorit të vitit 2013 § 220; GJEDNJ, *Brincat dhe të tjerët kundër Maltës*, përmendur më lart, në § 101).

196. Në kontekst të aktiviteteve të rrezikshme, Gjykata ka gjetur që theks i veçantë duhet vënë rregulloreve të përshtatura për karakteristika speciale të aktivitetit në fjalë,

veçanërisht në lidhje me nivelin e rrezikut potencial për jetët e njerëzve. Ato duhet kërkuar licencimin, organizimin, operimin, sigurinë dhe mbikëqyrjen e aktivitetit dhe duhet ta bëjnë të detyrueshme për të gjitha palët e përfshira që "të marrin masa praktike për të siguruar mbrojtje efektive të qytetarëve, jetët e të cilëve mund të rrezikohen nga aktivitetet ekzistuese". Gjykata ka konsideruar që, në mesin e këtyre masave parandaluese, theks i veçantë duhet vënë të drejtës së publikut për informata, siç është e vendosur në praktikën gjyqësore të institucioneve përgjithësisht (GJEDNJ [DHL], *Öneryıldız kundër Turqisë*, përmendur në § 194 më lart, në § 90).

197. Për sa i përket zgjedhjes së masave të caktuara praktike për t'i përmbushur obligimet sipas nenit 2, Gjykata Evropiane vazhdimisht ka konsideruar që, ku shtetit i kërkohet të marrë masa pozitive, zgjedhja e mjeteve në parim është një çështje që bie në kuadër të margjinës së vlerësimit të shtetit në fjalë (shih, në mes rastesh tjera, GJEDNJ, *Fadeyeva kundër Rusisë*, nr. 55723/00, vendimi i 9 qershorit të vitit 2005, në § 96). Gjatë vlerësimit të asaj nëse autoritetet kanë përmbushur obligimin e tyre, Gjykata duhet të marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit, vlerësimin që është bërë, në mesin e elementeve tjera, për ligjshmërinë e brendshme të akteve apo lëshimeve të autoriteteve, procesin e brendshëm vendimmarrës, duke përfshirë hetimet dhe studimet e duhura, dhe kompleksitetin e çështjes, veçanërisht ku janë përfshirë interesat kundërshtuese përgjithësisht (shih GJEDNJ [DHL], *Hatton dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36022/97, vendimi i 8 korrikut të vitit 2003, në § 128; GJEDNJ, *Fadeyeva kundër Rusisë*, përmendur në § 194 më lart, në §§ 96-98). Në këtë drejtim "një peshë e pamundshme apo joproporcionale nuk duhet ngarkuar autoriteteve pa marrë parasysh, në veçanti, zgjedhjet operacionale të cilat ato duhet t'i bëjnë për sa u përket prioriteteve dhe burimeve" (shih GJEDNJ, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 87/1997/871/1083, vendimi i 28 tetorit të vitit 1998, në § 116).

198. Paneli, po ashtu, rikujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane se mund të ketë një obligim pozitiv sipas nenit 2 për autoritetet që të mbrojnë jetën e individit nga palët e treta apo nga një "kërcënim ndaj integritetit të tyre fizik" (GJEDNJ, *Budayeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, përmendur në § 194 më lart, në § 146) apo rrezik nga "sëmundje që paraqet rrezik për jetën" (GJEDNJ [DHL], *Makaratzis kundër Greqisë*, nr. 50385/99, vendimi i 20 dhjetorit të vitit 2004, në § 49). Prandaj, neni 2 po ashtu vlen ku asnjë jetë nuk humbet, duke pasur parasysh rrethanat e rastit dhe objektin dhe qëllimin që ndiqet nga neni 2 (shih, GJEDNJ, *Budayeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, përmendur më lart, § 146; *mutatis mutandis*, GJEDNJ [DHL], *Makaratzis kundër Greqisë*, përmendur më lart, në §§ 49-50; shih gjithashtu PKDNJ, *Balaj dhe të tjerët kundër UNMIK-ut*, lënda nr. 04/07, mendimi i 27 shkurtit të vitit 2015, në §§ 162-180).

199. Paneli, po ashtu, i referohet jurisprudencës së traktateve-organeve për të drejtat e njeriut të OKB-së që e drejta në jetë "shumë shpesh është interpretuar ngushtë". KDNJ ka theksuar se mbrojtja e kësaj të drejte kërkon që shtetet të miratojnë masa pozitive dhe, në lidhje me këtë, ka konsideruar që "do të ishte e dëshirueshme që palët shtetërore *t'i marrin të gjitha masat e mundshme* për të zvogëluar vdekshmërinë e fëmijëve dhe shtuar jetëgjatësinë, veçanërisht gjatë miratimit të masave për të eliminuar mungesën e ushqimit dhe epidemitë" (shih KDNJ, Komenti i përgjithshëm nr. 6, Dok. i OKB-së HRI/GEN/1/Rev.1 (1994), në § 5). Komiteti ka theksuar se detyra për të miratuar masa pozitive me qëllim të mbrojtjes së jetës së njeriut në

parim vlen po ashtu te çështjet ambientale, siç janë ato që përfshijnë magazinimin e mbetjeve radioaktive në zonat e banueshme (shih, KDNJ, *EHP kundër Kanadasë*, komunikata nr. 67/1980, vendimi i 27 tetorit të vitit 1982) apo ekspozimi ndaj rrezatimit që buron nga testet nukleare (shih KDNJ, *Bordes dhe Temeharo kundër Francës*, komunikata nr. 167/1984, mendimet e 22 korrikut të vitit 1996, KDNJ e shpalli rastin e parë të papranueshëm për shkak të mosshterjes së mjeteve juridike, ndërsa në kontrast nuk gjeti asnjë shkelje të së drejtës në jetë në rastin e dytë, për shkak të dështimit të ankuesve për t'i bazuar pretendimet e tyre).

200. Paneli i referohet më tutje praktikës gjyqësore të zhvilluar nga Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut (GJNADNJ) lidhur me shkeljen e pretenduar të së drejtës në jetë të komuniteteve indigjene. Gjykata Ndër-Amerikane ka theksuar që e drejta në jetë përfshin miratimin e masave pozitive për të siguruar "qasje në kushtet që mund të garantojnë jetë të mirë". Gjykata e ka përcaktuar se nga ky obligim i përgjithshëm "burojnë detyra të veçanta sipas nevojave të veçanta për mbrojtje të personave juridikë, si për shkak të gjendjes së tyre personale, apo për shkak të situatës specifike që ata duhet ta përballin, siç janë varfëria ekstreme, përjashtimi apo fëmijëria" (shih GJNADNJ, *Komuniteti indigjen Sawhoyamaxa kundër Paraguait*, vendimi i 29 marsit të vitit 2006, në §§ 153-154; shih gjithashtu GJNADNJ, *Komuniteti indigjen Xákmok Kásek kundër Paraguait*, vendimi i 24 gushtit të vitit 2010). GJNADNJ e ka qartësuar më tutje se "me qëllim që të dalë ky obligim pozitiv, duhet përcaktuar në momentin e ndodhjes së ngjarjeve që autoritetet dinin apo është dashur të dinë për ekzistencën e një situate që paraqiste rrezik për jetën e një individi apo grupi individësh, dhe që masat e nevojshme nuk ishin miratuar në kuadër të fushëveprimit të autoritetit të tyre, të cilat arsyeshëm mund të pritej të parandalojnë apo shmangin rrezikun e tillë" (GJNADNJ, *Komuniteti indigjen Sawhoyamaxa kundër Paraguait*, përmendur më lart, në § 155).

ii) Aplikueshmëria në rastin aktual

201. Në fillim, Paneli thekson se PSSP-ja nuk e konteston aplikueshmërinë e nenit 2 të KEDNJ-së, që e mbron të drejtën në jetë, në këtë pjesë të ankesës. Megjithatë, ai e hedh poshtë pohimin që UNMIK-u shkeli obligimet e veta pozitive sipas kësaj dispozite. PSSP-ja thekson se kur UNMIK-u u vu në dijeni për rreziqet për shëndetin që burojnë nga plumbi, ai mori të gjitha masat e nevojshme që ishin në kuadër të mjeteve që i kishte-duke pasur parasysh buxhetin e vet si administratë e përkohshme dhe sfidat pas konfliktit – për të parandaluar materializimin e atyre rreziqeve. Masat përfshinin ndërmarrjen e hapave për të minimizuar ndotjen nga plumbi në kampe, vendosjen në Osterode, ofrimin në Osterode të objekteve dhe trajtimit mjekësor "sipas standardit të Kosovës", dhe ofrimin e edukimit për rreziqet nga kontaminimi me plumb. Përveç kësaj, PSSP-ja argumenton që gjendjet mjekësore që pretendohet t'i kenë pasur ankuesit nuk janë dokumentuar plotësisht dhe nuk është provuar që ndonjë vdekje në kampe (dhe në veçanti vdekja e D.M., R.M. dhe V.S.), ishte shkaktuar aktualisht nga helmimi me plumb (shih §§ 163-164 më lart).

202. Paneli do të shqyrtojë së pari vërejtjen e PSSP-së se gjendjet e pretenduara shëndetliga të ankuesve dhe lidhja e tyre kauzale me helmimin nga plumbi nuk janë dokumentuar si duhet. Në dritë të komenteve të PSSP-së, të përmendura më lart, rreth hapave që thuhet të jenë ndërmarrë nga UNMIK-u me qëllim të minimizimit të rrezikut që rrjedh nga ndotja me plumb, Paneli konsideron se nuk kontestohet nga

PSSP-ja se kampet e PZHB-ve ishin të kontaminuara me plumb. Megjithatë, PSSP-ja nuk e konteston se ankuesit dhanë dëshmi të mjaftueshme se ata kishin gjendje të keqe shëndetësore si pasojë e ekspozimit të tyre ndaj helmimit me plumb. Nga ana e tyre, ankuesit theksojnë që ata kanë ofruar dëshmi të forta që dëshmojnë gjerësisht për kontaminimin me plumb në kampe, si dhe ekspozimin e tyre individual ndaj plumbit. Ata argumentojnë se, meqë ata nuk kanë pasur qasje në shërbime adekuate mjekësore-e cila është pjesë thelbësore e ankesës së tyre-ata nuk ishin në gjendje të ofrojnë dokumentacion tjetër mjekësor për gjendjen e tyre të keqe shëndetësore.

203. Paneli rikujton që ankuesit paraqitën dëshminë vijuese: deklaratat në të cilat ata përmendin simptomat e tyre dhe gjendjen e shëndetit të keq; kopjet e testeve të gjakut dhe flokëve të kryera nga disa institucione në të gjitha kampet në periudhën 2005-2008; mendimet e ekspertëve në të cilat thuhet se simptomat që shfaqnin ankuesit janë "të përputhshme" me helmimin nga plumbi (shih § 120 më lart). Paneli është i kënaqur që testet e gjakut dhe flokëve dëshmojnë që, së paku gjatë gjithë periudhës 2005-2008, ankuesit dhe familjet e tyre kishin vazhdimisht nivele të larta apo jashtëzakonisht të larta të plumbit të akumuluar në gjakun dhe trupat e tyre, duke përfshirë kohën pas vendosjes së pjesshme në Osterode. Paneli thekson që, sipas këtyre testeve, shumë nga ankuesit (kryesisht fëmijë) ishin kualifikuar si "emergjenca mjekësore" sipas standardeve të OBSH-së. Paneli, po ashtu, i ka parasysh rezultatet e testeve lidhur me numrin e madh të PZHB-ve, të cilët nuk janë si ankues para Panelit. Këta PZHB, po ashtu, është gjetur se kanë pasur nivele të NPGJ-së të larta apo jashtëzakonisht të larta, cila tregon për shkallë të gjerë të kontaminimit të lartë me plumb në kampe ku ankuesit ishin duke jetuar. Paneli thekson se autenticiteti i këtyre testeve nuk është kontestuar nga PSSP-ja.

204. Paneli, po ashtu, e merr parasysh dokumentacionin e ofruar nga familja e D.M., e cila vdiq në kampin në Zhikoc në vitin 2004. Në këtë dokumentacion, autenticiteti i të cilit nuk është kontestuar nga PSSP-ja, thuhet: a) që D.M. ishte hospitalizuar me konvulsione dhe vdiq në vitin 2004 nga *herpes virales* në moshën katërvjeçare, pa u kryer asnjë test për praninë e plumbit tek ajo; b) që N.M., motra më e vogël e D.M. ishte hospitalizuar për herë të parë në vitin 2004 me konvulzione, kriza dhe inflamacion të bajameve dhe, përsëri, në vitin 2005, kur ajo ishte diagnostikuar me helmim nga plumbi (NPGJ më i lartë se 65 µg/dL) dhe anemi; c) që katër anëtarët e tjerë të familjes kishin NPGJ më të lartë se 65 µg/dL në vitin 2005 (shih § 119 më lart). Paneli është i mendimit se historia mjekësore e familjes M., siç është dokumentuar, ofron dëshmi jo të hollësishme për gjendjet e këqija shëndetësore që burojnë nga nivelet e larta të plumbit në trupat e ankuesve të tjerë.

205. Paneli e merr parasysh më tutje literaturën mjekësore dhe studimet shkencore mbi helmimin me plumb, duke përfshirë artikujt e dorëzuar nga ankuesit, të cilët që nga 1970-ta potencojnë pa kundërshtim efektet negative të plumbit në çdo organ të trupit të njeriut. Në studimet më të fundit thuhet se nuk ka "nivel të sigurt" të ekspozimit ndaj plumbit dhe që po ashtu ekspozimi i gjatë në sasi të ulët, nëse nuk trajtohet, mund të ketë efekte të pakthyeshme afatgjata në sistemet e imunitetit, reproduktiv dhe kardiovaskular, me simptoma dhe efekte të rënda që rriten ndërsa ekspozimi po ashtu rritet (shih §§ 64–67 më lart). Paneli veçanërisht thekson studimet që tregojnë se plumbi absorbohet më lehtë te fëmijët, zhvillimi dhe rritja e të cilëve rrezikohet pakthyeshëm nga ekspozimi në plumb. Paneli, po ashtu, rikujton të gjeturat shkencore sipas të cilave plumbi paraqet një kërcënim serioz për shëndetin dhe jetën e grave

shtatzëna dhe fetuseve. Paneli në fund thekson se hulumtimi është, po ashtu, në pajtim me të indikuarit që efektet negative të plumbit përkeqësohen nga niveli i dobët i higjienës dhe ushqimit.

206. Paneli, po ashtu, i merr parasysh raportet e agjencive të specializuara të OKB-së (OBSH) dhe organeve për të drejtat e njeriut (organet-traktatet e OKB-së për të drejtat e njeriut dhe raportuesit specialë), si dhe atyre organizatave tjera nacionale dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (në mes tjerash Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, HRW-së, Komisarit të KiE-së për të drejtat e njeriut) që mbulojnë periudhën relevante (2004-2008), autoriteti i të cilave nuk është kontestuar nga PSSP-ja. Paneli thekson se këto organe dhe organizata, inspektuan kampet dhe e regjistruan situatën si situatë serioze që paraqet kërcënim serioz për jetën dhe shëndetin e PZHB-ve romë. Në veçanti, Paneli rikujton: deklaratat e OBSH-së të vitit 2004 se gjysma e fëmijëve të testuar ishin në situatë të "emergjencës mjekësore" (shih § 72 më lart) dhe që "jetët e tyre dhe mundësitë për zhvillim janë në rrezik" (shih § 76 më lart); deklarata e vitit 2009 e OBSH-së se "banorët e kampeve kanë toksiticitet nga plumbi kërcënues për jetën të provuar përmes të gjeturave laboratorike dhe klinike" (shih § 60 më lart); një thirrje e përbashkët në vitin 2006 e OBSH-së, UNICEF-it dhe UNMIK-ut me të cilën u kërkohej PZHB-ve nga Kablare, Cesminluke dhe Zhikoc të vendosen në Osterode si një "kërkesë emergjente shëndetësore" dhe të parandalohen "pasojat serioze për shëndetin" (shih § 56 më lart); mendimin e vitit 2005 të Komitetit Këshillimor të KiE-së mbi Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale në të cilën thuhet se gjendja e PZHB-ve "përbën një rrezik serioz për shëndetin në veçanti të fëmijëve dhe grave shtatzëna" (shih § 87 më lart); raportin e vitit 2009 të HRW mbi situatën veçanërisht shqetësuese të PZHB-ve fëmijë, të cilët për shkak të sistemeve të tyre të dobëta imunitare dhe si pasojë e ushqimit dhe higjienës së keqe, ishin të cenueshëm ndaj të gjitha llojeve të sëmundjeve dhe epidemive, siç janë diarreja, problemet me lëkurë, pneumonia (shih § 87 më lart); letra e vitit 2009 e Komisarit të KiE-së për të Drejtat e Njeriut drejtuar PSSP-së, në të cilën thuhet që fëmijët që ai i kishte takuar në kampe ishin "qartas më pak të zhvilluar krahasuar me moshën e tyre" dhe e përkufizoi situatën në kampe si një "fatkeqësi humanitare" (shih § 87 më lart).

207. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Paneli konsideron se ekspozimi i rëndë në kontaminim, i shoqëruar me kushtet e rënda të jetës në kampe, një situatë që zgjati për më shumë se 10 vjet, tri nga to brenda juridiksionit të Panelit, ishte i tillë që paraqiste kërcënim real dhe të drejtpërdrejtë për jetën dhe integritetin fizik të ankuesve. Paneli, po ashtu, konsideron si të provuara kushtet e këqija për shëndetin të cilave u nënshtroheshin ankuesit dhe veçanërisht fëmijët dhe gratë shtatzëna, si rezultat i ekspozimit të tyre të gjatë ndaj plumbit.

208. Paneli thekson më tutje që kjo situatë jo vetëm që preku ankuesit por të gjithë banorët e kampeve, përafërsisht 600 PZHB e që paraqesin pjesën e mbetur të popullatës rome në Mitrovicën veriore pas shkatërrimit të lagjes së tyre. Në dritë të këtyre të dhënave, Paneli po ashtu konsideron se shtrirja dhe shkalla e kontaminimit me plumb, e shoqëruar me kushtet e rënda të jetës, ndikoi shumë në të drejtën e RAE-ve në Mitrovicën veriore për ekzistencë të përshtatshme dhe të sigurt, dinjitet njerëzor dhe në të vërtetë mbijetesë fizike.

209. Sa i përket njohurisë së UNMIK-ut për situatën, Paneli thekson se UNMIK-u ishte në dijeni për rreziqet që burojnë nga puna e Kompleksit Trepça në Mitrovicën veriore, që nga koha e arritjes së tij në Kosovë në vitin 1999 (shih § 69 më lart). Në fakt, atëherë ish-PSSP-ja, Bernard Kouchner, urdhëroi që të mbyllet shkritorja duke marrë si arsye shëndetin publik në gusht të vitit 2000. Lidhur me situatën e ankuesve, Paneli konsideron që është vërtetuar se UNMIK-u u vu në dijeni për rreziqet për shëndetin të cilave ata u ekspozoheshin që nga nëntori i vitit 2000 (shih §§ 48 dhe 70 më lart). Paneli konsideron më tutje se UNMIK-u u vu në dijeni, duke përfshirë mënyrën përmes komunikimit të të gjeturave klinike të OBSH-së, për situatën aktuale kritike për shëndetin që ishte si pasojë e kontaminimit me plumb dhe kushteve të vështira të jetës në kampe, deri në tetor të vitit 2004 (shih §§ 74 dhe 206 më lart).

210. Paneli po ashtu thekson që, duke u bazuar në dokumentet që i janë vënë në dispozicion, UNMIK-u po ashtu e dinte, apo është dashur ta dijë, që burimi kryesor i ekspozimit në plumb ishte afërsia e kampeve me Shkritoren dhe Kompleksin Trepça, dhe jo aktivitetet joformale të shkrirjes që kryheshin nga PZHB-të, siç pohohet por jo mbështetet nga PSSP-ja. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton në veçanti të gjeturat e tetorit të vitit 2004 të ekspertëve të OBSH-së, që 88.23 % e dheut ishte "i pasigurt për t'u shfrytëzuar për banim nga njerëzit dhe për kopshtari" (shih § 74 më lart), si dhe vlerësimet pasuese (në vitin 2007 nga KDNJ dhe në vitin 2010 nga UNEP), të cilat identifikuan gjendjen e kampeve, drejtimin e erës nga grumbujt me hedhurina dhe digat ndarëse dhe pajisjen e kontaminuar, ndërtesat dhe dheun e kontaminuar të lënë prapa nga Trepça si burime kryesore të ekspozimit ndaj plumbit (shih §§ 78 dhe 81 më lart).

211. Paneli në vijim do ta vlerësojë nëse UNMIK-u ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme që arsyeshëm mund të priteshin nga ai për të mbrojtur të drejtën e ankuesve në jetë, siç kërkohet me nenin 2 të KEDNJ-së.

212. Duke u bazuar në komentet e PSSP-së në lidhje me këtë, Paneli thekson se veprimet e vetme të ndërmarra nga UNMIK-u prej marsit/prillit të vitit 2005 ishin akomodimi i 12 familjeve të PZHB-ve për dy javë në një hotel jashtë Mitrovicës, dhe ndërmarrja e disa aktiviteteve sporadike rregulluese (p.sh. pastrimi i kampit dhe shpërndarja e shtesave ushqimore) në Cesminluke (shih § 53 më lart). Paneli thekson që, si rezultat i mosaktivitetit të UNMIK-ut, rreziqet për shëndetin që buronin nga kontaminimi me plumb në kampe vazhduan dhe ka të ngjarë u shtuan për shkak të ekspozimit të gjatë të popullatës PZHB në plumb dhe mungesën e vazhdueshme të qasjes në shërbime elementare siç janë ushqimi, higjiena dhe përkujdesja adekuate shëndetësore. Duke ardhur te periudha nën juridiksionin e Panelit, nga 23 prilli i vitit 2005, Paneli thekson se disa përpjekje ishin bërë në këtë periudhë, për të qenë specifik krijimi dhe implementimi i një Plani për Menaxhimin e Rrezikut dhe krijimi i EVM për të zvogëluar nivelin e ekspozimit ndaj plumbit dhe metaleve tjera të rënda ndërsa kërkohej të gjendej një vend për zhvendosje që nuk kishte plumb për PZHB-të romë.

213. Paneli konsideron që, veçanërisht në vakuumin rregullues dhe institucional në Kosovë pas konfliktit, të gjeturat dhe rekomandimet e ekspertëve të OBSH-së si dhe organeve tjera të specializuara, duhet të kenë informuar për veprimet e UNMIK-ut në përgjigje ndaj krizës shëndetësore në kampe. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se, nga qershori-tetori i vitit 2004, OBSH-ja i kishte identifikuar masat kryesore për t'u marrë me qëllim të parandalimit të materializimit të rreziqeve serioze për jetën e

PZHB-ve dhe i ka kërkuar UNMIK-ut të ndërmarrë veprim me kohë në lidhje me këtë. Këto masa përfshinin: a) largimin e PZHB-ve fëmijë nga burimi i të ekspozuarit (që do të thotë largim i menjëhershëm nga kampet të fëmijëve dhe grave shtatzëna dhe një zhvendosje e përkohshme dhe e përhershme e kampeve në një vend të sigurt); b) ofrimi i shërbimeve mjekësore, që do të thotë hospitalizimi dhe trajtimi i menjëhershëm i pacientëve që është gjetur të kenë NPGJ-në më të lartë (më të lartë se 70 mg/dL); analizë mjekësore dhe trajtim për ata që është gjetur të kenë NPGJ prej 30 mg/dL dhe më lart; monitorimin në bazë javore të atyre që janë gjetur me NPGJ-në më të vogël. Përveç kësaj, OBSH rekomandoi që të merren masa shtesë për pjesën e mbetur të banorëve në kamp, duke përfshirë edukimin, formimin e një sistemi për referime dhe ndërmarrjen e një hulumtimi për ambientin (shih § 76 më lart).

214. Në të vërtetë, sipas parashtresave të PSSP-së, Plani për Menaxhim të Rrezikut i përmendur më lart, i cili ishte iniciuar nga mesi i vitit 2005, në parim bazohej në rekomandimet e OBSH-së. Megjithatë, Paneli thekson që, pavarësisht nga kërkesat e përsëritura në këtë drejtim, UNMIK-u nuk i ofroi atij ndonjë dëshmi për shtrirjen e veprimeve të ndërmarra për të parandaluar dëmin për PZHB-të, siç përmenden ato nga PSSP-ja. Nga ana e tij, duke u bazuar në dokumentet e dorëzuar nga ankuesit dhe ato në dispozicion në fushën publike, Paneli thekson se shumica e masave të rëndësishme preventive siç ceken nga OBSH nuk ishin implementuar, apo ishin implementuar për vetëm një periudhë shumë të kufizuar kohore.

215. Sa i përket çështjes së zhvendosjes së PZHB-ve të prekur nga kampet e kontaminuara, Paneli njeh përpjekjet e UNMIK-ut, nga viti 2005 e më tej, për të mbledhur fonde dhe rindërtuar Lagjen e Romëve. Paneli, megjithatë, pajtohet me vlerësimin e bërë nga Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë se rindërtimi i Lagjes së Romëve, që ishte paraparë të zgjaste së paku deri në vitin 2007, nuk mund të vlerësohej si zgjidhje për nevojën për evakuim urgjent nga kampet (shih § 52 më lart). Paneli, po ashtu, konsideron se vendosja e shumë PZHB-ve në Osterode në vitin 2006, nuk ishte as e duhur dhe as e përshtatshme për qëllimin për t'i larguar PZHB-të nga burimi i kontaminimit. Kampi Osterode ishte po ashtu i kontaminuar, siç tregohet nga vazhdueshmëria e NPGJ-së te banorët e tij dhe siç konfirmohet nga OBSH-ja. Paneli nuk mund t'i verifikojë pretendimet e ankuesve se trupat e KFOR-it francez që më parë qëndronin në Osterode ishin larguar nga aty për shkak të niveleve të larta të plumbit të gjetur në gjakun e tyre; megjithatë, Paneli mendon se të menduarit e arsyeshëm është dashur të sugjeronte se ky kamp ishte po ashtu i kontaminuar, duke pasur parasysh pozicionin e tij për vetëm pak metra larg Cesminluke dhe grumbujve toksikë me plumb. Paneli thekson se, në vend të kësaj, UNMIK-u inkurajoi PZHB-të të vendosen në atë kamp, i përkufizuar nga UNMIK-u si "më i sigurt". Paneli po ashtu thekson, siç do ta sqarojë më poshtë në më shumë detaje, se gjendja në Osterode, po ashtu, parandaloi qasjen e PZHB-ve në terapi përkatëse.

216. Paneli rikujton parashtresën e PSSP-së për çështjen e evakuimit të kampeve (shih § 161 më lart) që PZHB-të kundërshtuan çdo përpjekje për zhvendosje dhe se tensionet ndëretnike dhe situata politike në Mitrovicën veriore e bëri shumë sfiduese për UNMIK-un që të identifikojë një vend të përshtatshëm dhe "pa plumb" për t'i vendosur. Në lidhje me këtë, Paneli thekson që PSSP-ja nuk tregoi se çfarë opsionesh alternative, veç kampit Osterode të kontaminuar me plumb, u ishin ofruar PZHB-ve për vendosjen afatshkurtër të tyre, që ata e kundërshtuan. Paneli, po ashtu, thekson që

përveç zhvendosjes, UNMIK-u dështoi t'i implementojë masat preventive siç janë sqaruar në seksionet më poshtë.

217. Për sa i përket monitorimit të rekomanduar të NPGJ-së te PZHB-të me NPGJ më të ulët, Paneli thekson se një Program për mbikëqyrje të gjakut ishte nisur në bashkëpunim me OBSH-në në janarin e vitit 2005, për t'u ndërprerë më vonë në një datë të paspecifikuar pa sqarim, të ofruar nga PSSP-ja në lidhje me këtë. Paneli thekson që, meqë UNMIK-u nuk mori përgjegjësinë për këtë detyrë, testimi i gjakut ishte në dispozicion të PZHB-ve vetëm në një nivel të kufizuar, falë përpjekjeve vullnetare të institucioneve lokale shëndetësore dhe mjekëve.

218. Veç kësaj, Paneli e thekson me shqetësim të madh se UNMIK-u u ofroi përkujdesje mjekësore PZHB-ve të prekur që ishte larg nga të qenit adekuat, duke përfshirë ata që kishin nivele të ngritura të plumbit në gjak. Në veçanti, Paneli thekson që shërbimet elementare mjekësore, si dhe administrimi i terapisë përkatëse për ata PZHB që ishin prekur rëndë nga kontaminimi me plumb, kishte filluar vetëm në janar të vitit 2007 dhe ishte ndërprerë, pak muaj më vonë, në tetor të vitit 2007 pa ndonjë përkujdesje alternative të ofruar për PZHB-të. Paneli e konsideron si shqetësues sqarimin që UNMIK-u ia ofroi Komitetit të OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në vitin 2008, që terapia ishte ndërprerë sepse mendohej të mos jetë më e nevojshme nga OBSH-ja. Përkundrazi, Paneli thekson se një sqarim i ndryshëm është ofruar nga OBSH-ja në njoftimin e vet për shtyp të 9 shtatorit të vitit 2009. Në këtë komunikim, OBSH-ja publikisht sqaroi se ajo e kishte filluar terapinë përkatëse në Osterode pas premtimit të UNMIK-ut, se të gjithë PZHB-të do të zhvendosen në hapësirë kohore prej gjashtë muajsh, e cila, megjithatë, nuk ndodhi. Pasi dhënia e terapisë përkatëse në zona të kontaminuara është provuar të jetë jashtëzakonisht e rrezikshme për ata që janë të prekur, sepse i mundëson trupit të njeriut të absorbojë sasi shumë më të mëdha të materialeve toksike, OBSH-ja kishte refuzuar të vazhdojë me trajtimin (shih § 60 më lart). Prandaj, Paneli konsideron se UNMIK-u jo vetëm që nuk mori masa proaktive për të siguruar ofrimin e ndihmës mjekësore për ankuesit por gjithashtu, përmes dështimit të vet për t'i zhvendosur ankuesit nga kampet e kontaminuara, *de facto* parandaloi qasjen e tyre në terapinë përkatëse të ofruar nga OBSH-ja.

219. Paneli, po ashtu, rikujton që Gjykata Evropiane ka vendosur që obligimet sipas nenit 2 në kontekst të aktiviteteve të rrezikshme dhe çështjeve ambientale, përfshijnë obligimin e autoriteteve kompetente që të sigurojnë qasje në informata esenciale, që u mundësojnë individëve të vlerësojnë rrezikun për shëndetin dhe jetët e tyre (GJEDNJ [DHL], *Öneryıldız kundër Turqisë*, përmendur në § 194 më lart, në § 90, dhe GJEDNJ, *Brincat dhe të tjerët kundër Maltës*, përmendur në § 194 më lart, në § 102). Paneli thekson që UNMIK-ut nuk ofroi ndonjë dokumentacion për të provuar llojin, shtrirjen dhe qëllimin e edukimit apo aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes që thuhej se ishin ofruar nga UNMIK-u për t'i informuar PZHB-të romë, duke përfshirë ankuesit, rreth rreziqeve për shëndetin dhe jetët e tyre që rrjedhin nga të ekspozuarit e madh të tyre në plumb. Në anën tjetër, nga dokumentacioni në posedim të tij, Paneli i gjen si të bazuara pohimet e ankuesve se UNMIK-u nuk i zbuloi apo komunikoi PZHB-ve të prekur apo anëtarëve të familjeve të tyre, rezultatet e testeve të gjakut të kryera nga OBSH-ja në vitin 2004 dhe 2005. Veç kësaj, Paneli tashmë ka theksuar se UNMIK-u dështoi të ofrojë monitorim në vazhdim për nivelin e absorbimit të plumbit nga ankuesit, që do t'u mundësonte atyre t'i kuptojnë më mirë rreziqet e shkaktuara. Në

fund, Paneli po ashtu thekson që UNMIK-u u ofroi informata mashtruese ankuesve për sa i përket vendosjes së tyre në kampin Osterode, duke e përshkruar atë si "më të sigurt" krahasuar me kampet e tjera. Duke nxjerrë konkluzione nga këto elemente, Paneli pajtohet me ankuesit që UNMIK-u nuk u ofroi informata adekuate ankuesve në lidhje me rreziqet për shëndetin dhe jetët e tyre që buronin nga prania e tyre e përhershme në kampe.

220. Në fund, Paneli e konsideron të parëndësishme nëse veprimet dhe lëshimet e UNMIK-ut për rreziqet me të cilat përballeshin ankuesit duhet t'i atribuohen UNMIK-ut si një "Mision paqeruajtës i OKB-së" apo si "një administratë e përkohshme". Paneli thekson se, në secilin rast, UNMIK-u e kishte autoritetin e plotë legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë në pajtim me Rezolutën e KS të OKB-së nr. 1244 (1999), e cila e vendosi si pjesë qendrore mandatin e UNMIK-ut në Kosovë, që në mes tjerash "Të sigurojë rendin dhe qetësinë publike […]" (neni 9, d); "T'i mbrojë dhe promovojë të drejtat e njeriut […]" (neni 11, j) dhe "Të sigurojë kthim të sigurt dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur" (neni 11, k). Sipas rregulloreve pasuese, UNMIK-u u zotua t'i ushtrojë kompetencat e veta në Kosovë në pajtim me "standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut" dhe parimin e mosdiskriminimit (shih Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/1 *Mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë*, në nenin 2), dhe në veçanti respektimin e instrumenteve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 *Mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë*), e cila mbron të drejtën në jetë. Përveç kësaj, në Parimet Udhëheqëse për Zhvendosjen e Brendshme thuhet qartas se autoritetet nacionale *de facto* apo *de jure* kanë përgjegjësinë primare për mbrojtjen e PZHB-ve në kuadër të juridiksionit të tyre. Në lidhje me këtë, në Parimin nr. 2 thuhet që të drejtat e PZHB-ve do të respektohen nga "të gjitha autoritetet, grupet dhe personat, pavarësisht statusit të tyre ligjor".

221. Paneli tashmë ka gjetur se është e vërtetë që karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e ngjashme duhet marrë parasysh në lidhje me një numër situatash, por në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si arsyetim për uljen e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat u inkorporuan sipas rregullit në mandatin e UNMIK-ut (për sa i përket të drejtës në jetë, shih PKDNJ, *S.C. kundër UNMIK-ut*, nr. 02/09, mendimi i 6 dhjetorit të vitit 2012, në § 88, dhe mendimet pasuese mbi dështimin e UNMIK-ut për të kryer hetime efektive sipas nenit 2 të KEDNJ-së; për shkelje të të drejtave në pronë, shih PKDNJ, *Millogoriq dhe të tjerët kundër UNMIK-ut*, nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08, 69/08, mendimi i 24 marsit të vitit 2011, § 44; *Berisha dhe të tjerët kundër UNMIK-ut*, nr. 27/08 dhe të tjerët, mendimi i 23 shkurtit të vitit 2011, § 25; *Laliq dhe të tjerët kundër UNMIK-ut*, nr. 09/08 dhe të tjerët, mendimi i 9 qershorit të vitit 2012, në § 22). Paneli konsideron se standardet e njëjta duhet të vlejnë për obligimin esencial për të mbrojtur të drejtën në jetë. Veç kësaj, dhe duke pasur parasysh se PSSP-ja ankohet se "burimet financiare të UNMIK-ut ishin të kufizuara me ato të buxhetit dhe burimeve njerëzore të Kosovës, në të gjitha fushat, duke përfshirë shërbimet sociale dhe mjekësore", Paneli thekson që PSSP-ja nuk i ka ofruar Panelit ndonjë argumentim apo dëshmi të detajuar për të provuar se zhvendosja e ankuesve dhe ofrimi i përkujdesjes adekuate shëndetësore do të ishin një "një peshë joproporcionale", të cilën UNMIK-u nuk mund ta përballonte vetëm apo në bashkëpunim me agjencitë e tjera të OKB-së dhe organet e tjera që operonin në Kosovë. Paneli e thekson natyrën absolute të nenit 2 të KEDNJ-së.

222. Paneli thekson më tutje që, gjatë përmbushjes së mandatit të vet, UNMIK-u është dashur t'u ofrojë mbrojtje të veçantë për të drejtën në jetë dhe integritet fizik ankuesve si persona të cenueshëm, si rezultat i të qenit të zhvendosur pas konfliktit në Kosovë dhe shkatërrimit të shtëpive të tyre dhe si pjesëtarë të një minoriteti të pafavorizuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ [DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, nr. 30696/09, vendimi i 21 janarit të vitit 2011, në § 251).

223. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Paneli konsideron se UNMIK-u nuk përmbushi obligimet e veta sipas nenit 2 të KEDNJ-së, pasi ai nuk i mori të gjitha masat që njeriu arsyeshëm mund t'i priste nga ai për t'i mbrojtur jetët e ankuesve.

224. Prandaj, Paneli gjen se kishte një shkelje të pjesës substanciale të nenit 2 të KEDNJ-së.

b) Obligimi procedural

225. Ankuesit N.M. (nr. 1) dhe S.M. (nr. 2), prindërit e D.M., S.M. (nr. 8), burri i R.M., dhe I.I. (nr. 20), gruaja e V.S. ankohen, duke pasur parasysh se ankesat e tyre janë shpallur të pranueshme, se nuk kishte nisur asnjë hetim lidhur me vdekjet në kamp të anëtarëve të tyre të familjes, në shkelje të obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së.

226. Sa i përket kësaj pike, PSSP-ja argumenton që "nuk ka asnjë dëshmi se këto raste ishin sjellë në mënyrë specifike në vëmendje të UNMIK-ut, si vdekje të shkaktuara nga ekspozimi në plumb dhe kështu nuk ka baza për të sugjeruar që është dashur të nisin hetime specifike".

227. Në lidhje me këtë, Paneli thekson që, më 2 shtator 2005, një kallëzim penal ishte paraqitur në Zyrën e Prokurorit Publik në Prishtinë, duke i kërkuar të fillojë një hetim për këtë kundër atyre që janë përgjegjës për rrezikimin e shëndetit të PZHB-ve RAE (shih § 90 më lart). Paneli, po ashtu, thekson se, që nga vendosja e tij në vitin 1999, UNMIK-u e kishte përgjegjësinë mbi administrimin e drejtësisë në Kosovë, që iu dorëzua EULEX-it më 9 dhjetor të vitit 2008 (shih PKDNJ, *S.C. kundër UNMIK-ut*, nr. 02/09, mendimi i 6 dhjetorit të vitit 2012, në § 20). Në dritë të këtyre fakteve, Paneli nuk mund ta pranojë argumentimin e PSSP-së se kallëzimi penal nuk ishte sjellë në vëmendje të autoriteteve të UNMIK-ut.

228. Paneli, po ashtu, u referohet parimeve të përgjithshme të paraqitura në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për nenin 2 që, "ku jetët janë humbur në rrethana që potencialisht përfshijnë përgjegjësinë e shtetit, ajo dispozitë përfshin një detyrë që shteti të sigurojë, me të gjitha mjetet në dispozicion të vet, një përgjigje adekuate-gjyqësore apo ndryshe-ashtu që korniza legjislative dhe administrative e krijuar për të mbrojtur të drejtën në jetë të implementohet si duhet dhe çdo shkelje e asaj të drejte të ndalet dhe dënohet" (shih, GJEDNJ, *Budayeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, përmendur në 194 më lart, në § 140; GJEDNJ [DHL], *Öneryıldız kundër Turqisë*, përmendur në 194 më lart, në §§ 91-94; GJEDNJ, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në § 197 më lart, në § 115; dhe GJEDNJ, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në § 194 më lart, në § 54).

229. Gjykata ka vendosur që, ku "jetët humben si rezultat i ngjarjeve që përfshijnë përgjegjësinë e shtetit për veprim parandalues pozitiv, sistemi gjyqësor sipas nenit 2 duhet të mundësojë një procedurë hetimi të pavarur, të paanshëm dhe zyrtar që plotëson standardet e caktuara minimale sa i përket efektivitetit dhe që është në gjendje të sigurojë që dënimet penale zbatohen në shkallën që kjo arsyetohet me të gjeturat e hetimit" (shih GJEDNJ, *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 24746/94, vendimi i 4 majit të vitit 2001, në §§ 105-09, dhe GJEDNJ, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në § 194 më lart, në §§ 69-73). Në rastet e tilla, autoritetet kompetente duhet të veprojnë me kujdes shembullor dhe shpejtësi dhe duhet që me lëvizjen e tyre të iniciojnë hetime që janë në gjendje, së pari, t'i konstatojnë rrethanat në të cilat ka ndodhur incidenti dhe ndonjë mangësi në funksionimin e sistemit rregullues dhe, së dyti, t'i identifikojnë zyrtarët apo autoritetet e shtetit të përfshirë në çfarëdo kapaciteti në vargun e ngjarjeve në fjalë (GJEDNJ, *Brincat dhe të tjerët kundër Maltës*, përmendur në § 194 më lart, në § 121, dhe GJEDNJ [DHL], *Öneryıldız kundër Turqisë*, përmendur në § 194 më lart, në § 94).

230. Paneli po ashtu thekson që, duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, nuk ka asnjë indikacion që hetimi ishte kryer apo madje menduar, pavarësisht faktit që dëshmia *prima facie* ishte paraqitur, që vdekjet me sa duket të shkaktuara nga helmimi me plumb kishin ndodhur në kampe dhe pavarësisht nga vëmendja publike. Në të vërtetë, PSSP-ja thekson që ai nuk dinte asgjë rreth kësaj.

231. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Paneli konsideron se neni 2 i KEDNJ-së, obligimi procedural, po ashtu, është shkelur në lidhje me ankuesit e përmendur në § 225 më lart.

2. Shkelja e pretenduar e të drejtës për të qenë i lirë nga trajtimi johuman dhe degradues

a) Parimet e përgjithshme

232. Sipas nenit 3 të KEDNJ-së, ankuesit ankohen se kushtet e jetës në kampet e PZHB-ve në Mitrovicën veriore paraqisnin trajtim johuman dhe degradues në shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së.

233. PSSP-ja argumenton që nuk kishte shkelje të nenit 3 për arsyet vijuese: ankuesit dështuan ta dëshmojnë "vuajtjen" e tyre përtej dyshimit të arsyeshëm dhe, në çdo rast, UNMIK nuk shkaktoi "qëllimisht" vuajtjen e tillë; kushtet në kampe ishin "të rënda" për shkak të situatës së pas konfliktit në Kosovë; veç kësaj ankuesit, si pjesëtarë të komunitetit rom, jetuan në një vend të kontaminuar me plumb dhe vuajtën "disavantazhet që ekzistonin më parë sa i përket shëndetit, edukimit, pjesëmarrjes ekonomike, kushteve të banimit dhe atyre sociale" madje edhe para konfliktit; UNMIK-u bëri krejt çka mundi që t'i lehtësojë kushtet e rënda të jetesës së ankuesve ndërsa rindërtimi i Lagjes së Romëve ishte duke vazhduar.

234. Paneli i referohet praktikës së mirë gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut se neni 3, së bashku me nenin 2, ruan një nga vlerat më fundamentale në shoqëritë demokratike. Ai me terma absolut ndalon torturën apo trajtimin apo dënimin johuman apo degradues pavarësisht rrethanave dhe sjelljes së viktimës (shih,

për shembull, GJEDNJ [DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur në§ 222 më lart, nët § 218; GJEDNJ [DHL], *Labita kundër Italisë*, nr. 26772/95, vendimi i 6 prillit të vitit 2000, në § 119).

235. Gjykata e konsideron trajtimin të jetë "johuman" kur ai është "paramenduar, kryer për orë të tëra në një periudhë dhe ka shkaktuar lëndime aktuale trupore apo vuajtje të madhe fizike apo mentale". Trajtimi konsiderohet të jetë "degradues" kur ai poshtëron apo përul një person, duke treguar mungesë respekti për të, apo përul dinjitetin e tij apo saj njerëzor, apo shkakton ndjenja të frikës, ankthit apo inferioritetit që lejojnë shkelje të moralit të personit dhe rezistencës fizike (shih GJEDNJ [DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur në § 222 më lart, në § 220; dhe GJEDNJ, *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 2346/02, vendimi i 29 prillit të vitit 2002, në § 52). Gjykata thekson që "gjatë shqyrtimit nëse një formë e caktuar e trajtimit është "degraduese" në kuadër të kuptimit të nenit 3, Gjykata do ta vlerësojë nëse qëllimi i saj është të poshtërojë dhe përul personin në fjalë dhe nëse, sa u përket pasojave, ajo ka ndikuar negativisht në personalitetin e tij/saj në një mënyrë që është e papajtueshme me nenin 3" (GJEDNJ, *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë (nr. 2)*, nr. 41138/98 dhe 64320/01, vendimi i 12 korrikut të vitit 2005, në § 101; GJEDNJ, *Raninen kundër Finlandës*, nr. 20972/92, vendimi i 16 dhjetorit të vitit 1997, në § 55). Megjithatë, mungesa e ndonjë qëllimi të tillë nuk e përjashton përfundimisht një gjetje të shkeljes së nenit 3 (GJEDNJ [DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur në § 222 më lart, në § 219; GJEDNJ, *Peers kundër Greqisë*, nr. 28524/95, vendimi i 19 prillit të vitit 2001, në § 74).

236. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, keqtrajtimi duhet të ketë një nivel minimal të ashpërsisë për të qenë në kuadër të fushëveprimit të nenit 3 (shih, në mes autoriteteve tjera, GJEDNJ, *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 5310/71, vendimi i 18 janarit të vitit 1978, në § 162). Megjithatë, Gjykata ka theksuar që vlerësimi i këtij minimumi është relativ dhe varet "nga të gjitha rrethanat e rastit, siç janë kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe mentale dhe, në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja e shëndetit të viktimës" (shih, në mes autoriteteve tjera, GJEDNJ [DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur në § 222 më lart, në § 219; shih gjithashtu GJEDNJ [DHL], *Kudła kundër Polonisë*, nr. 30210/96, vendimi i 26 tetorit të vitit 2000, në § 91). Gjykata ka konsideruar që, madje edhe në mungesë të dëmtimit aktual trupor apo vuajtjes së madhe fizike dhe mentale, "ku trajtimi poshtëron apo përul një person, duke treguar mungesë respekti apo përulur dinjitetin e tij/saj njerëzor, apo shkaktuar ndjenja të frikës, ankthit apo inferioritetit që lejojnë shkelje të moralit të personit dhe rezistencës fizike, kjo mund të karakterizohet si degraduese dhe, po ashtu, është në kuadër të ndalimit të përcaktuar me nenin 3" (shih GJEDNJ [DHL], *Bouyid kundër Belgjikës*, nr. 23380/09, vendimi i 28 shtatorit të vitit 2015, në § 87).

237. Gjykata ka konsideruar që mbrojtja e veçantë nga tortura, trajtimi johuman dhe degradues duhet ofruar kategorive të personave siç janë fëmijët dhe "personat e tjerë të cenueshëm" (shih GJEDNJ [DHL], *Z. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, lënda nr. 29392/95, vendimi i 10 majit të vitit 2001, në § 73; dhe, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në § 197 më lart, në § 116).

238. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar që romët janë "bërë një lloj specifik i minoritetit të pafavorizuar dhe të cenueshëm", që kërkon "mbrojtje të veçantë" nga keqtrajtimi (shih GJEDNJ [DHL], *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 57325/00, vendimi i 13 nëntorit të vitit 2007, në § 181) dhe ka gjetur që, për shembull, shkatërrimi i shtëpive të romëve në Turqi dhe Jugosllavi, përbënte keqtrajtim në shkelje të Konventës Evropiane dhe Konventës CAT (KKT) (shih GJEDNJ, *Selçuk dhe Asker kundër Turqisë*, nr. 12/1997/796/998-999, vendimi i 24 prillit të vitit 1998, në §§ 78-80; në kuptimin e njëjtë, shih Komiteti i OKB-së për KKT, *Xhemail dhe të tjerët kundër Jugosllavisë*, CAT/C/29/D/161/2000).

239. Gjykata, po ashtu, ka theksuar se azilkërkuesit duhet konsideruar pjesëtarë të "një grupi të popullatës veçanërisht pa të drejta dhe të cenueshëm", dhe si i tillë "në nevojë për mbrojtje speciale" (GJEDNJ [DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur në § 222 më lart, në § 251; *V.M. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, nr. 60125/11, vendimi i 7 korrikut të vitit 2015[57], në § 153). Veç kësaj, Gjykata Evropiane ka vendosur që kushtet jetësore të kategorive të caktuara të personave që varen nga përkrahja prej shtetit (siç janë të burgosurit, azilkërkuesit, banorët e institucioneve psikiatrike), kur karakterizohen me mbushje të tepërt të numrit, hapësira joadekuate sanitare dhe shërbime të dobëta të përkujdesjes, përbënin trajtim mizor, johuman dhe degradues në shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së (shih, për azilkërkuesit, GJEDNJ [DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur më lart, në §§ 229-234; lidhur me kushtet në paraburgim dhe mungesën e trajtimit adekuat mjekësor, shih ndër të tjera, GJEDNJ, *Hummatov kundër Azerbajxhanit*, nr. 9852/03 dhe 13413/04, vendimi i 29 nëntorit 2007, në §§ 107-122; GJEDNJ, *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27229/95, vendimi i 3 prillit të vitit 2001, në §§ 109-116 mbi kushtet jetësore në institucionet psikiatrike; shih gjithashtu GJEDNJ, *Moldovianët dhe të tjerët kundër Rumanisë (nr. 2)*, përmendur në § 235 më lart, mbi shkatërrimin e shtëpive rome në Rumani, si dhe rrethanat degraduese në të cilat viktimat ishin të detyruar të jetonin më vonë).

b) Aplikueshmëria në rastin aktual

240. Paneli thekson se shkatërrimi i shtëpive të banimit të ankuesve, që ndodhi në qershor të vitit 1999, është jashtë juridiksionit të vet *ratione temporis*. Lidhur me parashtresat e ankuesve mbi kushtet jetësore në kampet për PZHB të ndërtuara nga UNMIK-u, Paneli gjen se ato janë përkrahur nga të gjeturat e organeve dhe organizatave gjatë gjithë periudhës nën juridiksionin e përkohshëm të Panelit (2005-2008) dhe më tej. Paneli e konsideron të dëshmuar se kushtet jetësore në kampe (me përjashtim të Osterodes) ishin "nën standarde", "veçanërisht shqetësuese", dhe "të tmerrshme" (shih §§ 82-89 më lart). Përveç kësaj, Paneli rikujton të gjeturat e veta se kampet ishin të kontaminuara rëndë me plumb për shkak të afërsisë së tyre me Kompleksin Trepça dhe grumbujt e tij me zgjyrë.

241. Paneli, po ashtu, i kushton rëndësi të madhe gjendjes së ankuesve dhe situatës së veçantë të cenueshmërisë në të cilën ata u gjendën si PZHB dhe si romë. Paneli thekson se ata kishin qenë të zhvendosur si pasojë e konfliktit dhe dhunës pa pasur, megjithatë, qasje në status refugjati dhe të drejtat që gëzohen me të[58]. Si pjesëtarë të

[57] Gjykim jo përfundimtar.
[58] Shih Institucioni i Ombudspersonit i Republikës së Kosovës, *Raporti i tetë Vjetor, 2007/2008*, 21 korrik 2008, në ff. 47-48.

një minoriteti historikisht të pafavorizuar, ata, së bashku me minoritetet e tjera joserbe, e gjetën veten pas konfliktit "të zënë ndërmjet dy komuniteteve kryesore etnike në Kosovë"[59]. Në kuadër të ankuesve, Paneli thekson cenueshmërinë e mëtejme dhe vështirësinë me të cilat u përballën fëmijët dhe gratë shtatzëna, më të dëmtuarit nga absorbimi i plumbit kur iu ekspozuan efekteve të tij të dëmshme.

242. Paneli rikujton se në rastin *V.M. dhe të tjerët kundër Belgjikës dhe Greqisë*, lidhur me një familje azilkërkuesish me fëmijë të vegjël, të cilët kishin mbetur për katër javë në kushte të varfërisë ekstreme, Gjykata Evropiane e ka gjetur Qeverinë belge përgjegjëse sipas nenit 3 për të ekspozuarit e aplikantëve në trajtim degradues (shih GJEDNJ, *V.M. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, përmendur në § 239 më lart, në § 162; shih gjithashtu GJEDNJ [DHL], *Tarakhel kundër Zvicrës*, nr. 29217/12, vendimi i 4 nëntorit të vitit 2014, në §§ 119-122). Paneli thekson që, në rastin aktual, ankuesit duruan efektet kumulative të helmimit nga plumbi dhe kushtet e tilla të rënda jetësore për më shumë se dhjetë vjet, tri nga të cilat bien në kuadër të juridiksionit të përkohshëm të Panelit (shih GJEDNJ, *Dougoz kundër Greqisë*, nr. 40907/98, vendimi i 6 marsit të vitit 2001, në §§ 46-49; shih gjithashtu, *mutatis mutandis*, PKDNJ, *Krasniqi kundër UNMIK-ut*, nr. 85/10, mendimi i 13 nëntorit të vitit 2015, në § 52). Paneli thekson efektet e dëmshme që kjo gjendje i kishte për shëndetin dhe mirëqenien e tyre siç theksohet në të gjeturat e veta sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Paneli, po ashtu, thekson se kushtet e rënda dhe jo të shëndetshme jetësore në kampe ishin veçanërisht të dëmshme për fëmijët dhe gratë shtatzëna. Këta ankues kishin pasoja negative në zhvillimin dhe mirëqenien e tyre, të cilat janë të pakthyeshme. Paneli nuk ka dyshim se kushtet jo të dinjitetshme jetësore në kampe u shkaktuan atyre vuajtje të konsiderueshme dhe ndjenja të poshtërimit. Në lidhje me këtë, Paneli e konsideron të parëndësishme që UNMIK-u nuk e ka shkaktuar qëllimisht këtë nivel të vuajtjes.

243. Paneli nuk e nënvlerëson barrën që UNMIK-u duhej ta përballte menjëherë pas arritjes së tij në Kosovë pas konfliktit dhe vlerëson përpjekjet e tij për rindërtim. Megjithatë, Paneli nuk e përjashton përgjegjësinë e UNMIK-ut ndaj ankuesve, veçanërisht kur merret parasysh se situata për të cilën bëhet ankesë, zgjati për më shumë se dhjetë vjet, tri nga të cilat nën juridiksionin e përkohshëm të Panelit. Në fund, Paneli thekson karakterin absolut të nenit 3 të KEDNJ-së, i cili nuk liron autoritetet nga obligimet e tyre sipas kësaj dispozite. Siç është vlerësuar sa u përket obligimeve të UNMIK-ut sipas nenit 2 të KEDNJ-së, Paneli konsideron se UNMIK-ut nuk ndërmori hapat adekuatë që t'i largojë ankuesit nga një situatë ku ata përjetuan trajtim johuman dhe degradues gjatë përmbushjes së obligimeve të veta sipas nenit 3 të KEDNJ-së.

244. Paneli nuk mund ta pranojë as argumentimin e PSSP-së se romët historikisht jetuan në kushte jetese nën standarde, madje edhe para konfliktit (shih § 165 më lart). Paneli e konsideron këtë koment diskriminues dhe përulës, meqë ai sugjeron që margjinalizimi social dhe ekonomik i romëve bazohet në racë dhe në vetë veprimet e tyre, dhe si i tillë, mund të përjetësohet pa përgjegjësi. Përkundrazi, Paneli konsideron se margjinalizimi historik i romëve dhe përvojat traumatike të cilat i çuan ata te statusi i tyre si PZHB në Kosovë, i bënë ankuesit veçanërisht të cenueshëm ndaj

[59] Shih Raportin e Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi të Drejtat e Njeriut të Personave të Zhvendosur Brenda Vendit për vitin 2009, i përmendur në fusnotën 51 më lart, në § 42.

trajtimit degradues dhe UNMIK-un gjithashtu përgjegjës për mirëqenien e tyre. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se konsideratë e veçantë duhet pasur për situatën e ankuesve si PZHB, si pjesëtarë të një "grupi të popullatës pa të drejta dhe të cenueshëm në nevojë për mbrojtje të veçantë" (shih GJEDNJ [DHL], *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, përmendur në § 222 më lart, në § 251; GJEDNJ [DHL], *Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, nr. 15766/03, vendimi i 16 marsit të vitit 2010, në § 147).

245. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Paneli konsideron se kushtet e vështira të jetës në kampe (me përjashtim të Osterodes), të përcjella me ekspozimin në kontaminim nga plumbi dhe mungesa e përkujdesjes adekuate mjekësore për një periudhë të gjatë kohore, ka arritur nivelin e ashpërsisë që kërkohet sipas nenit 3. Si pasojë, Paneli konsideron se ankuesit iu nënshtruan trajtimit johuman dhe degradues.

246. Nga kjo rrjedh që, përmes dështimit të UNMIK-ut për të ndërmarrë veprime të duhura, ankuesit u vunë në situatë në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Prandaj, ka ndodhur një shkelje e asaj dispozite.

3. Shkelja e pretenduar e të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare

247. Përveç ankesës së tyre sipas nenit 2 dhe nenit 3 të KEDNJ-së, ankuesit theksojnë se rreziqet për shëndetin që burojnë nga kontaminimi me plumb, të përcjella nga kushtet e rënda të jetesës në kampe, dhe dështimin e UNMIK-ut të ndërmarrë veprim rregullues, po ashtu përbëjnë shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së, i cili e mbron të drejtën për respekt ndaj jetës private dhe familjare.

248. Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 8 të KEDNJ-së, PSSP-ja thekson që UNMIK-ut dhe partnerët e tij ndërmorën të gjithë hapat e arsyeshëm që t'i parandalojnë faktorët ambientalë që të interferojnë në të drejtën e ankuesve për jetë të tyre private dhe familjare dhe që "Romët mbaheshin në mënyrë të vazhdueshme të informuar nga UNMIK-u dhe partnerët e tij, duke përfshirë menaxherët e kampeve dhe profesionistët e pranishëm mjekësorë".

a) Parimet e përgjithshme

249. Paneli i referohet praktikës së mirë gjyqësore të Gjykatës Evropiane, e cila gjen se ndotja e rëndë e ambientit (si dhe zhurma, emetimet dhe erërat), pavarësisht nëse burojnë nga biznesi në pronësi publike apo private, mund t'i parandalojnë individët nga të gëzuarit e shtëpive të tyre, të menduara si vende ku jeta private dhe familjare zhvillohet, në një mënyrë të tillë që prek jetën e tyre private dhe familjare, në kundërshtim me nenin 8 të KEDNJ-së (shih, në mes autoriteteve tjera, GJEDNJ, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, përmendur në § 194 më lart, në § 60; GJEDNJ, *López Ostra kundër Spanjës*, nr. 16798/90, vendimi i 9 dhjetorit të vitit 1994, në § 51; GJEDNJ, *Powell dhe Rayner kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 9310/81, vendimi i 21 shkurtit të vitit 1990, § 41; dhe, në kohën më të fundit, GJEDNJ, *Di Sarno dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 30765/08, vendimi i 10 janarit të vitit 2012, në § 96, dhe GJEDNJ, *Brincat dhe të tjerët kundër Maltës*, përmendur në § 194 më lart, në § 102).

250. Gjykata ka konsideruar që neni 8 mund të vlejë në rastet ambientale, pavarësisht nëse ndotja është shkaktuar drejtpërdrejt nga shteti apo nëse përgjegjësia e shtetit del nga

dështimi për t'i rregulluar si duhet aktivitetet e sektorit privat. Në të dyja rastet – nëse rasti analizohet për sa i përket interferencës së një autoriteti publik apo shkeljes së obligimit pozitiv të shteteve për të marrë masa të duhura për të siguruar të drejtën në fjalë – parimet e aplikueshme janë në përgjithësi të ngjashme. Gjykata ka theksuar në lidhje me nenin 8 që "në të dy kontekstet duhet pasur kujdes për të pasur balancë të drejtë në mes interesave garuese të individit dhe të komunitetit si të tërë; dhe në të dy kontekstet shteti e ka një margjinë të caktuar të vlerësimit për t'i përcaktuar hapat që duhet ndërmarrë për të siguruar pajtueshmëri me Konventën" (shih GJEDNJ, *Giacomelli kundër Italisë*, nr. 59909/00, vendimi i 2 nëntorit të vitit 2006, në § 78).

251. Gjykata Evropiane, po ashtu, e ka pranuar se në kontekst të aktiviteteve të rrezikshme, fushëveprimi i obligimeve sipas neneve 2 dhe 8 të Konventës shumë përkon (shih GJEDNJ, *Brincat dhe të tjerët kundër Maltës*, përmendur në § 194 më lart, në § 102; GJEDNJ, *Budayeva dhe të tjerët*, përmendur në § 194 më lart, në § 133). Në të vërtetë, obligimet pozitive sipas nenit 8 kërkojnë që autoritetet nacionale t'i marrin masat e njëjta praktike si ato që priten prej tyre në kontekst të obligimit pozitiv sipas nenit 2 të Konventës (shih GJEDNJ *Brincat dhe të tjerët kundër Maltës*, përmendur më lart, në § 102; dhe GJEDNJ, *Kolyadenko dhe të tjerët* kundër Rusisë, nr. 17423/05, 20534/05, 20678/05, 23263/05, 24283/05 dhe 35673/05, vendimi i 28 shkurtit të vitit 2012, në § 216).

252. Këto obligime përfshijnë detyrën për t'i rregulluar me ligj aktivitetet e caktuara dhe për të miratuar masa tjera praktike, që arsyeshëm do të mund të priteshin për të garantuar të drejtën për jetë private dhe familjare. Në veçanti, Gjykata ka afirmuar një obligim pozitiv, në lidhje me nenin 8, për të ofruar qasje në informata esenciale që u mundësojnë personave që t'i vlerësojnë rreziqet për shëndetin dhe jetët e tyre (shih GJEDNJ, *Brincat dhe të tjerët kundër Maltës*, përmendur në 194 më lart, në § 102 dhe, sipas nënkuptimit, GJEDNJ, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, përmendur në § 194 më lart, në §§ 57-60; GJEDNJ, *López Ostra kundër Spanjës*, përmendur në § 249 më lart, në § 55; GJEDNJ, *McGinley dhe Egan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 10/1997/794/995-996, vendimi i 9 qershorit të vitit 1998, në §§ 98-104; dhe GJEDNJ [DHL] *Roche kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 32555/96, vendimi i 19 tetorit të vitit 2005, në §§ 157-69) dhe, në rrethana të caktuara, po ashtu detyra për të kryer "hetime dhe studime përkatëse ashtu që efektet e aktiviteteve që mund … t'i shkelin të drejtat e personave, të mund të parashihen dhe vlerësohen paraprakisht" (shih GJEDNJ, *Giacomelli kundër Italisë*, përmendur në § 250 më lart, në § 83; dhe GJEDNJ, *Vilnes dhe të tjerët kundër Norvegjisë*, përmendur në § 195 më lart, në § 235).

b) Aplikueshmëria në rastin aktual

253. Paneli, së pari thekson se neni 8 i KEDNJ-së vlen për situatat e ankuesve në kampe. Paneli e konsideron të dëshmuar, po ashtu, në dritë të gjetjeve të veta sipas neneve 2 dhe 3, se niveli i helmimit me plumb dhe rreziqet për shëndetin e PZHB-ve që banonin në kampe ishin të mjaftueshme të ndikojnë në gëzimin nga ana e ankuesve të jetës së tyre private dhe familjare. Në të vërtetë, Paneli thekson, duke u bazuar në dokumentacionin që i është paraqitur atij, se krejt familjet e ankuesve kanë duruar pasojat më serioze për shëndet nga të qëndruarit në kampe, një situatë që kuptueshëm rrezikoi, në shumë raste dhe në një mënyrë të pakthyeshme, jetën e tyre familjare.

254. Paneli e pranon, siç është theksuar nga PSSP-ja, se ndotja e shtrirë gjerësisht me plumb në Mitrovicën veriore erdhi nga operimi në Kompleksin e Minierës Trepça për shumë kohë para arritjes së UNMIK-ut. Paneli, po ashtu, thekson se menjëherë pas arritjes së tij, UNMIK-u mbylli shkritoren për arsye shëndetësore, një masë e cila ka të ngjarë se përmirësoi gjendjen e përgjithshme ambientale në atë vend.

255. Për sa i përket situatës së ankuesve, megjithatë, Paneli thekson se UNMIK-u ishte përgjegjës për vendosjen e tyre, që nga viti 1999, në kampet për PZHB të ndërtuara në vend me kontaminim të lartë, për shkak të afërsisë së tyre me mbeturinat toksike jo të trajtuara nga koha e Trepçës. Paneli, po ashtu, rikujton që është vërtetuar mirë se UNMIK-u ishte në dijeni për këtë situatë, si dhe për rreziqet kërcënuese për jetë që dalin nga ajo, më së voni në nëntor të vitit 2000. Prandaj nuk mund të vihet në dyshim se UNMIK-u kishte përgjegjësinë të miratojë masa që arsyeshëm mund të priten për të garantuar të drejtën e ankuesve për jetë private dhe familjare.

256. Paneli, duke rikujtuar se obligimet sipas nenit 2 dhe 8 të Konventës mund të përkojnë, u referohet të gjeturave të tij lidhur me ankesat sipas nenit 2 (shih §§ 212-223 më lart), që UNMIK-u nuk mori të gjitha masat që arsyeshëm mund të pritej prej tij-duke përfshirë zhvendosjen në një zonë të sigurt, aktivitete të duhura dhe të vazhdueshme rehabilituese, ofrimin e trajtimit mjekësor dhe ofrimin e informatave – për t'i mbrojtur ankuesit nga rreziku ambiental në kampe.

257. Sa i përket veçanërisht shkeljes nga UNMIK-u të detyrës së tij sipas nenit 8, për të ofruar qasje dhe informata relevante për rreziqet që dalin nga situata ambientale në kampe, Paneli e thekson me shqetësim se informatat kryesore të mbledhura nga UNMIK-u, pas nëntorit të vitit 2000 nuk ishin bërë kurrë publike apo komunikuar ankuesve. Ky material madje nuk i është paraqitur Panelit, pavarësisht kërkesave të tij të përsëritura. Paneli thekson se shumica e informatave (vlerësimi i rrezikut, testet e gjakut), që në parim iu vunë në dispozicion ankuesve nga viti 2005, ishin mbledhur dhe publikuar në mënyrë të pavarur nga UNMIK-u përmes entiteteve tjera, siç janë OBSH-ja dhe OJQ-të lokale dhe shtëpitë e shëndetit. Megjithatë, siç është theksuar tashmë, nuk ka asnjë indikacion që këto informata dhe të gjeturat u ishin shpërndarë më pas dhe komunikuar si duhet ankuesve.

258. Paneli, po ashtu, thekson që mungesa e qasjes në informata relevante ndikoi negativisht në të drejtat reprodukuese të grave në kampe, në veçanti grave shtatzëna siç janë ato të cilat thuhet se kishin vetë-abortim apo dështim si pasojë e helmimit me plumb. Paneli i referohet nenit 10 (h) të KEDKG, në të cilën thuhet se gratë gëzojnë të drejtën të kenë "qasje në informata specifike edukative për të ndihmuar që të garantohet shëndeti dhe mirëqenia e familjeve, duke përfshirë informata dhe këshilla mbi planifikimin familjar" (shih gjithashtu Komiteti i KEDKG-së, *A.S. kundër Hungarisë*, Komunikata nr. 4/2004, mendimet e 29 gushtit të vitit 2006, Dok. i OKB-së KEDKG/36/D/4/2004, në § 11.2).

259. Paneli thekson se ndikimet e tjera, siç janë çështjet politike dhe të sigurisë apo kufizimet ekonomike, janë paraqitur nga UNMIK-u për të justifikuar dështimin e vet që të ndërmarrë veprime të caktuara me qëllim të mbrojtjes së ankuesve nga rreziqet e ambientit, të cilave ata u ishin ekspozuar (shih § 162 më lart). Në lidhje me këtë, Paneli pranon përpjekjet e UNMIK-ut për t'i akomoduar ankuesit, por konsideron se nuk është paraqitur asnjë provë e mjaftueshme nga PSSP-ja për të dëshmuar se

vendosja e ankuesve në një zonë të sigurt ishte penguar nga vështirësitë e tjera emergjente që e bën zhvendosjen ngarkesë joproporcionale (shih § 221 më lart). Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, Paneli konsideron se UNMIK-u nuk arriti të krijojë një balancë të drejtë në mes interesave të komunitetit dhe gëzimit nga ana e ankuesve të të drejtave të tyre për t'iu respektuar jeta private dhe familjare.

260. Prandaj, Paneli konstaton se neni 8 i KEDNJ-së është shkelur.

4. Shkelja e pretenduar e të drejtës për shëndet dhe të drejtës për standard adekuat të jetesës

a) Parimet e përgjithshme

261. Ankuesit theksojnë se, përmes akteve dhe lëshimeve të UNMIK-ut janë shkelur, po ashtu, e drejta e tyre për shëndet dhe e drejta për standard adekuat të jetesës.

262. E drejta për standard adekuat të jetesës, duke përfshirë ushqim, veshje dhe banim adekuat, dhe e drejta për shëndet të dyja parashihen në DUDNJ, e cila në nenin 25.1, njeh të drejtën e secilit për:

> "një standard të jetesës që është adekuat për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen, banimin dhe përkujdesjen mjekësore dhe shërbimet e nevojshme sociale, dhe të drejtën e sigurimit në rast të punësimit, sëmundjes, paaftësisë, të qenit i vejë, në moshë të shtyrë apo mungesa e mjeteve të tjera për jetesë në rrethanat përtej kontrollit të tij"

263. Përkufizime gjithëpërfshirëse të të dyjave, të drejtës për shëndet dhe të drejtës për standard adekuat të jetesës gjenden në KNDESK, e cila po ashtu qartëson fushëveprimin e obligimit të shteteve për t'i respektuar, mbrojtur dhe përmbushur këto të drejta. Sa i përket të drejtës për standard adekuat të jetesës, neni 11.1 i KNDESK-së njeh

> "të drejtën e secilit për një standard adekuat të jetesës për veten dhe familjen e tij, duke përfshirë ushqimin adekuat, veshjen dhe banimin […]".

264. Komiteti i KNDESK-së i OKB-së ka qartësuar në veçanti se e drejta në banim, si një komponentë e të drejtës për një standard adekuat të jetesës, nuk duhet interpretuar në një kuptim të ngushtë apo të kufizuar; për shembull kjo e drejtë nuk përmbushet duke ofruar thjesht "një kulm mbi kokë". Më parë, ajo duhet të shihet si e drejtë "për të jetuar diku në siguri, paqe dhe me dinjitet" (shih Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 4 *mbi të drejtën për strehim adekuat*, 1991, në § 7). Strehimi është adekuat ku ai ofron "hapësirë adekuate" dhe mbron "nga të ftohtit, lagështia, të nxehtit, shiu, era apo kërcënimet e tjera për shëndetin, rreziqet strukturore dhe agjentët e sëmundjes". Nga kjo perspektivë, Komiteti ka theksuar që e drejta për strehim nuk mund të shihet e izoluar nga e drejta për shëndet, meqë, siç është theksuar po ashtu nga OBSH-ja, "strehimi dhe kushtet jetësore joadekuate dhe të mangëta janë në çdo rast të lidhura me vdekshmërinë më të lartë dhe shkallët e sëmundshmërisë" (*ibid.*, në § 8).

265. Për sa i përket të drejtës për shëndet, në nenin 12.1 të KNDESK-së thuhet se secili ka të drejtën për "standardet më të larta të arritshme të shëndetit fizik dhe mental"; Neni 12.2 parasheh obligimet për autoritetet në fjalë të ndërmarrin hapa për:

> "(a) Sigurimin e zvogëlimit të shkallës së lindjes së fëmijëve të vdekur dhe mortalitetit të fëmijëve dhe sigurimin e zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve;
> (b) Përmirësimin e të gjitha aspekteve të higjienës ambientale dhe industriale;
> (c) Parandalimin, trajtimin dhe kontrollin e sëmundjeve epidemike, endemike, profesionale dhe sëmundjeve të tjera;
> (d) Krijimin e kushteve, të cilat do të siguronin të gjitha shërbimet mjekësore dhe përkujdesjen shëndetësore në rast të sëmundjes".

266. E drejta në shëndet – e cila nuk barazohet me "të drejtën për të qenë *i shëndetshëm*" – duhet të interpretohet si një e drejtë ekskluzive që shtrihet "jo vetëm në përkujdesjen me kohë dhe të duhur shëndetësore", por gjithashtu në "përcaktuesit themelorë të shëndetit", siç janë ushqimi dhe të ushqyerit, strehimi, qasja në ujë të sigurt dhe të pijshëm dhe sanitari adekuate, kushte pune të sigurta dhe të shëndetshme, dhe një ambient i shëndetshëm, si dhe qasje në edukim dhe informim lidhur me shëndetin (Komiteti i KNDESK-së i OKB-së, Komenti i përgjithshëm nr. 14 *mbi të drejtën për standardet më të larta të arritshme të shëndetit*, 11 gusht 2000, Dok. i OKB-së E/C.12/2000/4, në § 8 dhe § 11). Për t'u përmbushur e drejta në shëndet, objektet shëndetësore, të mirat, shërbimet dhe programet duhet të jenë: a) në dispozicion; b) të qasshme dhe jo të shtrenjta, e cila po ashtu përfshin të drejtën për të kërkuar, pranuar dhe komunikuar informata lidhur me çështjet shëndetësore; c) të pranueshme dhe të duhura në aspektin kulturor; d) të cilësisë së mirë (*ibid.*, në § 12).

267. Pranohet se, në pajtim me nenin 2 të KNDESK-së, që ka të bëjë me fushëveprimin e obligimeve të shteteve, realizimi i plotë i këtyre të drejtave mund të arrihet vetëm "progresivisht", deri në maksimumin e burimeve në dispozicion të shteteve. Megjithatë, është e kuptueshme që këto dispozita të KNDESK-së, po ashtu, ngarkojnë obligime të cilat janë me efekt të drejtpërdrejtë. Këto përfshijnë: obligimin për të garantuar që ushtrimi i këtyre të drejtave do të jetë i lirë nga diskriminimi; dhe sigurimi i së paku gëzimit të "niveleve minimale esenciale" të secilës nga të drejtat në fjalë.

268. Sa i përket ndalimit të diskriminimit për gëzimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, Paneli rikujton që neni 5 i KNEDR-së ngarkon obligimin jo vetëm për të "ndaluar" diskriminimin por, po ashtu, për të "eliminuar" diskriminimin racor për gëzimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, në veçanti, të drejtës për strehim (neni 5 (iii)) dhe të drejtës për shëndet publik, përkujdesje mjekësore, siguri sociale dhe shërbime sociale (neni 5 (iv)).

269. Sa i përket obligimit bazë për të siguruar nivele minimale esenciale të të drejtave në fjalë, Komiteti ka theksuar që, për shembull, "një palë shtetërore te e cila ndonjë numër i rëndësishëm i personave privohet nga artikujt ushqimorë esencialë, përkujdesja esenciale primare shëndetësore, strehimi dhe banimi elementar […] është, *prima facie*, duke dështuar në kryerjen e obligimeve të veta sipas Konventës", veç nëse ajo mund të demonstrojë që "çdo përpjekje është bërë për t'i përdorur të gjitha burimet që janë në dispozicion të vet në një përpjekje për t'i përmbushur, si çështje prioriteti, ato obligime minimale" (Komiteti i KNDESK, Komenti i

përgjithshëm nr. 3 *mbi natyrën e obligimeve të palëve shtetërore*, 14 dhjetor 1990, Dok. i OKB-së. E/1991/23, at § 10). Në këtë kontekst, shprehja "të gjitha burimet në dispozicion" nënkupton referimin për "të dy burimet që ekzistojnë brenda një shteti dhe atyre në dispozicion nga komuniteti ndërkombëtar, përmes bashkëpunimit dhe asistencës ndërkombëtare (*ibid.*, në § 13).

270. Veç kësaj, Komiteti e ka nënvizuar se obligimet bazë minimale të përmendura më lart, vlejnë "po ashtu në kohë të kufizimeve të mëdha të burimeve", ku autoritetet kanë obligime për t'i mbrojtur "pjesëtarët e cenueshëm të shoqërisë" (Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 3 përmendur në § 269 më lart, në § 12). Në mënyrë specifike lidhur me të drejtën për strehim adekuat, Komiteti i KNDESK-së ka theksuar gjithashtu që, veçanërisht në kohë të krizës ekonomike apo situatave tjera me kufizime, "prioritet i duhur" dhe konsideratë duhet pasur për "ato grupe sociale që jetojnë në kushte të pafavorshme" (Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 4, përmendur në § 264 më lart, në § 11).

271. E drejta në shëndet dhe e drejta në standard adekuat të jetesës, siç parashihet në KNDESK, vlejnë për secilin, "duke përfshirë ata që nuk janë qytetarë të vendit, siç janë refugjatët, azilkërkuesit, personat pa shtet, punëtorët migrantë …, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor", si dhe "personat e shpërngulur brenda vendit" (Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 14, përmendur në § 266 më lart, në §§ 30 dhe 34). Veç kësaj, të drejtat dhe parimet e paraqitura në paragrafët më lart paraqiten në Parimet Udhëheqës të OKB-së për Zhvendosjen Brenda Vendit përmendur në § 184 më lart në të cilat, në nenin 18 dhe 19, në pjesët relevante thuhet:

> Parimi 18
> "1. Të gjithë personat e zhvendosur brenda vendit kanë të drejtë për standard adekuat të jetesës.
> 2. Në minimum, pavarësisht nga rrethanat, dhe pa diskriminim, autoritetet kompetente do t'u ofrojnë personave të zhvendosur brenda vendit dhe t'u sigurojnë qasje të sigurt në:
> a) ushqim esencial dhe ujë të pijshëm;
> b) strehim dhe banim elementar;
> c) veshje të përshtatshme; dhe
> e) shërbime esenciale mjekësore dhe të sanitarisë […]"
>
> Parimi 19
> "Të gjithë personat e zhvendosur brenda vendit që janë të plagosur dhe të sëmurë, si dhe ata me paaftësi, do ta kenë nivelin më të plotë të realizueshëm, dhe me vonesën më të vogël të mundshme, të përkujdesjes mjekësore dhe përkujdesjen që e kërkojnë, pa dallim të ndonjë lloji, veç atij për çështje mjekësore […]".

b) Aplikueshmëria në rastin aktual

272. Në fillim, Paneli rikujton parimin që të gjitha të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme, të ndërvarura dhe të ndërlidhura pasi ato të gjitha burojnë nga "dinjiteti dhe vlejnë, pa dalim, për çdo person" (shih preambulën e Deklaratës së Vjenës dhe Programit të Veprimit, e miratuar nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut, 25 qershor 1993, Dok. i OKB-së A/CONF.157/23). Paneli thekson që, madje për më

tepër në rrethanat e rastit aktual, shkelja e pretenduar e të drejtës së ankuesve për një standard adekuat të jetesës, e cila përfshin elementet kryesore elementare të së drejtës në shëndet siç janë e drejta për ushqim, veshje dhe strehim adekuat, është në thelb e lidhur me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tyre në shëndet dhe rrjedhimisht ne do t'i marrim në konsideratë së bashku.

273. Megjithëse kjo pikë nuk është kontestuar nga PSSP-ja, Paneli thekson aplikueshmërinë e plotë të së drejtës në shëndet dhe të drejtës për standard adekuat të jetesës, si dhe të drejtave tjera ekonomike, sociale dhe kulturore, për të gjithë ankuesit, pavarësisht statusit të tyre si PZHB. Veç kësaj, Paneli thekson se ankuesit është dashur të vlerësohen si pjesëtarë veçanërisht të cenueshëm të shoqërisë, për shkak të zhvendosjes së tyre pas dhunës dhe për shkak të margjinalizimit të tyre, dhe si të tillë meritonin mbrojtje dhe vëmendje të veçantë. Në këtë kuptim, është vërtetuar se në gjithë Evropën, mesatarja e jetëgjatësisë së romëve dhe endacakëve është shumë më e shkurtër sesa ajo e joromëve dhe joendacakëve[60].

274. Paneli thekson që, duke u bazuar në dokumentacionin dorëzuar atij dhe që është në dispozicion në fushën publike, i cili përfshin të gjeturat e disa organeve, për shembull OSBE-së, HRW, raportuesve specialë të OKB-së, Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, KiE (shih §§ 82-89 më lart), një konsideratë e tillë nuk u është kushtuar ankuesve dhe pjesës tjetër të PZHB-ve në kampe.

275. Paneli thekson që, në procesin e trajtimit të krizës së PZHB-ve romë në Mitrovicën veriore në vitin 1999, UNMIK-u akomodoi ankuesit në një vend të pasigurt, tepër toksik (duke përfshirë kohën pasi ishin vendosur në Osterode), për më shumë se dhjetë vjet, tri nga të cilat në kuadër të juridiksionit të Panelit, të cilat vetëm do të ngritin pyetjen e shkeljes së të drejtës së tyre në shëndet dhe standard adekuat të jetesës. Paneli thekson që, përveç asaj, ankuesit ishin vendosur në strehimore të improvizuara në të cilat nuk kishte qasje adekuate në ujë (ujë që rrjedh dhe ujë të pijshëm), kanalizim (tualet adekuat dhe sistem të kanalizimit), rrymë apo ngrohje. Paneli, po ashtu, u referohet të gjeturave që ky strehim, higjiena dhe situata e të ushqyerit në kampe krijoi një gjendje në të cilën ankuesit iu ekspozuan dhe ishin të cenueshëm nga helmimi me plumb, dhe si pasojë shumë sëmundje tjera ishte rritur në mënyrë dramatike.

276. Paneli e merr parasysh më tutje faktin që, në fillim të juridiksionit të përkohshëm të Panelit në prill të vitit 2005, kriza shëndetësore në kampe që buronte nga helmimi me plumb u bë më se evidente, veçanërisht në mesin e fëmijëve, me autoritetet e UNMIK-ut që ishin plotësisht të informuara për të. Megjithatë, raporte të ndryshme tregojnë se duke përfshirë këtë periudhë dhe vitet në vijim, shërbimet shumë të nevojshme shëndetësore nuk ishin në dispozicion apo të qasshme fizikisht (p.sh. referimi i shërbimeve në Serbi; mosdisponueshmëria e terapisë përkatëse në ambient të kontaminuar, siç thuhet në §§ 60 dhe 218 më lart) apo ekonomikisht (p.sh. shpenzimet për medikamente kurrë nuk u janë ofruar falas) ankuesve[61]. Një shqetësim i ngjashëm është shprehur nga Raportuesi Special i OKB-së për të Drejtat e PZHB-ve në fund të fund të vizitës së tij në qershor të vitit 2005[62].

---

[60] Shih, Komisari i KiE-së për të Drejtat e Njeriut, *Të Drejtat e Njeriut të Romëve dhe Endacakëve në Evropë*, Strasburg, shkurt 2012, në f. 167.
[61] Shih Raporti i HRW-së, përmendur në fusnotën 4 më lart, në ff. 40-44.
[62] Shih Dok. i OKB-së E/CN.4/2006/71/Add.5, në § 46.

277. Ndërsa vlerësonte ankesën sipas nenit 2 dhe nenit 3 të KEDNJ-së, Paneli vendosi që kushtet e përgjithshme të jetesës të ankuesve në kampet e kontaminuara ishin kërcënuese për jetën dhe përbënin trajtim degradues, Nga perspektiva e nenit 11 dhe nenit 2 të KNDESK-së, Paneli po ashtu konsideron se ato nuk ishin në pajtueshmëri me kërkesat minimale për të drejtën për standard adekuat të jetesës dhe të drejtës për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit.

278. Paneli tashmë e ka pranuar se disa përpjekje relevante janë bërë nga UNMIK-u në këtë periudhë, kryesisht vendosja e ankuesve në kushte më të mira jetese, së pari në kampin Osterode, i cili ofronte kushte më të mira strehimi por në një ambient njëjtë të kontaminuar, e së dyti, në Lagjen Romëve të sapondërtuar, duke filluar nga pranvera e vitit 2007. Megjithatë, Paneli e thekson me shqetësim ritmin e ngadalshëm të procesit të përgjigjes së UNMIK-ut krahasuar me kërcënimet shumë serioze për shëndetin me të cilat përballeshin ankuesit, veçanërisht fëmijët[63], që kërkonte evakuimin e tyre të menjëhershëm nga kampet siç kërkohej nga shumë organizata, duke përfshirë OBSH-në.

279. Përveç kësaj, në dritë të obligimit sipas nenit 12.2 të KNDESK-së për të ndërmarrë hapa për zvogëlimin e mortalitetit të fëmijëve dhe lindjeve të frytit të vdekur, për t'i parandaluar, trajtuar dhe kontrolluar sëmundjet, Paneli rikujton të gjeturat e veta sipas nenit 2 të KEDNJ-së, që UNMIK-u dështoi të bëjë monitorim sistematik të kontaminimit nga plumbi në kampe, përmes testeve të rregullta të gjakut. Sa i përket terapisë përkatëse, që paraqet një trajtim për t'i luftuar efektet e helmimit nga plumbi, Paneli po ashtu ka theksuar që: ishte implementuar vetëm për pak muaj; që kurrfarë trajtimi nuk u ishte ofruar ankuesve, të cilët në ndërkohë ishin kthyer në Lagjen e Romëve; dhe që nga tetori i vitit 2007 PZHB-të ishin lënë pa trajtim mjekësor që lufton efektet e helmimit nga plumbi (shih § 59 më lart). Në dritë të kësaj që u tha më lart, në lidhje me këtë, Paneli konsideron se UNMIK-u nuk ndërmori të gjithë hapat e duhur drejt realizimit progresiv të të drejtës së ankuesve në shëndet në periudhën në kuadër të juridiksionit të vet.

280. Siç është theksuar nga HRW[64], Paneli po ashtu konsideron se asnjë politikë gjithëpërfshirëse e shëndetit publik nuk mund të krijohej për shkak të mungesës së monitorimit sistematik dhe mbledhjes së të dhënave në kampe. Në këtë kontekst, Paneli e merr parasysh komentin e PSSP-së se kjo ishte e shumta që UNMIK-u mund të bënte për të përmirësuar shëndetin e ankuesve, duke pasur në konsideratë "stilet e tyre jo të shëndetshme dhe të rrezikshme të jetës" dhe përfshirjen në "aktivitete joformale të shkrirjes". PSSP-ja konsideron se këto aktivitete ishin burimi kryesor i helmimit nga plumbi në kamp por nuk ofron asnjë dëshmi përkatëse. Paneli është i shqetësuar që përgjigja joadekuate e UNMIK-ut ndaj krizës mund të jetë nxitur nga stereotipat diskriminues më parë sesa nga dëshmia shkencore, pasi kjo e fundit ka treguar që afërsia me Shkritoren e Trepçës dhe digat me mbetje paraqiste burimin kryesor të kontaminimit me plumb (shih §§ 74-75, 78 më lart).

281. Paneli nuk është i bindur nga argumenti tjetër i PSSP-së, se UNMIK-u i shfrytëzoi të gjitha burimet në dispozicion, që përfshinte bashkëpunimin ndërkombëtar dhe

---

[63] Shih Institucioni i Ombudspersionit i Republikës së Kosovës *Raporti i pestë Vjetor*, përmendur në fusnotën 60 më lart, në f. 41.
[64] Shih Raporti i HRW-së, përmendur në fusnotën 4 më lart, në f. 54.

asistencën nëse kishte nevojë, me qëllim të realizimit të të drejtave të ankuesve. E para, Paneli e konsideron këtë argument tepër të përgjithshëm apo abstrakt, duke mos qenë i mbështetur nga ndonjë dokumentacion për të treguar, për shembull që UNMIK-u apeloi te donatorët që të ofrojnë monitorim adekuat dhe trajtim për ankuesit, siç e bëri për rindërtimin e Lagjes së Romëve. E dyta, Paneli thekson se UNMIK-u nuk i krijoi kushtet për të pranuar asistencë të plotë nga entitetet e tjera të OKB-së, sikur OBSH-ja, e cila refuzoi të vazhdojë me përdorimin e terapisë përkatëse në një vend me toksicitet të lartë (shih § 60 më lart). Në fund, Paneli thekson se kanali kryesor përmes të cilit UNMIK-u apelonte për bashkëpunim me shtetet anëtare të OKB-së, ishte raportimi i tij i rregullt në Këshillin e Sigurimit të OKB-së nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm. Megjithatë, Paneli nuk vërejti ndonjë përmendje të krizës shëndetësore që buronte nga helmimi me plumb në kampe në raportet tremujore të Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurimit mbi aktivitetet e UNMIK-ut gjatë periudhës relevante.

282. Duke marrë parasysh të gjeturat, ndër të tjera, të Komisarit të KiE për të Drejtat e Njeriut, në të cilat thuhet se gjendja kërcënuese për jetën e përafërsisht 600 romëve, për një dekadë në kampe të kontaminuara me plumb në Mitrovicën veriore, ka qenë "ndoshta rasti më ekstrem në Evropë për të mbrojtur të drejtën e romëve në shëndet"[65], Paneli e konsideron të turpshme që një e dhënë e tillë i atribuohet veprimit dhe/apo mosveprimit të një entiteti të Organizatës së Kombeve të Bashkuara – UNMIK-ut – në thelb të mandatit të të cilit ishte mbrojtja e personave të shpërngulur nga konflikti.

283. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Paneli konsideron se UNMIK-u, po ashtu, shkeli të drejtën e ankuesve në jetë (neni 12, KNDESK) dhe një standard adekuat të jetesës (neni 11, KNDESK).

5. Shkelja e pretenduar për ndalim të diskriminimit

a) Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike

284. Ankuesit ankohen se, si pjesëtarë të komunitetit rom në Kosovë, ata i janë nënshtruar diskriminimit të përgjithshëm, të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë. Ata pohojnë që vendimi i UNMIK-ut për t'i vendosur PZHB-të romë në kampet e kontaminuara dhe dështimi i tij për t'i zhvendosur ata në një ambient më të sigurt, ishte manifestim i mëtejmë i diskriminimit kundër tyre, duke u bazuar në etninë e tyre rome. Në përkrahje të këtij pohimi, ankuesit argumentojnë se vetëm PZHB-të romë, krahasuar me PZHB-të e Kosovës me origjinë tjetër etnike, janë vendosur në një vend të njohur të jetë i kontaminuar dhe që autoritetet kanë vepruar në një mënyrë më të shpejtë për t'i "kthyer, për rindërtim dhe kompensim" të banorëve joromë të Kosovës, të cilëve iu kishte humbur apo shkatërruar prona gjatë konfliktit.

285. Paneli mendon se kjo pjesë e ankesës duhet shqyrtuar sipas shkeljes së pretenduar të nenit 14 të KEDNJ-së, shpallur në lidhje me nenin 2 (obligimi esencial), 3 dhe 8 i KEDNJ-së, si dhe sipas dispozitave për mosdiskriminim të KNDCP, KNDESK dhe KNEDR-së.

---

[65] Shih, Komisari i KiE-së për të Drejtat e Njeriut, *Të Drejtat e Njeriut të Romëve dhe Endacakëve në Evropë*, përmendur në fusnotën 62 më lart, në f. 168.

i) Parimet e përgjithshme

286. Paneli thekson se ndalimi i diskriminimit është një shtyllë fundamentale e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në kuadër të sistemit evropian përgjithësisht, neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin për të gëzuar të drejtat e garantuara me Konventë, në çfarëdo baze sikur gjini, racë, ngjyrë, religjion, mendim politik apo tjetër, origjinë nacionale dhe sociale, bashkim me një minoritet nacional, pronë, lindje apo status tjetër. Ndalimin e diskriminimit, po ashtu, e përmban KNDCP (nenet 2 dhe 26), KNDESK (neni 2) dhe KNEDR (nenet 2 dhe 5).

287. Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane si dhe jurisprudencës së traktateve-organeve që diskriminimi nënkupton të trajtuarit ndryshe, pa një objektiv dhe justifikim të arsyeshëm, i personave në situata për nga rëndësia të ngjashme (shih GJEDNJ, *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36042/97, vendimi i 11 qershorit të vitit 2002, në § 48, dhe GJEDNJ, *Okpisz kundër Gjermanisë*, nr. 59140/00, vendimi i 25 tetorit të vitit 2005, në § 33; shih gjithashtu Komiteti i KNDESK, Komenti i përgjithshëm nr. 20 *mbi mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*, 2 korrik 2009, Dok. i OKB-së E/C.12/GC/20, në § 7). Megjithatë, Gjykata Evropiane po ashtu ka theksuar që neni 14 i KEDNJ-së nuk e ndalon një vend anëtar nga të trajtuarit ndryshe të grupeve me qëllim të korrigjimit të "pabarazive faktike" në mes tyre; në të vërtetë në rrethana të caktuara një dështim për të bërë përpjekje për ta korrigjuar pabarazinë përmes trajtimit ndryshe mundet vetvetiu të paraqesë shkelje të nenit (shih GJEDNJ [DHL], *Thlimmenos kundër Greqisë*, nr. 34369/97, vendimi i 6 prillit të vitit 2000, në § 44; mbi legjitimitetin e "masave pozitive" shih gjithashtu Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 20, i përmendur më lart, në § 9; dhe Komiteti i KDNJ-së, Komenti i përgjithshëm nr. 18 *mbi mosdiskriminimin*, 11 tetor 1989, në § 10).

288. Është e vërtetuar mirë se ndalimi i diskriminimit përfshin ndalimin e diskriminimit indirekt apo *de facto*. Gjykata Evropiane thekson që "një politikë apo masë e përgjithshme që ka në mënyrë joproporcionale efekte paragjykuese për një grup të caktuar, mund të konsiderohet diskriminuese pavarësisht se nuk ka pasur si qëllim specifik atë grup dhe që "diskriminimi potencialisht kundër Konventës mund të rezultojë nga një situatë *de facto* " (shih, GJEDNJ [DHL], *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, përmendur në § 238 më lart, në § 175 dhe rastet e përmendura aty).

289. Po ashtu, sipas Konventës KNEDR-së, përkufizimi i diskriminimit duhet kuptuar si shtrirje "përtej masave të cilat janë qartas diskriminuese, për t'i përfshirë masat që nuk janë diskriminuese në kuptimin formal por janë diskriminuese në fakt dhe efekt" (shih Komiteti i KNEDR-së, *L.R. dhe të tjerët kundër Republikës së Sllovakisë*, vendimi i 7 marsit të vitit 2005, në § 10. 4). Gjatë vlerësimit të diskriminimit të tillë indirekt apo *de facto*, Komiteti i KEDR-së thekson se ai duhet të marrë parasysh plotësisht kontekstin e veçantë dhe rrethanat e kërkesës", meqë sipas përkufizimit diskriminimi indirekt "mund të dëshmohet vetëm sipas rastit" (*ibid.*).

290. Në lidhje me këtë, Komiteti i KNDESK-së ka theksuar, po ashtu, se eliminimi i diskriminimit për gëzimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, "kërkon të kushtuarit e mjaftueshëm të vëmendjes në grupet dhe personat për të cilët ka paragjykim historik apo të vazhdueshëm" dhe të miratohen masa "për t'i parandaluar,

zvogëluar apo eliminuar kushtet dhe qëndrimet të cilat shkaktojnë apo përjetësojnë" *de facto* diskriminimin". Për shembull, "të siguruarit që të gjithë personat kanë qasje të barabartë në strehim, ujë dhe instalime sanitare adekuate, do të ndihmojë për të tejkaluar diskriminimin kundër grave dhe vajzave, fëmijëve dhe personave që jetojnë në vendbanime joformale apo zona rurale" (shih Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 20, përmendur në § 287 më lart, në § 8).

291. Në veçanti për diskriminimin racor, Gjykata ka konsideruar që ekziston një "lloj veçanërisht i papëlqyeshëm i diskriminimit", i cili "duke pasur parasysh pasojat e tij të rrezikshme, kërkon nga autoritetet vigjilencë të veçantë dhe një reagim energjik" dhe "që asnjë dallim në trajtim, i cili bazohet ekskluzivisht apo deri në një nivel vendimtar në origjinën etnike të personit, nuk mund të justifikohet objektivisht në një shoqëri moderne dhe demokratike të ndërtuar mbi parimet e pluralizmit dhe respektit për kulturat e ndryshme" (shih GJEDNJ, *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, vendimi i 29 janarit të vitit 2013, në § 101).

292. Siç është theksuar më lart, Gjykata Evropiane si dhe traktatet dhe organet e OKB-së kanë pranuar se, si rezultat i historisë së tyre të turbullt dhe lëvizjes nga vendi në vend, romët janë bërë një lloj specifik i minoritetit të pafavorizuar dhe të cenueshëm, që kërkon mbrojtje dhe vëmendje të veçantë (shih, në mes tjerash autoritetet e GJEDNJ-së, GJEDNJ [DHL] *Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, përmendur në § 244 më lart, në § 102; për traktet dhe organet e OKB-së shih për shembull Komiteti i KNEDR-së, Rekomandimi i përgjithshëm nr. XXVII mbi *Diskriminimin kundër romëve*, 2000, Dok. i OKB-së HRI/GEN/1/Rev. 6, i cili thekson obligimet e shtetit për të përmirësuar qasjen e romëve, *inter alia*, në kushte adekuate jetësore dhe shërbime shëndetësore).

293. Veç kësaj, duhet theksuar se disa individë apo grupe përballen me diskriminim nga më shumë se një nga arsyet e ndaluara, për shembull gratë që i takojnë një minoriteti etnik apo religjioz. Diskriminimi i tillë kumulativ ka ndikim unik dhe specifik mbi individë dhe meriton vëmendje të veçantë dhe korrigjim" (Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 20, përmendur në § 287 më lart, në § 17; Komiteti i KEDKG-së, Rekomandim i përgjithshëm nr. 28 *mbi Obligimet bazë të palëve shtetërore sipas nenit 2 të Konventës mbi Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave*, 16 dhjetor 2010, Dok. i OKB-së KEDKG/C/GC/28, at § 18).

294. Për sa i përket peshës së dëshmisë në raste ku diskriminimi është pretenduar, GJEDNJ ka vendosur që "sapo ankuesi të ketë treguar për një dallim në trajtim, i takon Qeverisë të tregojë se ishte i justifikueshëm" (shih GJEDNJ [DHL], *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës së Çekisë*, përmendur në § 238 më lart, në §§ 176-177; shih po ashtu GJEDNJ [DHL], *Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, përmendur në § 292 më lart, në § 150). Sa i përket çështjes se çfarë përbën dëshmi *prima facie* që është në gjendje ta zhvendosë peshën e dëshmisë në shtetin e paditur, Gjykata ka vendosur në procedurat para saj se nuk ka pengesa procedurale për pranueshmëri të dëshmisë apo formulë të paracaktuar për vlerësimin e saj (shih GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, nr. 43577/98 dhe 43579/98, vendimi i 6 korrikut të vitit 2005 § 147). Gjykata ka theksuar që "niveli i bindjes i nevojshëm për të arritur te një përfundim i caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarja e peshës së dëshmisë janë në thelb të lidhura me specifikimin e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe e

drejta në rrezik sipas Konventës (GJEDNJ [DHL], *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke,* përmendur më lart, në § 178). Veç kësaj, ku ngjarjet në fjalë janë krejtësisht, apo në pjesën më të madhe, në kuadër të dijes ekskluzive të autoriteteve, pesha e dëshmisë atëherë mund të vlerësohet se bie mbi autoritetet për të dhënë një sqarim të kënaqshëm dhe bindës (shih *ibid.* dhe praktikën gjyqësore të përmendur aty).

295. Ngjashëm, Komiteti i KNEDR-së thekson që, veçanërisht gjatë vlerësimit të diskriminimit të tillë indirekt apo *de facto*, personi duhet të marrë parasysh plotësisht kontekstin e veçantë dhe rrethanat" e rastit, meqë sipas përkufizimit diskriminimi indirekt "mund të dëshmohet vetëm sipas rastit" (shih po ashtu, Komiteti i KNEDR-së, *L.R. dhe të tjerët kundër Republikës së Sllovakisë*, përmendur në § 289 më lart, në § 10.4).

ii) Aplikueshmëria në rastin aktual

296. Paneli tanimë ka gjetur që vendosja dhe të qëndruarit e ankuesve në kampe të PZHB-ve të kontaminuara me plumb, përbën shkelje të të drejtave të tyre fundamentale, sidomos të drejtës në jetë (të dyja, substanciale dhe procedurale), të drejtës të ndalimit të trajtimit johuman dhe degradues, shkelje e të drejtës së tyre për shëndet dhe standard adekuat të jetesës. Në këtë pjesë të ankesës, Paneli do të vlerësojë nëse animet dhe paragjykimi racial ndaj ankuesve si pjesëtarë të komunitetit RAE luajtën një rol fundamental në këtë rast, duke arritur në shkelje të mëtejme të së drejtës së tyre për të mos qenë të diskriminuar.

297. Paneli i merr parasysh vështirësitë për prova të pandara në pretendimet për diskriminim dhe i referohet qasjes dhe praktikës së Gjykatës Evropiane dhe organeve dhe konventave të OKB-së (shih §§ **Error! Reference source not found.**-295), që përmbajnë bartjen e peshës së dëshmisë tek i padituri dhe një vlerësim të lirë të dëshmisë, e cila mund të përfshijë të dhëna statistikore, kur një rast *prima facie* i diskriminimit është paraqitur arsyeshëm nga ankuesit.

298. Pas shqyrtimit të parashtresave dhe dokumentacionit që i është ofruar Panelit, Paneli mendon se vendosja e ankuesve në kampe të kontaminuara dhe dështimi i mëvonshëm i UNMIK-ut për t'i zhvendosur ata në një vend të pakontaminuar dhe t'u ofrojë qasje në kushte të jetesës konform standardeve për të drejtat e njeriut, ishte diskriminim *prima facie*. Paneli thekson që, duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion të tij, vetëm PZHB-të RAE ishin akomoduar në ato vende të Mitrovicës veriore të njohura të jenë shumë të kontaminuara. Paneli, po ashtu, thekson që kriza pasuese humanitare dhe shëndetësore preku në mënyrë joproporcionale komunitetin RAE.

299. Veç kësaj, Paneli thekson, në lidhje me parashtresën e ankuesve se rindërtimi i Lagjes së Romëve të shkatërruar dhe si rrjedhojë zhvendosja e RAE-ve ishte vonuar shumë më gjatë sesa rindërtimet e kryera në favor të komuniteteve tjera të PZHB-ve, deklaratën Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë që thotë se, në vitin 2004, Lagjja e Romëve ishte akoma vendi më i madh me shtëpi të shkatërruara në Kosovë.

300. Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e këtij rasti, Paneli mendon se ankuesit e kanë krijuar një rast *prima facie* të diskriminimit që ka të bëjë me dështimin e UNMIK-ut

për të iniciuar ndonjë hetim pas paraqitjes së kallëzimit penal nga QEDR lidhur me vdekjet e dyshimta në kampe, duke përfshirë fëmijët.

301. Paneli thekson se, si pasojë, i takon UNMIK-ut të dëshmojë që trajtimi i PZHB-ve romë nuk ishte diskriminues, që do të thotë se kishte arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm për vendosjen e tyre në vend të kontaminuar me plumb dhe dështimin për t'i zhvendosur ata. Paneli thekson se PSSP-ja nuk ka ofruar ndonjë argumentim specifik për të hedhur poshtë pretendimin për diskriminim, përveç një deklarate të përgjithshme se "të gjitha masat e marra nga UNMIK-u dhe partnerët e tij", tregojnë që "komunitetet RAE nevojitet të trajtohen si prioritet nga UNMIK-u dhe partnerët e tij" (shih § 168 më lart).

302. Duke marrë parasysh komentet e PSSP-së lidhur me pjesët e tjera të ankesës, Paneli vlerëson që ndërtimi i kampeve për PZHB-të RAE ndodhi menjëherë pas konfliktit, kur tensionet etnike ishin akoma të larta, në përgjigje të gjendjes së vështirë të mijëra PZHB-ve romë, që kishin mbetur pa shtëpi pas shkatërrimit të Lagjes së Romëve (shih § 153 më lart). Megjithatë, Paneli thekson se një zgjidhje e tillë, e synuar të jetë e përkohshme, zgjati për rreth një dekadë nën mandatin e UNMIK-ut (tri nga të cilat nën juridiksionin e Panelit) dhe që gjatë kësaj kohe PZHB-të RAE ishin lënë në kushte jetësore të rrezikshme dhe pa përkujdesje shëndetësore që situata e tyre e kërkonte. Në lidhje me këtë, Paneli e gjen si të përfshirë nga paragjykimi racor dhe sigurisht justifikim jo-objektiv dhe jo të arsyeshëm argumentin-e kundërshtuar me dëshmi shkencore-se kriza shëndetësore në kampe ishte krijuar nga stili "jo i shëndetshëm" i jetës i PZHB-ve RAE apo argumentin që UNMIK-u nuk mundi t'i zhvendoste PZHB-të RAE në një vend alternativ, të sigurt që do të ishte "i pranueshëm" për krejt palët. Paneli konstaton se gjykimet e tilla dhe qëndrimet diskriminuese të aktorëve lokalë nuk duhet në një shoqëri demokratike dhe pluraliste të kenë prioritet ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies të atyre në një situatë të cenueshme. Veç kësaj, Paneli thekson se nuk është ofruar asnjë justifikim objektiv dhe i arsyeshëm nga PSSP-ja për të sqaruar se pse nuk ishte ndërmarrë çfarëdo qoftë veprimi nga UNMIK-u në vazhdimësi të kallëzimit penal të paraqitur nga përfaqësuesja e ankuesve.

303. Veç kësaj, Paneli thekson se diskriminimi i përhapur ndaj komunitetit RAE në Evropë, duke përfshirë Evropën Lindore, është i dokumentuar gjerësisht. Raportet e organeve përgjegjëse për të drejtat e njeriut dhe organizatave ndërkombëtare potencojnë se segregacioni rreth banimit i romëve, zakonisht i përcjell me kushte të rrezikshme jetësore, është një problem i zakonshëm në shumë vende evropiane[66]. Statistikat mbi ndikimin në shëndet të segregacionit historik dhe kushteve nën standard të jetesës, të shoqëruara me mungesën e shërbimeve adekuate shëndetësore tregojnë se mesatarja e jetëgjatësisë së romëve është për dhjetë vjet më e shkurtër sesa mesatarja në disa vende evropiane[67] dhe që komunitetet rome vuajnë joproporcionalisht nga sëmundjet kronike të shëndetit, mortalitet më i lartë i fëmijëve dhe dështime[68]. Një qëndrim dominues negativ ndaj romëve në Evropë është vërejtur, po ashtu, në procesin e ofrimit të mbrojtjes ndërkombëtare azilkërkuesve dhe refugjatëve, duke iu mohuar shpesh romëve mbrojtja në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare. Në lidhje me këtë është vërejtur se azilkërkuesve romë nga konflikti i

[66] *Ibid.*, në ff. 140-141.
[67] *Ibid.*, në f. 173.
[68] *Ibid.*, në f. 174.

Kosovës u janë ofruar në vende të caktuara evropiane (Gjermani për shembull) forma të mbrojtjes së përkohshme, të cilat nuk përfshijnë statusin e qëndrimit, ndërsa në vendet siç janë Moldavia, Gjeorgjia dhe Mali i Zi, PZHB-të me etni rome që jetonin në qendra kolektive vuajtën nga mungesa e strehimit të mirë[69]. Në veçanti sa i përket PZHB-ve romë, është potencuar se ata vuajtën diskriminim të dyfishtë, në bazë të etnisë dhe si persona të zhvendosur.

304. Paneli thekson se diskriminimi sistemor kundër romëve në Evropë është manifestuar, siç është vërtetuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjithashtu gjatë dështimit të autoriteteve vendore për t'i hetuar efektivisht krimet e kryera kundër romëve dhe motivet e mundshme raciste pas tyre (shih, mbi dështimin për të kryer hetim efektiv për vrasjet dhe sulmet kundër romëve, GJEDNJ, *Sheçiq kundër Kroacisë*, nr. 40116/02, vendimi i 31 majit të vitit 2007; GJEDNJ, *Angelova dhe Iliev kundër Bullgarisë*, nr. 55523/00, vendimi i 26 korrikut të vitit 2007; GJEDNJ, *Koky dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 13624/03, vendimi i 12 qershorit të vitit 2012; mbi dështimin për t'i hetuar motivet e mundshme raciste pas sulmeve, shih po ashtu GJEDNJ [DHL], *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, nr. 43577/98 dhe 43579/98, vendimi i 6 korrikut të vitit 2006, në §§ 160-168).

305. Paneli rikujton se vetë UNMIK-u e kishte për obligim të mos diskriminojë dhe të garantojë mosdiskriminim nga aktorët joshtetërorë (shih Komiteti i KDNJ, Komenti i përgjithshëm nr. 18, përmendur në § 287 më lart, në § 9; dhe Komiteti i KNDESK, Komenti i përgjithshëm nr. 20, përmendur në § 287 më lart, në § 11).

306. Paneli thekson më tutje raportet të cilat dokumentojnë diskriminimin e përgjithshëm që e përjetoi komuniteti RAE në Kosovë për qasje në strehim të mirë, punësim, edukim, shëndet dhe shërbime të tjera. Në këto raporte thuhet që në vitet pas konfliktit, RAE-të janë përballur me armiqësi dhe paragjykim nga të dyja palët komunitetet shqiptare dhe serbe dhe si rezultat i diskriminimit të përhapur, janë prekur në një shkallë shumë më të madhe nga varfëria dhe përjashtimi social sesa pjesëtarët e komuniteteve të tjera në Kosovë[70].

307. Paneli thekson situatën veçanërisht të cenueshme të RAE-ve të shpërngulur brenda vendit në Kosovë. Pas vizitës së tij në Kosovë në qershor të vitit 2005, Raportuesi Special i OKB-së për të Drejtat e Njeriut të PZHB-ve, theksoi se përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar ishin kryesisht të fokusuara te të kthyerit, ndërsa ata që kishin mbetur të zhvendosur brenda Kosovës, dhe veçanërisht PZHB-të romë, ishin lënë shumë pas dore[71]. Pas vizitës së tij në Kosovë në vitin 2009, Raportuesi Special deklaron se më shumë se një dekadë pas zhvendosjes, PZHB-të në Kosovë ishin pas popullatës rezidente sa u përket indikatorëve kryesorë socio-ekonomikë[72] dhe që, në mesin e tyre, një e treta e PZHB-ve romë thuhej se jetonin në "objekt që nuk ishte menduar për strehim"[73].

---

[69] *Ibid.*, në f.196.

[70] Shih, mes tjerash, Komiteti Këshillimor i KiE-së mbi Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale, *Mendim mbi Kosovën*, nëntor 2005, në § 18.

[71] Shih Raportin e vitit 2006 të Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi të Drejtat e Njeriut të Personave të Zhvendosur Brenda Vendit, përmendur në fusnotën 37 më lart, në § 42.

[72] Shih Raportin e vitit 2009 të Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi të Drejtat e Njeriut të Personave të Zhvendosur Brenda Vendit, përmendur në fusnotën 51 më lart, në § 8.

[73] *Ibid.*, në § 52.

308. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Paneli konsideron se UNMIK-u e kishte, përveç obligimit për të mos diskriminuar, po ashtu obligimin pozitiv specifik për të shmangur shtrirjen e praktikave diskriminuese kundër komunitetit RAE në Kosovë dhe t'u ofrojë mbrojtje të veçantë ankuesve si PZHB dhe si pjesëtarë të komunitetit RAE, në një situatë veçanërisht të cenueshme. Këto obligime kërkonin nga UNMIK-u të veprojë me vendosmëri kundër segregacionit të RAE-ve dhe çdo praktike diskriminuese të autoriteteve lokale, të bëjë marrëveshje për t'iu ofruar qasje të barabartë dhe adekuate në përkujdesjen shëndetësore, t'i implementojë aktivitetet e veçanta për të përmirësuar shëndetin e grave dhe fëmijëve të PZHB-ve RAE (shih Komiteti i KNEDR, Rekomandimi i përgjithshëm XXVII, përmendur në § 292 më lart, Shtojca V). Paneli, pas arsyetimit të dhënë në §§ 221, 244 dhe 281 më lart, konsideron se UNMIK-u nuk përmbushi këto obligime dhe as që paraqiti një justifikim të arsyeshëm që nuk e bëri këtë.

309. Si rrjedhim, duke pasur parasysh arsyet e theksuara më lart, Paneli gjen se ankuesit kanë përjetuar diskriminim si pjesëtarë të komunitetit RAE, në shkelje të nenit 14, shpallur në lidhje me nenet 2, 3 dhe 8 të KEDNJ-së, të neneve 2 dhe 26 të KNDCP-së dhe nenit 2 të KNDESK-së.

b) Diskriminimi kundër grave

310. Ankueset femra ankohen se kushtet e rënda dhe të rrezikshme të jetesës në kampe kishin ndikim të veçantë negativ në jetën dhe shëndetin e tyre si gra dhe që, si rrjedhim, ato kishin qenë të diskriminuara në bazë të origjinës së tyre etnike si dhe gjinisë.

i) Parimet e përgjithshme

311. Paneli rikujton që të gjeturat e veta lidhur me pjesët e mëparshme të ankesës janë plotësisht të aplikueshme për ankueset femra. Përveç kësaj, Paneli rikujton që UNMIK-u kishte obligime specifike për mbrojtjen e të drejtave të grave në kampe në pajtim me Konventën KEDKG, e aplikueshme për UNMIK-un në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 të përmendur në § 182 më lart.

312. Në veçanti, Paneli mendon se pretendimi i ankueseve për diskriminim duke u bazuar në gjini duhet shqyrtuar sipas dispozitave relevante (Nenet 1, 2 dhe 12) të KEDKG-së, e cila ndalon të gjitha format e diskriminimit kundër grave, të përkufizuara në nenin 1 të Konventës si:

> "çdo dallim, përjashtim apo kufizim i bërë në bazë të gjinisë i cili ka ndikim apo qëllim të dëmtojë apo shpallë jovalide njohjen, gëzimin apo ushtrimin nga ana e grave, pavarësisht statusit të tyre martesor, duke u bazuar në barazi në mes burrave dhe grave, të të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale në fushën politike, ekonomike, kulturore, civile apo ndonjë fushë tjetër".

313. Në veçanti, neni 12 i KEDKG-së krijon obligimin ligjor për të eliminuar diskriminimin kundër grave për qasje në shërbime shëndetësore gjatë gjithë jetës së tyre. Në dispozitë thuhet:

"1. Palët shtetërore do t'i marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin kundër grave në fushën e përkujdesjes shëndetësore për të siguruar, duke u bazuar në barazi mes burrave dhe grave, qasje në shërbimet e përkujdesjes mjekësore, duke përfshirë ato të lidhura me planifikimin e familjes.
2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, palët shtetërore do t'u sigurojnë grave shërbime të duhura në lidhje me shtatzëninë, lehoninë dhe periudhën post-natale, duke u ofruar shërbime falas ku është e nevojshme, si dhe ushqim adekuat gjatë shtatzënisë dhe gjidhënies."

314. Në rekomandimin e vet të përgjithshëm nr. 24, i cili sqaron shtrirjen dhe fushëveprimin e obligimeve të shteteve sipas nenit 12 të Konventës, Komiteti i KEDKG-së ka theksuar obligimin e përgjithshëm të autoriteteve për të "vendosur perspektivën gjinore" në qendër të të gjitha programeve shëndetësore me qëllim të trajtimit të veçorive dalluese – siç janë ato biologjike (p.sh. funksioni reprodukues), socio-ekonomike (p.sh. marrëdhëniet me fuqi të pabarabartë) dhe faktorët psikologjikë – që dallojnë për gratë krahasuar me burrat dhe të cilat përcaktojnë gjendjen e tyre përkatëse shëndetësore (Komiteti i KEDKG-së, Rekomandimi i përgjithshëm nr. 24 *mbi nenin 12 të Konventës (Gratë dhe Shëndeti)*, 1999, Dok. i OKB-së A/54/38/Rev.1, në §§ 12 dhe 31(a)). Komiteti i KEDKG-së ka potencuar më tutje masat specifike që palët shtetërore e kanë për obligim t'i marrin për përmbushjen e të drejtave shëndetësore të grave. Ato kërkojnë, në mes tjerash që:

"Neni 12 (1)

10. Palët shtetërore inkurajohen të përfshijnë në raportet e tyre informata mbi sëmundjet, gjendjet shëndetësore dhe kushtet e rrezikshme për shëndetin që prekin gratë apo grupe të caktuara grash ndryshe nga burrat, si dhe informata mbi intervenimin e mundshëm në lidhje me këtë …
15. Obligimi për t'i mbrojtur të drejtat në lidhje me shëndetin e grave kërkon nga palët e shteteve, agjentët e tyre dhe zyrtarët që të ndërmarrin veprim për të parandaluar dhe ngarkuar sanksione për shkelje nga personat dhe organizatat private …
21. Palët shtetërore duhet të raportojnë për masat e marra për t'i eliminuar pengesat me të cilat gratë përballen për qasje në shërbimet e përkujdesjes mjekësore dhe çfarë masash i kanë marrë ato për t'iu ofruar grave qasje me kohë dhe çmim të arsyeshëm shërbime të tilla …
22. Palët shtetërore duhet, po ashtu, të raportojnë për masat e marra për të siguruar qasje në shërbime cilësore të përkujdesjes mjekësore, për shembull, duke i bërë ato të pranueshme për gratë. Shërbime të pranueshme janë ato që ofrohen në një mënyrë që një grua ofron pajtimin e saj të plotë duke qenë e informuar, respektojnë dinjitetin e saj, garantojnë konfidencialitetin dhe ofrohen me ndjeshmëri për nevojat dhe perspektivat e saj …
23.Në raportet e tyre, shtetet duhet të theksojnë se cilat masa i kanë marrë për të siguruar qasje me kohë në një varg shërbimesh që janë të lidhura me planifikimin familjar, apo shëndetin seksual dhe reprodukues në përgjithësi …

Neni 12 (2)

26. Raportet duhet, po ashtu, t'i përfshijnë masat e marra për t'iu siguruar grave shërbime të duhura në lidhje me shtatzëninë, lehoninë dhe periudhën post-natale. Informata mbi shkallët në të cilat këto masa e kanë zvogëluar vdekshmërinë dhe sëmundshmërinë e nënës … në përgjithësi, dhe grupet e cenueshme, rajonet dhe komunitetet, duhet po ashtu të identifikohen në veçanti.

> 27. Palët shtetërore duhet të përfshijnë në raportet e tyre se si ato ofrojnë shërbime falas ku është e nevojshme për të siguruar shtatzëni, lindje të fëmijës dhe periudha të sigurta pas lindjes për gratë ... Komiteti thekson se është detyrë e palëve shtetërore ta sigurojnë të drejtën e grave për amësi të sigurt dhe shërbime emergjente obstetrike dhe ato duhet të ndajnë për këto shërbime nivelin maksimal të burimeve në dispozicion".

315. Komiteti ka theksuar gjithashtu që "ndërsa diferencat biologjike ndërmjet grave dhe burrave mund të çojnë te diferencat në statusin shëndetësor, *ekzistojnë po ashtu faktorë shoqërorë që janë përcaktues për statusin e grave dhe burrave dhe mund të ndryshojnë në mesin e vetë grave*. Për atë arsye, vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet nevojave shëndetësore dhe të drejtave të grave që u takojnë grupeve të cenueshme dhe të pafavorizuara, *siç janë gratë migrante, refugjate dhe gratë e shpërngulura së brendshmi, vajza, fëmija dhe gratë e moshuara* … (është shtuar theksi)[74].

316. Paneli rikujton më tutje që obligimet e cekura më lart nuk ndalojnë së ekzistuari në periudha të konfliktit të armatosur apo në gjendjet e emergjencës dhe ato janë të vlefshme, pa diskriminim, për të gjithë ata nën juridiksionin e shtetit, që do të thotë qytetarët dhe joqytetarët, siç janë refugjatët, azilkërkuesit, punëtorët migrantë dhe personat pa shtet (shih Komiteti i KEDKG-së, Rekomandimi i përgjithshëm nr. 28, përmendur në § 293 më lart, në §§ 10-12).

ii) Aplikueshmëria në rastin aktual

317. Paneli thekson se më shumë se gjysma e ankuesve (rreth 75, shih § 98 më lart) janë ankuese femra, gra dhe vajza.

318. Paneli ka verifikuar se kombinimi i helmimit me plumb dhe kushteve joadekuate të jetesës në kampe ishin të tilla saqë shkelën të drejtat më fundamentale të njeriut të ankuesve dhe ishin diskriminuese në bazë të origjinës etnike. Nga kjo pjesë e kësaj ankese, Paneli do të vlerësojë nëse, në dritë të parimeve të paraqitura më lart, ankueset femra ishin, po ashtu, të diskriminuara në bazë të seksit/gjinisë.

319. Paneli i ka parasysh raportet dhe materialin tjetër të cilat ofrojnë dëshmi se gratë rome ka të ngjarë se historikisht kanë përjetuar diskriminim të shumëfishtë, sikur praktikat e sterizilimit me forcë dhe të detyruar apo praktika e martesave me detyrim dhe atyre të fëmijëve që ekziston në shumë shtete evropiane.

320. Paneli e thekson me shqetësim se nuk ka të dhëna zyrtare mbi ndikimin aktual të kontaminimit me plumb në gratë shtatzëna në mesin e PZHB-ve RAE në Mitrovicën veriore. Megjithatë, Paneli konsideron se ka pak hapësirë për dyshim se, *de facto*, ankueset femra ishin prekur gjithashtu dhe në mënyrë joproporcionale nga gjendja jashtëzakonisht jo e shëndetshme në kampe.

321. Paneli rikujton që është verifikuar mirë se gratë shtatzëna, së bashku me fëmijët nën moshën pesë vjeç, janë ata në rrezik më të madh që të përjetojnë efekte të dëmshme nga helmimi me plumb. Plumbi i absorbuar nga gratë shtatzëna ka kaluar në fetus përmes kordonit të kërthizës dhe është përgjegjës për dështimin, lindjen e frytit të vdekur, lindjen para kohe dhe peshën e vogël gjatë lindjes, si dhe deformime të

---

[74] *Ibid*., në § 6.

fëmijës së sapolindur (shih § 66 më lart). Paneli, po ashtu, u referohet raporteve të OJQ-ve që përmbajnë informatat e vetme që i janë paraqitur atij mbi gjendjen e grave shtatzëna në kampe, sipas të cilave shumica e grave me barrë në kampe kishin dështim apo vendosën të vetëshkaktojnë abort, duke u frikësuar se do të lindin një fëmijë të prekur nga deformimet (shih § 116 më lart).

322. Paneli thekson, siç është theksuar po ashtu nga PSSP-ja në komentet e tij për Panelin, që nga ditët e veta të para UNMIK-u ishte në dijeni për rreziqet e larta për shëndetin të shkaktuara nga helmimi me plumb për gratë shtatzëna dhe fëmijët. Në të vërtetë, për këtë arsye, atëherë ish-PSSP-ja SRSG, Bernard Kouchner, kishte vendosur ta ndalë punën e Kompleksit Trepça në gusht të vitit 2000 (shih § 69). Paneli thekson, megjithatë, se nga kjo masë përfituan në një nivel të kufizuar PZHB-të RAE, pasi ata vazhduan t'i ekspozoheshin rrezikut nga plumbi në strehimoret e tyre që gjendeshin në tokën shumë të kontaminuar.

323. Paneli thekson që, përsëri në qershor dhe në tetor të vitit 2004, OBSH-ja potencoi situatën veçanërisht serioze të grave shtatzëna (dhe fëmijëve) në kampe, duke e paralajmëruar UNMIK-un se ata nevojitej të evakuoheshin urgjentisht nga kampet dhe që rastet e tyre paraqisnin emergjenca mjekësore (shih §§ 72-73 më lart).

324. Paneli thekson që, në këto rrethana, UNMIK-u e kishte obligimin sipas KEDKG-së për ta ditur se si situata në kampe kishte prekur ndryshe apo joproporcionalisht ankueset femra dhe të miratojë masa pozitive për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate situatës së tyre veçanërisht të pafavorshme. Këto përfshinin: obligimin *in primis* për të siguruar që gratë shtatzëna të mund të mbajnë shtatzëninë e tyre në një ambient të sigurt, për të siguruar qasje të lehtë për ekzaminim të rregullt dhe përkujdesje adekuate shëndetësore për gratë shtatzëna, qasje adekuate në higjienë dhe ushqim, mbledhje të të dhënave për lindjet e fryteve të vdekura dhe dështimet me qëllim të monitorimit, sigurimit të shërbimeve psikologjike dhe mbështetëse për ato gra që kanë pasur dështim, abort apo lindje të frytit të vdekur.

325. Sa i përket argumentimit të PSSP-së se komuniteti RAE kundërshtoi përpjekjen e UNMIK-ut për t'i zhvendosur gratë shtatzëna (shih § 169 më lart), pas rekomandimeve të OBSH-së të vitit 2004, Paneli thekson se kjo përpjekje përbëhej nga zhvendosja e 12 familjeve të cilat ishin akomoduar për dy javë në një hotel me shpenzime të UNMIK-ut (shih §§ 175 dhe 212 më lart). Paneli konsideron se përgjigjja e UNMIK-ut nuk ishte me kohë, adekuate dhe në përpjesëtim me nivelin e krizës, as e përshtatshme në aspektin kulturor, siç theksohet nga ankuesit, nuk i mori parasysh nevojat dhe perspektivat e ankuesve, duke përfshirë faktin se do të ishte e papranueshme në aspektin kulturor që gratë rome të ndahen nga pjesa e mbetur e familjes (shih § 175 më lart).

326. Sa u përket masave tjera që thuhet të jenë marrë nga UNMIK-u në pritje të zhvendosjes së ankuesve apo si zëvendësim për zhvendosjen (punët rregulluese në kampe, ofrimi i ndihmës mjekësore dhe fushatat për edukim shëndetësor, siç janë përmendur nga PSSP-ja në § 212 më lart), Paneli rikujton me shqetësim se shërbimet e lartpërmendura ishin ofruar në bazë jo të rregullt për PZHB-të RAE dhe ishin ndërprerë në vitin 2007, pa asnjë justifikim të ofruar nga PSSP-ja në lidhje me këtë. Paneli thekson më tutje se zhvendosja e menjëhershme e grave shtatzëna ishte mënyra e vetme për t'iu siguruar atyre një shtatzëni dhe lindje të sigurt të fëmijës, kur

merret parasysh se statusi i tyre nuk lejonte terapi përkatëse apo trajtim tjetër shërues për ndonjë nga sëmundjet që janë paraqitur nga helmimi me plumb.

327. Veç kësaj, Paneli thekson se krijimi i kushteve në të cilat gratë vetëshkaktuan abort është një formë e dhunës në bazë gjinore dhe rrjedhimisht një manifestim i dhunës në bazë gjinore, për të cilën UNMIK-u dështoi t'i marrë masat për t'i mbrojtur gratë (shih Komiteti i KEDKG-së, Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 *mbi Dhunën kundër Grave*, 1992, Dok. i OKB-së A/47/38).

328. Në rrethana të tilla, Paneli përfundon se ndërsa, siç është përcaktuar tanimë, të gjithë ankuesve u ishin shkelur të drejtat, ankueset femra u ishin nënshtruar, po ashtu, diskriminimeve të shumta për gëzimin e të drejtave të tyre fundamentale si gra, si PZHB dhe si pjesëtare të komunitetit RAE.

329. Paneli thekson më tutje se sipas nenit 12 të KEDKG-së, UNMIK-u e kishte për obligim t'u ofrojë ankuesve mbrojtje juridike dhe qasje në mjetet juridike kundër diskriminimit. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se dështimi i UNMIK-ut për t'i hetuar vdekjet në kampe, duke përfshirë rastet e vdekjeve (sikur vdekja e M., e përshkruar në § 122 më lart), që thuhet të jenë shkaktuar nga komplikimet në lindje të fëmijës të shkaktuara nga helmimi me plumb, përbënin diskriminim të mëtejmë të ankuesve.

330. Prandaj, Paneli konstaton se dispozitat relevante të KEDKG-së janë shkelur, gjithashtu.

6. Shkelja e pretenduar e të drejtave të fëmijëve

331. Ankuesit pretendojnë se dispozita të caktuara të KDF-së për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (shih § 148 më lart), po ashtu janë shkelur.

332. Ndërsa rikujton që të gjeturat e Panelit lidhur me pjesët e tjera të ankesës janë plotësisht të aplikueshme për fëmijët, Paneli thekson se KDF, drejtpërdrejt e aplikueshme për UNMIK-un duke u mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 (shih § 182 më lart), ngarkoi obligime specifike në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në kampe, të cilat nuk janë cekur plotësisht në pjesët e tjera të ankesës.

333. Në veçanti, Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës duhet të ekzaminohet sipas nenit 3 (e drejta e fëmijës të merret në konsideratë interesi më i mirë i fëmijës), neni 6 (e drejta e qenësishme e fëmijës në jetë), neni 24 (e drejta e fëmijës për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit), neni 27 (e drejta e fëmijës për një standard të jetesës adekuat për zhvillimin e saj/tij fizik, mental, shpirtëror, moral dhe shoqëror), neni 37 (ndalimi i trajtimit johuman dhe degradues kundër fëmijëve).

a) Parimet e përgjithshme

334. Në dispozitat relevante të Konventës për të Drejtat e Njeriut thuhet si në vijim:

Neni 3

1. Në të gjitha veprimet lidhur me fëmijët … konsideratë kryesore duhet kushtuar interesave më të mira të fëmijës …

Neni 6

1. Palët shtetërore pranojnë se çdo fëmijë e ka të drejtën e qenësishme në jetë. 2. Palët shtetërore duhet të sigurojnë në nivelin maksimal të mundshëm mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.

Neni 24

"1. Palët shtetërore pranojnë të drejtën e fëmijës që të gëzojë standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit dhe lehtësitë për trajtimin e sëmundjes dhe rehabilitimin nga sëmundja. Palët shtetërore do të përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmijë nuk privohet nga e drejta e tij/saj për qasje në shërbime të tilla të përkujdesjes shëndetësore.

2. Palët shtetërore do të ndjekin implementimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti, do t'i marrin masat e duhura:
   (a) Të zvogëlojnë mortalitetin e të miturve dhe fëmijëve;
   (b) Të sigurojnë ofrimin e asistencës së nevojshme mjekësore dhe përkujdesjes shëndetësore të gjithë fëmijëve me theks në zhvillimin e përkujdesjes primare shëndetësore;
   (c) Të luftojnë sëmundjen dhe mosushqimin …përmes, inter alia … ofrimit të ushqimeve adekuate për ushqyerje dhe ujit të pastër dhe të pijshëm, duke marrë parasysh rreziqet e ndotjes ambientale;
   (d) Të sigurojnë përkujdesje shëndetësore para-natale dhe pas-natale për nënat …;
   (e) Të sigurojnë që të gjitha segmentet e shoqërisë, në veçanti prindërit dhe fëmijët, janë të informuar, kanë qasje në edukim dhe përkrahen për përdorimin e njohurive elementare për shëndetin dhe ushqimin e fëmijës, përparësive të ushqimit me gji, higjienën dhe higjienën publike në ambient dhe parandalimin e aksidenteve;
   (f) Të zhvillojnë përkujdesjen preventive shëndetësore, udhëzimin për prindërit dhe edukim dhe shërbime mbi planifikimin familjar.

Neni 27

1. Palët shtetërore pranojnë të drejtën e çdo fëmije për një standard të jetesës adekuat për zhvillimin fizik, mental, shpirtëror, moral dhe social të fëmijës"

Neni 37

Palët shtetërore sigurojnë që: (a) Asnjë fëmijë nuk do t'i nënshtrohet torturës apo trajtimit apo dënimit tjetër mizor, johuman dhe degradues …

335. Në Komentin e vet të përgjithshëm nr. 14, Komiteti i KDF-së ka theksuar që neni 3 i KDF-së, në të cilin thuhet se konsideratë kryesore duhet kushtuar interesave më të mira të fëmijës në të gjitha veprimet e lidhura drejtpërdrejtë apo indirekt me fëmijët, vendos një "obligim të fortë ligjor" mbi autoritetet. Kjo nënkupton, që autoritetet "mund të mos kenë zgjedhje për atë nëse interesat më të mira të fëmijëve duhet vlerësuar dhe peshuar si konsideratë kryesore në ndonjë veprim të ndërmarrë" (shih Komiteti i KDF-së, Komenti i përgjithshëm nr. 14 *mbi të drejtën e fëmijëve për të pasur si konsideratë kryesore interesat e tij apo saj më të mira*, 20 maj 2013, Dok. i OKB-së CRC/C/GC/14, në § 36).

336. Komiteti e ka qartësuar se "konsideratë primare" nënkupton që "interesat më të mira të fëmijës mund të mos konsiderohen të nivelit të njëjtë si të tjerat". Komiteti thekson që "ky qëndrim i fortë justifikohet me situatën e veçantë të fëmijës: varësinë, pjekurinë, statusin ligjor dhe, shpesh të mosdëgjuarit e zërit të tyre. Fëmijët kanë më pak mundësi se të rriturit ta bëjnë një rast të fortë që të jetë në interesin e tyre dhe ata të përfshirët në vendime që i prekin ata, duhet në mënyrë të qartë të jenë të vetëdijshëm për interesat e tyre. Nëse interesat e fëmijëve nuk theksohen, ato ka tendencë të neglizhohen" (Komiteti i KDF, Komenti i përgjithshëm nr. 14, përmendur më lart, në § 37).

337. E drejta e fëmijës për t'u marrë interesat më të mira të tij/saj si konsideratë primare është një e drejtë substanciale por edhe rregull procedurale: "kurdo që një vendim duhet marrë që do të prekë një fëmijë specifik, një grup të identifikuar të fëmijëve apo fëmijët në përgjithësi, procesi i vendimmarrjes duhet të përfshijë një vlerësim të ndikimit të mundshëm (pozitiv apo negativ) të vendimit në fëmijën apo fëmijët në fjalë …" (Komiteti i KDF-së, Komenti i përgjithshëm nr. 14, përmendur në § 335 më lart, në § 6 (c)).

338. Mbrojtja e të drejtës së qenësishme të fëmijës për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, si dhe të drejtës së fëmijës për shëndet dhe gjendjen e tij/saj shëndetësore, janë "qendrore" kur vlerësohen dhe përcaktohen interesat më të mira të fëmijës (shih Komiteti i KDF-së, Komenti i përgjithshëm nr. 14, përmendur në § 335 më lart, në §§ 42 dhe 77). Veç kësaj, Komiteti ka theksuar që një element i rëndësishëm për t'u konsideruar në procesin e vlerësimit të interesave më të mira të fëmijës në një situatë specifike është "situatë e cenueshmërisë së fëmijës, sikur paaftësia, përkatësia një grupi minoritar, të qenit refugjat apo azilkërkues … etj." (Komiteti i KDF-së, *ibid.*, në § 75).

339. Veç kësaj, në Komentin e vet të përgjithshëm nr. 15 mbi të drejtën e fëmijës për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit, Komiteti i KDF-së ka theksuar që parimi për interesat më të mira të fëmijës "duhet pasur parasysh në të gjitha vendimet e lidhura me shëndetin". Për shembull, ky parim duhet "t'i udhëheqë opsionet trajtuese që zëvendësojnë konsideratat ekonomike ku është e mundshme" dhe të jetë "baza për gjithë vendimmarrjen në lidhje me ofrimin, mbajtjen dhe përfundimin e trajtimit për të gjithë fëmijët" (Komiteti i KDF-së, Komenti i përgjithshëm nr. 15 *mbi të drejtën e fëmijës për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit*, 17 prill 2001, Dok. i OKB-së CRC/C/GC/15, në §§ 12-14).

b) Aplikueshmëria në rastin aktual

340. Paneli, së pari, thekson se rreth gjysma e ankuesve (siç është theksuar në § 98 më lart) ishin fëmijë kur ankesa në emër të tyre i ishte paraqitur Panelit.

341. Paneli e konsideron si të vërtetuar se ishin fëmijët të cilët vuajtën më së shumti, dhe në një mënyrë të pakthyeshme, nga situata në kampet e PZHB-ve, duke përfshirë helmimin me plumb dhe kushtet e vështira të jetesës dhe higjienës.

342. Paneli rikujton që, më së voni në qershor të vitit 2004, UNMIK-u ishte i informuar në lidhje me rreziqet serioze dhe specifike që helmimi me plumb paraqiste për jetët dhe shëndetin e fëmijëve në kampe. Në fakt, që nga viti 2004 OBSH-ja ia transmetoi të gjeturat klinike (shih §§ 72-73) UNMIK-ut, të cilat tregonin që në mesin e popullatës

së fëmijëve të marrë mostër, të cilët kishin lindur në kampe, rreth 58.6 % kishin NPB mbi nivelin e pranueshëm dhe rreth një nga pesë fëmijët e testuar ishin klasifikuar si emergjencë shëndetësore, duke pasur NPB aq të lartë saqë aparatet në përdorim nuk ishin në gjendje ta regjistrojnë atë. UNMIK-u ishte paralajmëruar se situata kërkonte intervenim të menjëhershëm (evakuim, trajtim, shpërndarje të furnizimit me ushqim), pa të cilin PZHB-ve fëmijë do t'u shkaktoheshin pasoja serioze që radhiten nga humbja e inteligjencës dhe dëmtimi i trurit (për ekspozim më të ulët) deri te encefalopatia dhe vdekja (për nivelet e larta të NPB-së).

343. Paneli thekson parashtresën e PSSP-së se, në dritë të masave të miratuara nga UNMIK-u në përgjigje të situatës në kampe, ai "përmbushi obligimet pozitive për t'i mbrojtur të drejtat e fëmijëve duke siguruar mbrojtje, strehim, përkujdesje shëndetësore dhe arsimim" (shih § 170 më lart).

344. Megjithatë, në dritë të dokumentacionit që i është paraqitur atij dhe në dritë të të gjeturave të Panelit lidhur me pjesët e tjera të ankesës, Paneli i konsideron të pamjaftueshme dhe joadekuate veprimet e ndërmarra nga UNMIK-u për të përmbushur obligimin e vet sipas nenit 24.2 të KDF-së (t'i marrë masat për të parandaluar dhe zvogëluar mortalitetin e fëmijëve, ofruar asistencën e nevojshme mjekësore, siguruar përkujdesje para-natale dhe pas-natale për nënat).

345. Paneli konsideron se jetët dhe shëndeti i fëmijëve është dashur të jenë të një konsiderate thelbësore që do të udhëhiqte përgjigjen e UNMIK-ut ndaj situatës. Megjithatë, Paneli thekson se UNMIK-u nuk sqaroi (as që ofroi ndonjë dokumentacion në lidhje me këtë) se si interesat më të mira të fëmijëve ishin konsideruar, vlerësuar dhe përcaktuar kur janë vendosur dhe miratuar masa në përgjigje ndaj situatës në kampe.

346. Paneli, po ashtu, thekson se veçanërisht pas miratimit të Deklaratës së Mileniumit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe krijimit të Qëllimeve Zhvillimore të Mileniumit (QZHM) në vitin 2000, OKB-ja ka bërë përpjekje të konsiderueshme dhe ka kërkuar nga vendet anëtare që t'i marrin të gjitha masat për të arritur qëllimin e zvogëlimit të mortalitetit të fëmijëve dhe përmirësimit të shëndetit të nënës (i vendosur si QZHM i katërt apo i pestë), të konsideruara si objektiva të arritshme për komunitetin ndërkombëtar. Arritja e QZHM-ve me sa duket i ka dhënë formë gjithë programimit dhe veprimeve të UNMIK-ut. Megjithatë, Paneli thekson se konsideratat e tilla duket se nuk kanë udhëhequr përgjigjen e UNMIK-ut ndaj situatës së ankuesve.

347. Si pasojë, Paneli konstaton se, përmes veprimeve dhe lëshimeve të veta, UNMIK-u ishte përgjegjës për rrezikimin në mënyrë të pakthyeshme të jetës, shëndetit, dhe potencialit zhvillimor të ankuesve që kanë lindur dhe janë rritur si fëmijë në kampe, në shkelje të neneve 3, 6, 24, 27 dhe 37 të KDF-së.

6. Shkelja e pretenduar e të drejtës për gjykim të drejtë dhe kompensim efektiv

348. Sa i përket ankesës sipas neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së, Paneli mendon se aktivitetet ligjore substanciale më të rëndësishme në këtë rast janë analizuar plotësisht dhe nuk është e nevojshme të bëjë vlerësim të mëtejmë lidhur me këtë pjesë të ankesës.

V. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET

349. Për arsyet e mësipërme, Paneli unanimisht:

1. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 2, OBLIGIMI ESENCIAL, TË KEDNJ-së;**

2. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 2, OBLIGIMI PROCEDURAL, TË KEDNJ-së, PËR SA I PËRKET ANKUESVE NR. 1, 2, 8, DHE 20;**

3. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 3 TË KEDNJ-së;**

4. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 8 TË KEDNJ-së;**

5. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENEVE 11 DHE 12 TË KNDESK-së;**

6. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 14, SHPALLUR NË LIDHJE ME NENET 2, 3 DHE 8 TË KEDNJ-së;**

7. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENEVE 2 DHE 26 TË KNDCP-së DHE NENIT 2 TË KNDESK-së;**

8. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENEVE 1, 2 DHE 12 TË KEDKG-së PËR SA U PËRKET ANKUESEVE FEMRA;**

9. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENEVE 3, 6, 24, 27 DHE 37 TË KDF-së PËR SA U PËRKET FËMIJËVE;**

10. **KONSTATON SE NUK ËSHTË E NEVOJSHME TË BËHET NJË VLERËSIM TJETËR LIDHUR ME NENET 6 DHE 13 TË KEDNJ-së.**

REKOMANDON QË UNMIK-u:

a. **TË PRANOJË PUBLIKISHT, DUKE PËRFSHIRË MEDIET, DËSHTIMIN E UNMIK-ut PËR TË VEPRUAR NË PAJTIM ME STANDARDET E APLIKUESHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË PËRGJIGJE NDAJ GJENDJES SË PAFAVORSHME SHËNDETËSORE TË SHKAKTUAR NGA KONTAMINIMI ME PLUMB NË KAMPET PËR PZHB DHE PËR DËMET PASUESE QË I PËRJETUAN ANKUESIT, DHE T'U KËRKOJ FALJE ATYRE DHE FAMILJEVE TË TYRE;**

b. **TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT ADEKUAT ANKUESVE PËR DËMIN MATERIAL NË**

LIDHJE ME GJETJEN E SHKELJEVE TË DISPOZITAVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT TË PËRMENDURA MË LART;

c. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT ADEKUAT ANKUESVE PËR DËMIN MORAL NË LIDHJE ME GJETJEN E SHKELJEVE TË DISPOZITAVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT TË PËRMENDURA MË LART;

d. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR PËR T'UA PAGUAR ANKUESVE TË GJITHA PAGESAT DHE SHPENZIMET NË LIDHJE ME PROCEDURAT PARA PANELIT;

e. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR PËR TË SIGURUAR QË ORGANET E OKB-së QË PUNOJNË ME REFUGJATË DHE PZHB TË PROMOVOJNË DHE SIGUROJNË RESPEKTIMIN E STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE QË TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET E PANELIT NË KËTË RAST TË NDAHEN ME KËTO ORGANE, SI NJË GARANCI PËR MOSPËRSËRITJE;

f. T'IU KËRKOJË ORGANEVE TË OKB-së DHE AUTORITETEVE RELEVANTE TË KOSOVËS T'I MBROJNË DHE PROMOVOJNË TË DREJTAT E NJERIUT TË POPULLATËS RAE, VEÇANËRISHT GRAVE DHE FËMIJËVE, DUKE SIGURUAR QË ATO TË KENË NJË ROL PROAKTIV;

g. TË NDËRMARRË TË GJITHË HAPAT E DUHUR NË ORGANET E OKB-së PËR TË SIGURUAR SHPËRNDARJE EFEKTIVE TË INFORMATAVE RELEVANTE PËR SHËNDETIN DHE MIRËQENIEN E NJERËZVE NËN AUTORITETIN DHE KONTROLLIN E TYRE;

h. TË MARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T'I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT DHE T'I INFORMOJË ANKUESIT DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.

Anna Maria Cesano	Christine Chinkin
Ushtruese e detyrës së zyrtares ekzekutive	Kryesuese

Shtojca

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

BLL – Niveli i plumbit në gjak
CCPR – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
CEDAW – Konventa Për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave
CDC – Qendra për Kontroll të Sëmundjes
ICERD – Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial
CESCR – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
CoE – Këshilli i Evropës
CRC – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve
ECHR -Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
EctHR-Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ERRC – Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve
EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
GfbV – Shoqëria për Popuj të Kërcënuar *[Gesellschaft für bedrohte Völker]*
HRAP – Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
HRC – Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
HRRP – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i EULEX-it
HRW – Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut
IACtHR – Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut
ICRC – Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
IDPs – Personat e zhvendosur brenda vendit
KFOR – Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (zakonisht e njohur si Forca e Kosovës)
MAT – Ekipi për Veprim në Mitrovicë
MDGs – Qëllimet zhvillimore të mileniumit
NGO – Organizatë joqeveritare
OSCE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PISG – Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
RAE – Romë, Ashkali, Egjiptian
SRSG – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UDHR – Deklarata Univeale për të Drejtat e Njeriut
UN – Kombet e Bashkuara
UNEP – Programi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ambientin
UNICEF – Fondi i Emergjencës i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNHCR – Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
WHO – Organizata Botërore e Shëndetësisë